



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 344 Akti

Nr. 447 Vendimi
Tiranë, më 17.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Relator
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 15.9.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bujar Musta**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisioner Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Musta, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 15.9.2021, kërkoi konfirmimin në detyrë.

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Bujar Musta, për shkak të funksionit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹.
2. Pas hedhjes së shortit të datës 12.11.2019, për rivlerësimin e këtij subjekti rezultoi i shortuar trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Olsi Komici dhe Suela Zhegu. Në vijim, komisionere Genta Tafa (Bungo) ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga rivlerësimi i kësaj dosjeje dhe pasi kjo kërkesë është shqyrtuar dhe pranuar nga një tjetër trup gjykues, komisionere Genta Tafa (Bungo) është zëvendësuar nga komisioner Lulzim Hamitaj, i cili ishte shortuar më herët si anëtar zëvendësues i këtij trupi gjykues. Më tej, trupi gjykues i rikompozuar, pasi administroi dhe shqyrtoi raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 27.11.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesues i trupit gjykues komisioneri Olsi Komici. Gjithashtu, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
3. Në vijim të hapave hetimore, me vendimin nr. 2, datë 30.7.2021, trupi gjykues, pasi vlerësoi ekzistencën e një niveli të lartë provueshmërie të provave të administruara, vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, çmoi që procesi i rivlerësimit për z. Bujar Musta të bazohej mbi të tria kriteret e rivlerësimit.
4. Në datën 30.7.2021, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 20.8.2021; (iii) të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
5. Më tej, pasi është njohur me dosjen përkatëse, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar zgjatjen e afatit për sjelljen e dokumentacionit dhe prapësimeve. Trupi gjykues e ka pranuar kërkesën e subjektit duke i dhënë kohë shtesë.

II. SEANCA DËGJIMORE

6. Në seancën dëgjimore të datës 15.9.2021, subjekti u paraqit personalisht dhe shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues, si dhe shprehu qëndrimin e tij përfundimtar, duke kërkuar konfirmimin në detyrë.
7. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, vendosi të konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Bujar Musta. Seanca dëgjimore e datës 15.9.2021, u mbyll, për të rifilluar më 17.9.2021, për shpalljen e vendimit.

¹Paragrafi 3 i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikojnë se: "Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*".

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

8. Z. Bujar Musta ka mbajtur qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje, të paraqitura në afatet e caktuara, si dhe ka vënë në dispozicion edhe dokumentacion ligjor mbështetës, për aq sa ka disponuar, siç i është kërkuar nga Komisioni.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

9. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - i. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
 - ii. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - iii. raportet dhe informacionet mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
 - iv. provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
 - v. deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;
 - vi. shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve të bëra nga subjekti në seancën dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
 - vii. deklaratimet e personave të lidhur, apo të tjerë të lidhur; si dhe
 - viii. faktet e njohura botërisht.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

10. ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Bujar Musta, ku konstatohet se:
 - *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

11. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
12. Hetimi administrativ, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rremë apo të ndonjë konflikti të interesave, parashikuar në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, pasuritë në vijim:

- a. apartament me sip. 121.09 m² me nr. pasurie ***, z. k. ***, ndodhur në lagjen “E. M.”, Elbasan, blerë në datën 26.2.2010, me vlerë 3,000,000 lekë, me burim të ardhurat, ndër vite, nga paga, dhurimet, administrimi i vlerës së shitjes së shtëpisë dhe huamarrje;
- b. autoveturë tip “Mercedes-Benz”, modeli 250 CDI, me targa aktuale AA *** (më parë EL ***), viti i prodhimit 1996, blerë në datën 11.02.2010, me vlerë 200,000 lekë dhe me burim krijimi të ardhurat ndër vite;
- c. llogari rrjedhëse në emër të subjektit, në “Raiffeisen Bank”, në shumën 697 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga; si dhe
- ç. gjendje *cash* në vlerën 1,300,000 lekë.

1. Apartament banimi me sip. 121.09 m², në Elbasan²

14. Pasuria e sipërcituar është deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 dhe në deklaratën *Vetting*, si e përfutur nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 26.2.2010, me palë shitëse E. L., kundrejt çmimit total 3,000,000 lekë³ (24,775.96 lekë/m²). Në deklaratën e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka specifikuar konkretisht burimet e krijimit të kësaj pasurie, por ka deklaruar pakësimin e kursimeve të disponuara më herët në formën *cash* dhe në rubrikën e detyrimeve financiare ka deklaruar marrjen e një huaje, me kontratë të thjeshtë, të datës 24.2.2010, me afat trevjeçar në vlerën 1,000,000 lekë për blerjen e apartamentit. Ndërsa në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e pasurisë:

- a. të ardhurat dhe kursimet e përbashkëta, të krijuara nga paga e tij dhe e bashkëshortes;
- b. dhurim në shumën 500,000 lekë nga vëllai H. M.;
- c. administrimi i vlerës së shitjes së apartamentit në Burrel dhe depozitimi në llogari bankare së bashku me interesat ndër vite; si dhe
- d. huamarrje në vlerën 1,000,000 lekë nga shtetasja E. P. në vitin 2010.

15. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se shitësi E. L., e ka blerë këtë pasuri, nga vjehëri i subjektit, nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 18.3.2006, kundrejt çmimit prej 3,500,000 lekësh. Referuar Udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, ka rezultuar se çmimi mesatar i apartamenteve në tregun e lirë, për vitin 2010, në qytetin e Elbasanit, ka qenë në vlerën 48,984 lekë/m², sipas së cilës çmimi i tregut të apartamentit në fjalë do të rezultonte 5,931,473 lekë.

16. Fillimisht, kjo pasuri ishte blerë nga vjehëri i subjektit të rivlerësimit, z. R. F., me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 22.7.2004, me palë shitëse z. M. L., në cilësinë e ortakut dhe administratorit të shoqërisë “E.” sh.p.k., në vlerën prej 3,100,000 lekësh, të likuiduar jashtë zyrës së noterisë. Edhe në këtë rast, referuar Udhëzimit nr. 1, datë 4.3.2004, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit ‘K’”, çmimi mesatar në tregun e lirë për vitin 2004, ka qenë në vlerën 44,611 lekë/m², çka do të rezultonte në një çmim tregu prej 5,401,946 lekësh, dukshëm më i lartë se çmimi i përshkruar në kontratën e shitblerjes. Për më tepër, ky i fundit duket të jetë edhe nën koston e ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi, i përcaktuar për qytetin e Elbasanit në vitin 2004, në vlerën

²Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë adresë banimi/vendqëndrimi në DIPP-të e viteve 2007, 2008 dhe 2009.

³Referuar kontratës së shitblerjes, këtë shumë pala shitëse ka deklaruar se e ka marrë jashtë zyrës noteriale nëpërmjet përfaqësueses E. P., sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 23.2.2010, për kryerjen e veprimeve si kontratë shitblerjeje, kontratë dhurimi/kontratë shkëmbimi për pasurinë në fjalë.

27,284 lekë/m², sipas së cilës kosto e ndërtimit për një sipërfaqe shfrytëzimi prej 121.09 m², ka qenë në vlerën 3,303,820 lekë.

17. Në DIPP-të për vitet 2011 dhe 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjet përkatësisht të shumave prej 500,000 lekësh në vit, të huas ndaj shtetasës E. P.. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia e apartamentit në fjalë, në shumën 420,000 lekë, sipas kontratës së qirasë së datës 1.10.2013, të lidhur mes tij dhe shoqërisë “M. M. L.”, kundrejt qirasë në vlerën 35,000 lekë/muaj.
18. Lidhur me këtë pasuri Komisioni ka administruar dokumentacionin e përshkruar në vijim:
 - a. kontratë shitblerje nr. ***, datë 26.2.2010, e lidhur ndërmjet palës shitëse E. L. (i përfaqësuar me prokurë nga shtetasja E. P.) dhe palës blerëse Bujar Musta, për blerjen e një apartamenti me nr. pasurie ***, me sip. 121.09 m², në vlerën totale 3,000 000 lekë;
 - b. deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.12.2019, e shtetasit E. L., i cili ka deklaruar se gjatë periudhës 1.9.2007 – 1.2.2010, ia ka lënë pasurinë në fjalë, në përdorim subjektivit të rivlerësimit, për banim familjar, pa kundërshtim;
 - c. ZVRPP-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 22.9.2017 dhe ASHK-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot, datë 27.2.2020, kanë konfirmuar pasurinë e sipërcituar në pronësi të shtetasit Bujar Musta dhe kanë bashkëlidhur dokumentacionin e pronësisë;
 - d. ASHK-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 13.11.2020⁴, ka bashkëlidhur dosjen e plotë të pasurisë në fjalë, përfshirë dhe historikun e saj;
 - e. UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2020, ka informuar se për shtetasin Bujar Musta dhe personat e lidhur, nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për kontrata të regjistruara në emër të tyre;
 - f. FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2020, ka bërë me dije se kanë rezultuar tri kontrata me gjeneralitet e shtetasit Bujar Musta, konkretisht: kontratat e furnizimit në Elbasan, me nr. ***⁵ e çelur në datën 31.3.2004; me nr. *** e çelur në datën 30.10.2009; si dhe kontrata me nr. ***⁶ në qytetin e Kavajës, e çelur në datën 5.11.2004;
 - g. kontratë qiraje e datës 1.10.2013, e lidhur mes subjektivit të rivlerësimit dhe shoqërisë “M. M. L.”, e përfaqësuar nga shtetasi E. Zh., me afat 1-vjeçar, kundrejt vlerës 35,000 lekë/muaj.
19. Gjithashtu, nëpërmjet shkresës së datës 12.11.2020, notere A. Gj.⁷ ka vënë në dispozicion të Komisionit një deklaratë të nënës së subjektivit të rivlerësimit, z. N. M., me të cilën ka hequr dorë nga çdo e drejtë, si pjesë, përqindje apo masë ideale e pjesës takuese, mbi pasurinë e paluajtshme në analizë dhe, rrjedhimisht, duke i kaluar këto të drejta reale subjektivit të rivlerësimit Bujar Musta.
20. Lidhur me ekzistencën e konfliktit të mundshëm të interesit me palët e mësipërme⁸, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 19.11.2020, ka informuar se nga kjo gjykatë janë dhënë gjithsej pesë vendime gjyqësore, por asnjëri prej tyre nuk është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

⁴Në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 10.11.2020, të Komisionit drejtuar ASHK-së Elbasan.

⁵Në këtë kontratë ka rezultuar shënimi: “#emri E. L. në Bujar Musta *** dt. 04.03.2014...”.

⁶FSHU-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2021, ka përcjellë dosjen e kësaj kontrate furnizimi, e cila ka rezultuar se nuk është e lidhur nga subjekti i rivlerësimit, por një individ tjetër me të njëjtin emër, por datëlindje ndryshe.

⁷Nga verifikimi i dokumentacionit të Regjistratit Noterial të Ministrisë së Drejtësisë ka rezultuar nënshkrimi i një deklaratë për heqje dorë nga pasuria e nënshkruar nga nëna e subjektivit të rivlerësimit, në datën 24.1.2017.

⁸Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2020, ka kërkuar informacion lidhur me çështje gjyqësore të gjykuara nga viti 2009 e në vijim për shtetasit E. L., E. Zh. (përfaqësues i subjektivit M. M. D. L.), V. P. dhe E. P. dhe shoqëria “E.” sh.p.k. (përfaqësuar nga shtetasi M. L.). Nga kjo gjykatë janë shqyrtuar 5 çështje, prej të cilave një vendim civil me palë shtetasin V. P. dhe i paditur shoqëria “E.” sh.p.k. dhe 4 vendime të tjera me palë ndërgjyqëse shoqërinë “E.” sh.p.k.

1.1 Lidhur me burimet e krijimit për blerjen e kësaj pasurie

a. Për sa i përket të ardhurave dhe kursimeve të përbashkëta të subjektit dhe të bashkëshortes, të ardhurat nga shitja e pasurisë në Burrel dhe dhurimet e vëllait të subjektit

- 21.** Nisur nga deklaramet e subjektit mbi burimet e përdorura për blerjen e apartamentit në analizë, duket se burimet e trajtuara në këtë pikë janë përdorur për kryerjen e pagesës së shumës prej 2,000,000 lekësh, për sa kohë pjesa tjetër, pra, shuma prej 1,000,000 lekësh është deklaruar si hua e marrë nga shtetasja E. P..
- 22.** Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej 500,000 lekësh të përfituar nga shitja e banesës në Burrel, në bashkëpronësi me nënën. Kjo pasuri ishte blerë fillimisht nëpërmjet kontratës për privatizimin e banesës së datës 30.11.1993, kundrejt çmimit 20,096 lekë. Më pas, kjo pasuri është shitur prej nënës së subjektit, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** regj., datë 4.2.1997, palës blerëse S. L., kundrejt çmimit 500,000 lekë. ZVRPP-ja Mat, me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2017 dhe ASHK-ja Dibër, Zyra Vendore Mat, me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020, kanë informuar se shtetasit N. M. dhe Bujar Musta, kanë të regjistruar transaksionin e shitjes së datës 6.9.1999, të pasurisë nr. ***, të llojit apartament me sip. 69.5 m², ndodhur në Mat, Burrel.
- 23.** Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka bërë me dije se shumën 500,000 lekë e ka depozituar në Bankën e Kursimeve më 28.4.1998, shumë e cila ka qëndruar e investuar me afat 3-mujor, deri më 28.7.2000, interesat e së cilës janë akumuluar dhe nuk janë tërhequr, duke krijuar shumën prej 682,959 lekësh. Më pas, shuma e mësipërme prej 682,959 lekësh, së bashku me kontributet nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes, si dhe dhurimet e vëllait H. M. (emigrant në Itali), u bashkuan duke krijuar shumën totale 1,000,000 lekë. Subjekti është shprehur se shuma 1,000,000 lekë është depozituar, më pas, sërish në Bankën e Kursimeve në datën 4.8.2000 dhe ka qëndruar e investuar me afat 3-mujor deri në vitin 2004.
- 24.** Përgjatë hetimit administrativ, “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 4.0.2020, ka përcjellë informacionin mbi llogaritë e subjektit, të cilat datojnë nga 30.9.2004, ku teprica e llogarisë së subjektit ka qenë në shumën 1,271,169 lekë. Po ashtu, “Raiffeisen Bank”, me shkresën kthim përgjigjes nr. *** prot., datë 26.1.2017, ka bërë me dije se informacioni i ish-Bankës së Kursimeve nuk ka qenë ruajtur në formë elektronike dhe banka e ka të pamundur të nxjerrë të dhëna të klientëve përpara datës 1.10.2004.
- 25.** “Raiffeisen Bank”, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 26.3.2019, ka vënë në dispozicion të Komisionit, buletinin e normave të interesit të aplikuara nga ish-Banka e Kursimeve për depozitat. Komisioni ka përllogaritur investimin e shumës fillestare prej 500,000 lekësh, sipas deklaramet të subjektit, për periudhën 28.4.1998 – 28.4.2000, me afat 3-mujor. Nga kjo përllogaritje, ka rezultuar se në fund të maturimit, në datën 28.4.2000, *principali* së bashku me interesat arrijnë një vlerë të njëjtë me shumën e pretenduar nga subjekti, prej 682,959 lekësh.
- 26.** Po ashtu, Komisioni ka përllogaritur investimin e shumës prej 1,000,000 lekësh, për periudhën 4.8.2000 – 28.10.2004 (data e maturimit e konfirmuar nga “Raiffeisen Bank”), në përfundim të së cilës ka rezultuar se *principali* së bashku me interesat arrijnë në një vlerë shumë të përafërt me shumën e evidentuar në lëvizjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank”, në momentin e maturimit, prej 1,284,106 lekësh. Gjithashtu, është vlerësuar mundësia financiare e subjektit për të krijuar me burime të ligjshme, përgjatë periudhës maj 1998 – korrik 2000, kursime në shumën prej 317,041 lekë (për të plotësuar shumën

prej 1,000,000 lekësh, pas tërheqjes së depozitës në shumën 682,959 lekë). Në këtë analizë janë konsideruar të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të bashkëshortes dhe të pensionit të nënës, të cilat kanë rezultuar në shumën 1,033,575 lekë⁹. Sa i përket dhurimeve nga vëllai i subjektit H. M.¹⁰, të deklaruara në deklaratën *Vetting*, në shumën 500,000 lekë, përgjatë periudhës 1991– 1999, subjekti ka bërë me dije se shumat janë dërguar pjesë-pjesë dhe se ai gjatë kësaj periudhe ka qenë i pasiguruar dhe, për rrjedhojë, ky burim nuk është përfshirë në analizën në fjalë.

27. Pasi janë përlllogaritur edhe shpenzimet e jetesës¹¹ për të njëjtën periudhë, në përfundim ka rezultuar se subjekti mund të dispononte kursime në shumën 317,041 lekë, për të investuar shumën totale prej 1,000,000 lekësh, me burime të ligjshme financiare.

Tabela nr. 1 – Mundësia e kursimeve për investimin në vitin 2000

Të ardhura maj 1998 - korrik 2000		1 033 575
Shpenzime jetese maj 1998 - korrik 2000	-	452 000
Krijuar kursime për investimin në depozitë	-	317 041
Rezultati		264 534

28. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se shuma 1,284,106 lekë është tërhequr prej subjektit në datën 24.12.2004 dhe në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar se depozita bankare në shumën e sipërcituar ekziston në formën *cash* në bashkëpronësi me bashkëshorten dhe nënën. Kjo shumë ka vijuar të shtohet me kursimet nga të ardhurat nga pagat dhe pensioni i nënës, për periudhën 2004 – 2009, duke arritur shumën totale prej 2,399,685 lekësh, sipas deklaramit në DIPP-në e këtij viti. Më pas, në vitin 2010, subjekti ka deklaruar pakësimin e kësaj gjendjeje të disponuar *cash* në banesë në shumën 1,873,345 lekë.
29. Lidhur me mundësinë e subjektit për të krijuar kursimet e pretenduara përgjatë kësaj periudhe, për të cilën është kryer analiza e detajuar e kursimeve *cash* në pikën 3 të këtij relacioni, nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1,439,004 lekë, në vitet 2007, 2008 dhe 2009, për krijimin e kursimeve në shumën 2,399,685 lekë në fund të vitit 2009, të cilat më pas janë përdorur prej subjektit për pagesën e apartamentit dhe të automjetit. Për rrjedhojë, duket se subjekti i rivlerësimit, në fund të vitit 2009, mund të dispononte kursime në *cash* me burime të ligjshme financiare, në shumën 960,681 lekë.
30. Në vijim të sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në shumën prej 1,174,422 lekësh¹², për kryerjen e pagesës prej 2,000,000 lekësh, siç është detajuar në tabelën e mëposhtme.

⁹Në këtë përlllogaritje janë përfshirë të ardhurat nga pagat e subjektit dhe nga pensioni i nënës për të gjithë periudhën, ndërsa të ardhurat e bashkëshortes janë përlllogaritur vetëm gjatë vitit 2000, për sa kohë ata janë martuar gjatë këtij viti.

¹⁰Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion një deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.11.2016, të shtetasit H. M., i cili ka deklaruar se me subjektin e rivlerësimit janë vëllezër dhe se prej vitit 1991 e deri në fund të vitit 1999, ai i ka dërguar vëllait të tij nëpërmjet personave të tretë, si dhe personalisht dorazi shumën prej 500,000 lekësh. Gjatë kësaj periudhe ai ka punuar si emigrant i pasiguruar deri në vitin 1996, periudhë në të cilën ka vazhduar të dërgojë shumë pjesore të vlerës së sipërcituar.

¹¹Në këtë përlllogaritje janë përfshirë shpenzimet e jetesës për 2 persona, prej 5,000 lekësh në muaj/person, deri në vitin 1999 (subjekti dhe nëna e tij), ndërsa për vitin 2000 janë përlllogaritur shpenzimet sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it për 4 persona (duke qenë se në vitin 2000 subjekti është martuar dhe ka lindur djalën e tij të parë).

¹²Në këtë analizë janë përfshirë shumat e tërhequra nga subjekti dhe bashkëshortja për periudhën 1.1.2010 – 26.2.2010 (të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes), të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit, kursimet e familjes në gjendjen *cash*, të cilat mund të krijoheshin me burime të ligjshme financiare, shpenzimet e jetesës dhe të shkollimit të fëmijëve (të përlllogaritua këto në mënyrë përpjesëtimore për 2 muaj të vitit), si dhe shpenzimi i kryer për blerjen e automjetit i cili është blerë rreth 2 javë përpara apartamentit.

Tabela nr. 2 – Pagesa e kështit në vlerën 2,000,000 lekë

Tërheqjet janar 2010 - 26.02.2010	183 000
Të ardhura nga pensioni	25 664
Gjendje cash (me burime të ligjshme)	960 681
Shpenzime janar-shkurt 2010	- 143 767
Shpenzim për blerje automjeti	- 200 000
Shpenzim për blerje apartamenti	- 2 000 000
Rezultati	- 1 174 422

b. Lidhur me huamarrjen në vlerën 1,000,000 lekë

31. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010, huamarrjen në shumën prej 1,000,000 lekësh nga shtetasja E. P., me qëllim plotësimin e vlerës për blerjen e apartamentit, duke e deklaruar edhe në rubrikën përkatëse të detyrimeve. Kjo hua është deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*, si burim për krijimin e pasurisë në fjalë. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen pjesore të shumës prej 500,000 lekësh dhe, më pas, në DIPP-në e vitit 2012, ka deklaruar edhe shlyerjen e pjesës së mbetur prej 500,000 lekësh. Për të provuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion një aktmarrëveshje të thjeshtë, të datës 24.2.2010 të nënshkruar mes tij dhe huadhënëses E. P., e cila ka deklaruar se i ka dhënë subjektit të rivlerësimit vlerën prej 1,000,000 lekësh, pa interes, me një afat 3-vjeçar. Më pas, huadhënësja ka lëshuar një deklaratë të thjeshtë në datën 15.12.2011, në të cilën ka deklaruar se ka marrë vlerën 500,000 lekë, si dhe në datën 13.6.2012, ka lëshuar një deklaratë tjetër të thjeshtë, në të cilën ka pohuar se është paguar pjesa e mbetur. Edhe subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012, shlyerjen përfundimtare të huas.
32. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënëses, që kanë mundësuar dhënien e huas në shumën 1,000,000 lekë, në favor të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit ka vënë në dispozicion dokumentacionin sa vijon:
- kontratë qiraje 5-vjeçare me afat 5.2.2010 – 5.2.2015, për dhënien e ambientit “*godinë shërbimi 1 kat*”¹³, kundrejt qirasë 20,000 lekë/muaj;
 - shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2019, të ASHK-së Elbasan, e cila ka paraqitur dokumentacionin mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të shtetasve V. P. dhe E. P.;
 - kontratë sipërmarrje e datës 5.12.2007, në të cilën shtetasi V. P., në cilësinë e sipërmarrësit dhe investitorit merr përsipër ndërtimin e një objekti bodrum + 2 kate lokal + 2 kate banim, në truallin e porositësve N.;
 - leje ndërtimi e dhënë me vendimin nr. ***, datë 8.10.2007, të KRRT-së, shoqërisë ndërtuese “E.” sh.p.k.;
 - kontratë sipërmarrje e datës 25.9.2008, e lidhur mes investitorit V. P. dhe shtetasit A. B., për porositjen e një apartamenti në godinën e sipërcituar në vlerën 50,000 euro, nga të cilat kësti i parë 40,000 euro i është likuiduar investitorit;
 - vendim nr. ***, datë 30.3.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për përcaktimin e trashëgimtarëve të shtetasit V. P., mes të cilëve edhe bashkëshortja e të ndjerit, znj. E. P..

¹³Godinë banimi nr. pasurie ***, të ndodhur në z. k. ***, pranë tregut të fruta perimeve me sip. 115.7 m².

33. Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të lartpërmendur është konstatuar se shtetasi V. P. ka dhënë një truall me sip. 1924 m², për ndërtim shoqërisë “E.” sh.p.k. dhe nëpërmjet kontratës së shkëmbimit nr. ***, datë 12.7.2004, ka përfituar gjithsej 1 bodrum, 4 njësi dhe 5 apartamente në pallatin e ndërtuar në rrugën “E. M.”¹⁴. Nga këto pasuri të përfituara, ka shitur vetëm dy prej tyre, kundrejt çmimit total 7,500,000 lekë¹⁵, përkatësisht me kontratat e datave 2.12.2005 dhe 9.1.2006, ndërsa pasuritë e tjera kanë vijuar të mbeten në pronësi të tij edhe pas dhënies së huas subjektit të rivlerësimit. Ndërsa nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare të huadhënësës dhe të bashkëshortit, nuk është konstatuar ndonjë tërheqje parash prej tyre, përveç depozitimeve të parave dhe shlyerjeve të kredive në bankat e nivelit të dytë.
34. Ndërkohë, vendimi për përcaktimin e trashëgimtarëve të të ndjerit V. P., ka marrë formë të prerë në datën 14.4.2010, rreth 2 muaj pas dhënies së huas subjektit, nga ku duket se zj. E. P. ende nuk ishte bërë titullare e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të bashkëshortit të ndjerë, në momentin e dhënies së huas në datën 24.2.2010. Megjithatë, nga kontratat e shitblerjeve të paraqitura, ka rezultuar se huadhënësja E. P. ka qenë e pranishme në nënshkrim, në cilësinë e bashkëshortes së shitësit V. P. dhe ka dhënë pëlqimin për shitjet e sipërcituara, në vitet 2005 dhe 2006, në shumën totale prej 7,500,000 lekësh. Ndërsa në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2008, nuk është e qartë në çfarë cilësie është bërë shitja nga investitori V. P., nëse shitja është bërë nga shoqëria apo individi, ndërkohë që nuk ka ndonjë cilësim të tij dhe e shoqja nuk ka nënshkruar si e pranishme në këtë shitje. Referuar Kodit të Familjes, pasuria e fituar gjatë martesës prezumohet si pasuri e përbashkët bashkëshortore dhe, për rrjedhojë, edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e këtyre pasurive, administrohen në mënyrë të përbashkët nga të dy bashkëshortët.
35. Në përfundim të sa më sipër, duket se huadhënësja E. P. ka pasur mundësi të dispononte kursime në shumën 1,000,000 lekë, me burim nga të ardhurat nga shitjet e pasurive të paluajtshme prej së paku 3,500,000 lekë, të barabartë me 50% të çmimit.

1.2 Lidhur me blerjen e pasurisë në fjalë nga shtetasi E. L. dhe R. F.

a. Për sa i përket blerjes së apartamentit nga shtetasi E. L., në vitin 2006

36. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se për periudhën shtator 2007 – shkurt 2010 (kur është formalizuar shitja më pas në emër të subjektit), ka banuar në apartamentin në analizë, pa qira. Pasi është pyetur nga Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se bashkëshortja dhe pronari, në atë kohë i pasurisë, z. E. L., janë kushërinj të dytë dhe duke qenë se ky i fundit nuk e përdorte vetë apartamentin, palët ranë dakord që të merrej nga subjekti, për përdorim familjar, pa kundërshtim.
37. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit E. L., për blerjen e pasurisë në fjalë, në vitin 2006, pasi është pyetur nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 15.6.2021, në të cilën shtetasi E. L. ka deklaruar se për qëllime të biznesit të tij të mundshëm dhe arsimore në qytetin e Elbasanit, ka blerë pasurinë nga vjehëri i subjektit. Për të blerë këtë pasuri, shtetasi E. L. ka marrë hua, në fillim të marsit të vitit 2006, nga një i afërmi i tij, z. Th. V.. Ky i fundit, ka bërë deklarinimin e tij në këtë deklaratë për dhënien e huas në shumën 3,500,000 lekë, me burim nga të ardhurat nga emigracioni, të afërmit të tij, z. E. L., shumë

¹⁴Në të njëjtën godinë me pasurinë e blerë nga subjekti i rivlerësimit, objekt analize.

¹⁵Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 2.12.2005, kundrejt çmimit 3,600,000 lekë dhe kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 9.1.2006, kundrejt çmimit 3,900,000 lekë.

kjo e cila iu kthye në vitin 2010, me të ardhurat nga shitja e apartamentit subjektit të rivlerësimit, kundrejt çmimit 3,000,000 lekë dhe 500,000 lekë nga aktiviteti i tij ekonomik.

38. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e tij dhe pala shitëse në deklaratën e sipërcituar, janë shprehur se likuidimi total i çmimit të shitblerjes mes tyre, është kryer në qytetin e Kavajës, në datën 23.2.2010, ndërkohë që duket se ka mospërputhje me datën e marrjes së huas prej subjektit nga shtetasja E. P., e cila daton më 24.2.2010.
39. Komisioni ka verifikuar në faqen zyrtare *online* të QKB-së, mbi aktivitetin ekonomik të z. E. L., nga ku ka rezultuar se ky i fundit ka ushtruar aktivitetin e tij si Person Fizik, prej vitit 2004, në qytetin e Kavajës. Ndërkohë, nuk ka rezultuar ndonjë adresë tjetër e ushtrimit të aktivitetit, në Elbasan, si dhe aktiviteti rezulton të jetë ushtruar prej tij, pa ndërprerje deri në vitin 2014, kur është pezulluar.
40. Po ashtu, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion që të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, mënyrën e dhënies/transferimit të shumës prej 3,500,000 lekësh apo ndonjë dokumentacion i kohës që të provojë marrëdhënien e huamarrjes/huadhënies në vitet 2006 dhe 2010, mes shtetasve E. L. dhe Th. V..
41. Në përfundim të sa më sipër analizuar, duket se: nuk ka ndonjë logjikë ekonomike në investimin e shtetasit E. L. në këtë pasuri, ndërkohë që ushtronte aktivitetin e tij privat në një qytet tjetër dhe nuk ka pasur ndonjë seli të regjistruar në qytetin e Elbasanit; nuk ka përdorur të ardhurat/kursime të tij për blerjen e kësaj pasurie; nuk provohet me ndonjë dokument të kohës marrja dhe kthimi pas i huas të pretenduar nga shtetasi Th. V.; pasuria i është dhënë subjektit të rivlerësimit në përdorim, pa kundërshtim për një periudhë 3-vjeçare; si dhe në përfundim pasuria është shitur te subjekti me një çmim më të ulët se ai i blerjes, duke mos rezultuar me ndonjë fitim nga ky investim.

b. Për sa i përket blerjes fillestare të kësaj pasurie, nga shtetasi R. F., në vitin 2004

42. Subjekti ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e mësipërme, kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie nga vjehëri me datë 22.7.2004. Bashkëngjitur kësaj kontrate gjendet një mandatar-këtimi nr. ***, datë 22.11.2002, sipas të cilës vjehëri i subjektit i ka paguar shoqërisë “E.” sh.p.k., shumën 3,000,000 lekë, me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti për kontratën e datës 22.11.2002, ap. 25, kati 6 teknik, sip. 125 m²”, si dhe një vërtetim nga shoqëria “E.” sh.p.k., datë 10.5.2004, që citon se: “*Vërtetoj se midis shoqërisë ‘E.’ dhe shtetasit R. F. është lidhur kontrata që ky shtetas të blejë banesën me nr. ***, në katin e 5-të të banimit dhe aktualisht banon në këtë banesë*”.
43. Gjithashtu, në vijim të përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të lëshuar nga vjehëri në datën 20.6.2021, në të cilën, ky i fundit, ka bërë me dije se nga fitimet dhe kursimet e tij familjare (për periudhën 1993 – 2002) dhe nga ofertat e sugjerimet shoqërore nga njohjet me shoqëri të ndryshme private, ka fituar pronësinë e apartamentit në fjalë, ku ka paguar shumën 3,000,000 lekë sipas mandatpagesës së sipërcituar dhe shumën 100,000 lekë dorazi, por nuk ka ruajtur dokumentin përkatës.
44. Në vijim të analizës së detajuar të kryer nga Komisioni, në pikën 5 të këtij relacioni, mbi burimet e ligjshme të të ardhurave të vjehërit të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij, - sipas së cilës ata kanë pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për investimin e kryer në vitin 1999 - duket se pas atij investimi, ata nuk mund të dispononin kursime të krijuara më herët, me burime të ligjshme financiare. Për rrjedhojë, Komisioni ka përlllogaritur në këtë fazë, të ardhurat e familjes së vjehërit të subjektit, vetëm gjatë periudhës tetor 1999 – nëntor 2002, për investimin e kryer prej tij, në pasurinë në analizë.

45. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej subjektit të rivlerësimit, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, nga ku ISSH-ja Drejtoria Rajonale Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 10.2.2020, ka bërë me dije se vjehrit i subjektit aktualisht trajtohen me pension pleqërie, duke filluar nga 25.5.2008 dhe 1.1.2010. Nga dosjet e pensioneve përkatëse informohemi se vjehëri i subjektit ka rezultuar i siguruar si i vetëpunësuar përgjatë periudhës 1.06.1993 – 31.12.1996, periudhë kjo e cila është përfshirë në analizën e kryer. Ndërsa vjehëri i subjektit ka qenë në asistencë përgjatë periudhës 15.12.1992 – 16.12.1993, ndërsa për periudhën 1.1.1994 – 31.12.1996, ka paguar vullnetarisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vitin 2009 dhe më pas ka filluar punësimin prej datës 19.3.2003, e cila është jashtë periudhës së analizës.
46. Gjatë periudhës tetor 1999 – nëntor 2002, ka rezultuar se vjehrit i subjektit dhe bashkëshortja, kanë shitur banesën e tyre të ndodhur në Lushnje, me sip. 57 m², nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 18.7.2001, kundrejt çmimit 1,350,000 lekë. Kjo banesë është privatizuar më herët, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 25.1.1994, nga z. R. F., kundrejt vlerës 8,070 lekë.
47. Subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. ***, datë 31.8.2020, të nënshkruar prej bashkëshortes E. M. dhe prindërve të saj, znj. D. F. dhe z. R. F.¹⁶, të cilët kanë deklaruar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit si bashkëpronare e pasurisë së privatizuar, nuk ka pasur asnjë kontribut në këtë banesë (në natyrë apo vlerë monetare) dhe as nuk ka përfituar/pretenduar kompensim nga shitja e banesës së sipërcituar.
48. Në përfundim, nga analiza¹⁷ e burimeve të familjes së vjehrit të subjektit, duket se kanë pasur një pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare në vlerën prej 2,926,824 lekësh, për kryerjen e pagesës në vlerën 3,000,000 lekë, në nëntor të vitit 2002.

Tabela nr. 3 – Analiza e burimeve për blerjen e pasurisë nga vjehri i subjektit

Te ardhura nga shitja e pasurisë ekzistuese		1 350 000
Shpenzime jetese tetor 1999 - nëntor 2002	-	1 226 624
Shpenzim për blerje kamioni	-	50 200
Shpenzim për blerje apartamenti	-	3 000 000
Rezultati	-	2 926 824

49. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me sa më sipër, Komisioni i ka njoftuar subjektin rezultatet e mëposhtme, për të cilat i është kaluar barra e provës:
- a. Duket se pasuria në fjalë është blerë nga subjekti i rivlerësimit me një çmim të barabartë me gjysmën e çmimit të tregut të lirë dhe më pak se çmimi i blerjes së këtij apartamenti

¹⁶QKB-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2020, ka informuar se shtetasi R. F. figuron të këtë qenë aksioner në shoqërinë "T." sh. a. dhe është larguar si aksioner i shoqërisë më 16.11.2016. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2020 ka bërë me dije se për vitet 2009 - 2016 që përkon me periudhën kur shtetasi R. F. ka qenë aksioner i kësaj shoqërie janë shpërndarë dividendë në shumën totale 2,832,490 lekë, nga të cilat shuma prej 283,249 lekësh është tatimi i paguar për to. Referuar ekstraktit të QKB-së, shtetasi R. F. është shtuar si ortak në datën 16.9.2009, kundrejt kontributit në para prej 110,000 lekësh dhe përqindjes në kapital prej 0.74%, nga ku duket se fitimet e përfituara prej këtij të fundit, në përputhje me kuotat e zotëruara, kanë qenë në masën 18,864.38 lekë, të cilat gjithsesi janë të periudhave pas kryerjes së investimeve prej këtij të fundit.

¹⁷Në përlogaritjen e kryer janë përfshirë investimet e kryera prej vjehrit të subjektit të rivlerësimit, në blerjen e mjetit/kamionit në datën 17.1.2002; shpenzimet e jetesës për periudhën tetor 1999 – nëntor 2002, në bazë të frymëve dhe të dhënave zyrtare të INSTAT-it nga viti 2000 deri në vitin 2002 dhe me vlerë 5,000 lekë/person në muaj, për vitin 1999.

edhe nga vetë pala shitëse – madje edhe më lirë se kosto e ndërtimit të tij referuar kostove mesatare të ndërtimit sipas EKB-së – pas një përdorimi pa kundërshtim të këtij apartamenti për një periudhë 3-vjeçare.

- b. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1,839,304 lekë, për krijimin e kursimeve të pretenduara në fund të vitit 2009. Si pasojë e sa më sipër, për të kryer pagesën e shumës 2,000,000 lekë për blerjen e apartamentit, me burim nga kursimet e përbashkëta të familjes, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1,174,422 lekë.
- c. Duket se huadhënësja E. P. ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, për dhënien e huas në shumën 1,000,000 lekë, subjektit të rivlerësimit.
- d. Duket se pasuria në fjalë, ndonëse është blerë më herët nga vjehtëri i subjektit dhe më pas nga i afërmi i tij, z. E. L., nuk është përdorur prej tyre, por vetëm prej subjektit, fillimisht pa kundërshtim për një periudhë 3-vjeçare dhe më pas është finalizuar shitblerja në emër të këtij të fundit.
- e. Duket se pronarët *de jure* të mëparshëm të kësaj pasurie, nuk kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare dhe/apo logjike ekonomike në investimin e kryer prej tyre në këtë pasuri dhe që kjo mund të ketë qenë një pasuri e fshehur e subjektit, e blerë për llogari të tij, nëpërmjet kontratave fiktive, pasi ky i fundit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të paguar/blerë këtë apartament, në vitet 2002/2004.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- 50. Subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, si më sipër, lidhur me konstatimin e parë, mbi diferencën e çmimit në raport me referencën e EKB-së, është shprehur se udhëzimet e vitit 2004 dhe 2010 të EKB-së, nuk kanë pasur qëllim përcaktimin e çmimit të shitblerjes së pasurive të paluajtshme apo kufizimin e palëve në lirinë e tyre për të përcaktuar lirisht të drejtat e detyrimit e tyre kontraktuale (përfshirë edhe çmimin e shitblerjes) dhe nuk rregullojnë marrëdhëniet civile dhe tregtare midis individëve apo personave juridik privatë. Çmimet e blerjes në vitet 2004 (nga shtetasi R. F.) dhe në vitin 2006 (nga shtetasi E. L.) dhe 2010 (prej subjektit), nuk janë të ulëta dhe nuk ka *indicie* për trajtim preferencial apo rrethana në kushtet e konfliktit të interesave për shkak të detyrës. Shoqëria “E.” sh.p.k., ka pasur marrëdhënie kontraktore, për ndërtimin e ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me ish-Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe ish-Ministrinë e Ekonomisë. Kjo marrëdhënie kishte ndodhur përpara se subjekti të vinte në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasanit. Termat dhe kushtet e kësaj marrëdhënie kontraktore, në vitin 2004, janë vendosur jashtë çdo ndikimi të mundshëm.
- 51. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer mbi kursimet e tij në gjendjen *cash*, duke kërkuar rishikimin e të ardhurave të nënës dhe saktësime të kursimeve *cash* sipas shtesave dhe pakësimeve të deklaruara prej tij në deklaratat periodike. Gjithashtu, subjekti është shprehur lidhur me depozitimin e kryer në vitin 2007, të shumës prej 20,000 USD, duke sqaruar se sipas tij kjo shumë ka ardhur në formë bankare nga motra e bashkëshortes, në llogarinë e kësaj të fundit, me qëllim aplikimin për vizë britanike. Pas marrjes së vizës dhe kthimit nga shtetasja M. B., bashkëshortja e subjektit i ka kthyer shumën të motrës. Për llogaritjen e likuiditeteve, subjekti është shprehur se është kryer duke përllogaritur të ardhurat e vitit të deklarimit, duke i shtuar gjendjet e likuiditeteve në *cash* në banesë dhe ato në llogaritë bankare të vitit paraardhës dhe duke i zbritur shpenzimet jetike të vitit përkatës, nga ku sipas rastit ka rezultuar shtesë apo pakësim i likuiditeteve.

52. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka listuar shpenzimet e familjes së tij, të llogaritura për secilin vit, për vitet 2006 –2016. Subjekti ka bërë me dije se këto shpenzime janë përlllogaritur sipas situatës dhe gjendjes faktike të kryerjes së shpenzimeve të konsumit. Sipas tij, presumohet se çmimet e sendeve, shërbimeve të ndryshme dhe të konsumit, nuk referohen në çdo vit apo çdo ditë, praktikës së INSTAT-it dhe as publikimeve të saj ditore. Aq më tepër që INSTAT-i i harton vlerat, në të dhëna të përfituara nga përpunimi i tyre, për të karakterizuar fenomene kolektive në një popullim të dhënë. Statistika zyrtare është informacion sasior dhe përfaqësues për situatën ekonomike në vend. Saktësia e të dhënave i referohet vlerësimeve më të përafërta ndaj vlerave reale sigurisht të panjohura, periudha që i referohet INSTAT-it nuk përputhet në çdo rast me kohën e shpenzimeve faktike/reale/rrethanore dhe të përditshme. Subjekti shprehet se nuk ka vërejtje, që t'i referohen të dhënave të INSTAT-it, por ka kërkuar që të mbahet në konsideratë, vlerësimi i tij se në çdo vit kalendarik, ku ka deklaruar në DIPP të ardhurat dhe gjendjen e mbetur, në çdo fund të çdo viti kalendarik, referuar shpenzimeve përkatëse.
53. Subjekti ka kërkuar përlllogaritjen e investimit fillestar në vlerën 500,000 lekë, për periudhën 28.4.1998 – 28.7 2000 (dhe jo 28.4.2000), konsiderimin se shumatat e dhëna nga vëllai, në periudhën 1991 – 1999, kanë qenë relativisht të vogla dhe mundësia objektive e subjektive për të vërtetuar burimin e krijimit nga vëllai është e vogël edhe për faktin se marrja dhe dhënia midis familjareve, praktikisht është bërë shpesh, pa dokument shkresor. Gjithashtu, subjekti ka kërkuar që në llogaritjet e vitit 2004, të merret në konsideratë shuma 1,284,106.85 lekë e tërhequr nga ish-Banka e Kursimeve dhe jo vlera 1,271,169.17 lekë.
54. Lidhur me dy konkluzionet e fundit të Komisionit, mbi mundësitë financiare të vjehrrit të subjektit dhe të shtetasit E. L., për të mundësuar blerjen e pasurisë në fjalë prej tyre, me burime të ligjshme financiare, subjekti është shprehur se për kohën që janë kryer veprimet, vjehri ka mundur të provojë për aq sa ishte e mundur të përpilojë, të dokumentojë, të ruajë të dhëna për pagesën e detyrimeve bankare të taksave e sigurimeve shoqërore, për të pasqyruar veprimet e pagesave, sipas zakoneve tregtare të kohës, që janë lejuar edhe nga organet tatimore, sigurimet shoqërore dhe organeve të pushtetit vendor. Informacionet dhe aktet që ka paraqitur, sipas subjektit, kënaqin në nivelin diskrecional, për të justifikuar burimet e krijimit të pasurive.
55. Gjithashtu, subjekti pretendon se edhe firma “E.” sh.p.k. ka vërtetuar banimin e shtetasit R. F. para lidhjes së kontratës dhe ky fakt pranohet në mandatarkëtimin e pagesës, datë 10.5.2004, lëshuar me nënshkrimin/vullnetin/dakordësinë/pëlqimin e shitësit dhe blerësit. Vërtetimi i datës 10.5.2004 është akt i krijuar, para miratimit të ligjit nr. 84/2016. Veprimet juridike të ndodhura në vitet 2004, 2006 dhe 2010 dalin nga logjika e thjeshtë e veprimeve të kësaj natyre dhe kanë lidhje me veprimet e tyre parakontraktore, me shkakun, vullnetet/pëlqimet e palëve, me shprehjen lirisht të përmbajtjes të çdo veprimi juridik, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi. Në secilën prej këtyre kontratave presumohet se ka ekzistuar pëlqimi i palëve kontraktore, zotësia për të vepruar, shkakun i ligjshëm në të cilin mbështeten të drejtat e detyrimet e palëve, objekti që formon lëndën e secilës kontratë dhe forma e secilës kontratë noteriale. Z. R. F. ka lidhur me shkrim kontratat, po në vitin 2004, për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, si dhe ka paguar energji elektrike, për këtë banesë, që nga prilli i vitit 2004, pagesë kjo që përputhet me përmbajtjen e vërtetimit të datës 10.5.2004, sipas të cilës ai banonte në këtë banesë, para kohës që të lidhnin kontratën përfundimtare të shitjes. Pasi z. E. L. bleu banesën në vitin 2006, ka lidhur edhe kontratat, po në vitin 2006, për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike. Nuk ka asnjë të dhënë/rrethanë faktike nga ndonjë agjenci tjetër shtetërore apo private, që të provojë se çmimi i përfituar prej z. R. F. (në vitin 2004), z. E. L. (në 2006) apo prej subjektit (në 2010), të jetë nën vlerën e tregut për atë zonë.

56. Në mbështetje të sa ka pretenduar, si më lart, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:
- librezat e energjisë elektrike dhe të ujësjetillësit në emër të vjehrrit R. F. dhe të shtetasit E. L.;
 - mandatin e transfertës bankare nga llogaria e bashkëshortes së subjektit, në favor të motrës së saj;
 - vërtetimet për të ardhurat e nënës nga pensioni dhe të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi ndër vite.

Vlerësimi i trupit gjykues

57. Sa i takon diferencës së çmimeve të blerjes së trefishtë të apartamentit në fjalë - pasi janë shqyrtuar shpjegimet dhe argumentimet e subjektit së bashku me dokumentet e përcjella prej tij, të analizuar këto në harmoni me materialet dhe provat e tjera që Komisioni ka administruar - trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk e ka provuar të kundërtën, pasi citon referencat e EKB-së mbi kostot e ndërtimit, por analiza krahasimore duhet bërë me çmimet e tregut të lirë, për sa kohë ndërtuesit duhet të kenë një marzh fitimi mbi sa kanë shpenzuar për ndërtimin, përndryshe nuk do të përmbushej qëllimi i tyre për të realizuar fitime. Megjithatë, në rastin konkret, vlen të theksohet nga njëra anë fakti që në vitin 2004 vjehrrit i subjektit e ka blerë pasurinë në fjalë edhe më pak sa ishte parashikuar kostoja e ndërtimit¹⁸ dhe nga ana tjetër që, gjithsesi, dinamika e shitblerjeve të kësaj pasurie paraqitet alogjike, pasi ajo konkretizohet me blerjen nga ana e subjektit, jo vetëm me një çmim më të ulët se mesatarja e tregut të lirë, por duke pasqyruar një humbje financiare të shitësit, z. E. L., së paku në vlerën prej 500,000 lekësh – për shkak se e kishte blerë në vlerën 3,500,000 lekë dhe ia shiti subjektit vetëm për 3,000,000 lekë, pasi ia kishte lënë këtij të fundit në përdorim pa kundërshtim për një periudhë pothuajse 3-vjeçare. Nga kjo panoramë, qartësisht dalin me humbje financiare si ndërtuesi ashtu edhe shitësi dhe vetëm subjekti përfiton dukshëm nga kjo marrëdhënie tregtare.
58. Lidhur me shumën 500,000 lekë, të pretenduar si të përfituar nga vëllai i subjektit, ky i fundit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor provues mbi burimin e ligjshëm të shumave në fjalë. Megjithatë, vlen të theksohet se, ndonëse kjo shumë nuk është konsideruar në analizën financiare, si një e ardhur me burim të ligjshëm, ky fakt nuk e ka ndikuar rezultatin final lidhur me mundësinë e familjes së subjektit për të investuar shumën 1,000,000 lekë, me kursime të familjes së subjektit, që gjithsesi kanë rezultuar si të krijuara me burime të ligjshme financiare.
59. Për sa i takon shpenzimeve jetike, Komisioni konfirmon se të dhënat mesatare të INSTAT-it referojnë një nivel minimal në kufirin e mbijetesës dhe, për rrjedhojë, në mungesë të provës së kundërt, nuk konstatohen hapësira diskrecionale për t'i përlllogaritur ato në një nivel akoma më të ulët - për më tepër kur bëhet fjalë për shpenzimet e familjes së një subjekti, që sigurisht ka disponuar të ardhura mbi mesataren e fashës së shoqërisë të analizuar nga INSTAT-i.
60. Lidhur me kursimet e deklaruara, vërehet se, ndonëse, subjekti ka deklaruar në çdo vit shtimin apo pakësimin e likuiditeteve totale, gjithashtu, ka bërë ndarjen e detajuar midis atyre të disponuara *cash* në banesë në fund të vitit paraardhës dhe atyre të gjendura në llogarinë e tij bankare, duke specifikuar, gjithashtu, edhe gjendjen *cash* në fund të vitit

¹⁸Udhëzimit nr. 1, datë 4.3.2004, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave të tregut të lirë të banësive dhe të koeficientit 'K'", çmimi mesatar në tregun e lirë për vitin 2004, ka qenë në vlerën 44,611 lekë/m², çka do të rezultonte në një çmim tregu prej 5,401,946 lekësh, dukshëm më i lartë se çmimi i përshkruar në kontratën e shitblerjes. Për më tepër, ky i fundit duket të jetë edhe nën koston e ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi, i përcaktuar për qytetin e Elbasanit në vitin 2004, në vlerën 27,284 lekë/m², sipas së cilës kostoja e ndërtimit për një sipërfaqe shfrytëzimi prej 121.09 m², ka qenë në vlerën 3,303,820 lekë.

deklarues. Shtesat apo pakësimet në gjendjet e llogarive bankare e pasqyrojnë efektin e tyre nga njëri vit në tjetrin, rrjedhimisht, shtesat apo pakësimet e gjendjes *cash* në banesë janë përlllogaritur në bazë të vlerave specifike të vetëdeklaruar nga subjekti në DIPP-të përkatëse. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit rezultoi i pabazuar.

61. Gjithashtu, Komisioni ka rishikuar të ardhurat e nënës së subjektit dhe bashkëshortes, sipas dokumentacionit që disponohej dhe atij të paraqitur në prapësimet e subjektit dhe nuk janë konstatuar diferenca mes atyre të përlllogaritura në rezultatet e hetimit dhe atyre të paraqitura në provat e reja. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit gjendet i pabazuar.
62. Sa i përket investimit të shumës prej 500,000 lekësh në Bankën e Kursimeve deri më 28.7.2000, ky pretendim ishte konsideruar dhe pranuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, duke e pasqyruar efektin përkatës në rezultatet e hetimit që i janë dërguar subjektit. Gjithsesi, vërehet se data 28.4.2000 përbën datën e fundit të investimit të fondeve me afatin 3-mujor, të përlllogaritur të maturuar në datën 28.7.2000, nga e cila ka rezultuar e njëjta vlerë e të ardhurave të interesave të përfituara me ato të deklaruar prej subjektit.
63. Lidhur me shumën e tërhequr nga ish-Banka e Kursimeve në vitin 2004, Komisioni kishte marrë në konsideratë në përlllogaritjet e kryera vlerën prej 1,284,106.85 lekë, e cila ka rezultuar dhe nga dokumentacioni i administruar dhe nga deklaratimet e subjektit si e tërhequr në muajin dhjetor të vitit 2004. Vlera prej 1,271,169.17 lekësh përbën tepricën e transferuar nga ish-Banka e Kursimeve në kalimin në sistemin në “Raiffeisen Bank” në datën 1.10.2004.
64. Sa i përket depozitimit të kryer në vitin 2007, të pretenduar nga subjekti si garanci për marrjen e vizës britanike nga bashkëshortja, ndonëse në shpjegimet e tij flitet për depozitim nga motra e bashkëshortes dhe/apo kunatit të saj, nga lëvizjet bankare, të administruara dhe të analizuara nga Komisioni, ka rezultuar përshkrimi “E. M. ka derdh në llogari” dhe nuk duket të ketë ndonjë përshkrim tjetër apo depozitim nga të tretë të shumës 20,000 USD. Mandati i transfertës paraqitur nga subjekti përmban vetëm përshkrimin “E. M. kalim në llogari të B. Q.” dhe nuk duket të ketë ndonjë përshkrim apo specifikim të kthimit pas të shumës përkatëse, të pretenduar si të marrë hua më herët nga subjekti. Për më tepër, referuar deklaratimeve të subjektit, në fund të vitit 2006, familja e tij dispononte kursime *cash* në shumën 2,283,641 lekë (mëse të mjaftueshme për të mbuluar depozitim e shumës prej 20,000 USD, konvertuar në 1,662,593 lekë), nga ku duket pa shkak dhe jo bindës pretendimi mbi marrjen e huas *de qua*, kur shumat disponoheshin nga subjekti *cash* në banesë. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, pas pyetjeve të anëtarëve të trupit gjykues, lidhur me këtë veprim, ka shpjeguar se nuk ka qenë në dijeni të këtij veprimi të kryer nga bashkëshortja, pasi është kryer prej kësaj të fundit së bashku me të motrën, në Lushnjë. Edhe kjo rrethanë nuk duket bindëse, që subjekti të mos informohej dhe konsultohej paraprakisht për një vlerë monetare të rëndësishme, përveçse nuk provohen pretendimet e subjektit për marrjen e shumës prej 20,000 USD nga motra e bashkëshortes, nuk duket të ketë as logjikë veprimi i huamarrjes, ndërkohë që disponohej gjendje *cash* në banesë shuma 27,000 USD. Nisur nga sa më sipër, shpjegimet dhe pretendimet e subjektit duken kontradiktore, pa logjikë ekonomike, të paprovuara dhe nuk rezultojnë bindëse.
65. Në përfundim të analizimit të pretendimeve të mësipërme, nisur nga arsyetimet e trupit gjykues nuk konstatohen ndryshime në zërat përbërës të analizës financiare dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për mungesën e burimeve të ligjshme financiare në shumën 1,174,422 lekë, për të kryer pagesën e shumës 2,000,000 lekë për blerjen e apartamentit, nuk ndryshon.

66. Gjithashtu, duket i pabazuar dhe kontradiktor referimi i subjekti në një citim të mandatpagesës së shoqërisë së ndërtimit “E.” sh.p.k., pra: “... vërtetimit të datës 10/5/2004 sipas të cilës R. banonte në këtë banesë, para kohës që të lidhnin kontratën përfundimtare të shitjes...”, pasi për këtë periudhë subjekti ka deklaruar se familja e vjehrrit banonte në Tiranë, ku bashkë me ata ka banuar edhe subjekti për periudha të caktuara. Nuk mund të kuptohet shkaku i banimit në Elbasan i vjehrrit të subjektit, kur familja e tij banonte në Tiranë dhe ai nuk kishte asnjë lidhje me qytetin e Elbasanit, për të jetuar i vetëm atje, për më tepër përpara se të paguhej totalisht çmimi i pasurisë të ndërtuesi dhe/ose përpara se të lidhej kontrata përkatëse. Gjithsesi, në këto kushte, citimi në shkresën e lartpërmendur, sikurse edhe lidhja e kontratave për furnizimin e energjisë elektrike dhe të ujit të pijshëm, nuk mund të provojnë banimin konkret të kësaj banese nga pronarët *de jure*, ndonëse kjo është vetëm njëra nga rrethanat që çoi Komisionin në ngritjen e dyshimeve mbi fshehjen e mundshme.
67. Sa i përket burimeve financiare të përdorura prej blerësve të mëparshëm, vërehet se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion shtesë, përveç atyre të paraqitura përgjatë procesit të rivlerësimit dhe të analizuar përpara se të kristalizoheshin rezultatet e njoftuara subjektit. Lidhur me blerjen e vitit 2004 (të paguar në vitin 2002), nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, evidentohet fakti që përveç dy apartamenteve të blera në vitin 1999 në Tiranë dhe në vitin 2002 në Elbasan, nga hetimi administrativ ka rezultuar dhe një apartament tjetër në Golem, Kavajë, blerë në vitin 2005. Për rrjedhojë, rezultati i Komisionit, lidhur me pamundësinë financiare të familjes së vjehrrit të subjektit, për të blerë këtë pasuri me kursimet e veta, nuk mund të ketë ndryshime dhe kjo rrethanë e gërshetuar me dinamikën e tjetërsimeve të mëtejshme, çon në konfirmimin e dyshimit/konkluzionit të Komisionit se ky apartament është blerë, në vitin 2004 nga z. R. F., për llogari të subjektit dhe me mjetet monetare të këtij të fundit.
68. Lidhur me blerjen e vitit 2006 nga z. E. L., trupi gjykues vëren se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi këtë pikë, përkundrazi nëpërmjet shpjegimeve të tij dhe dokumentacionit të paraqitur, jo vetëm që nuk janë përmbysur rezultatet e njoftuara, përkundrazi është konfirmuar dyshimi mbi fshehjen e pasurisë, duke krijuar plotësisht bindja se z. E. L., jo vetëm që nuk kishte mundësi financiare për të blerë këtë pasuri, por as nuk kishte arsye brenda logjikës ekonomike, ose tjetër interes apo dobi që të blinte pasuri, nëse jo për interesin dhe për llogari të subjektit të rivlerësimit, pasi i vetmi person që ka dalë me përfitim financiar, në sajë të efekteve finale të transaksioneve dhe lëvizjeve të trefishta, të lartpërshkruara, rezulton të ketë qenë, pikërisht, subjekti i rivlerësimit. Ky konkluzion mbështet dhe buron nga një sërë faktesh dhe rrethanash të përshtjelluara edhe mes rezultateve të hetimit, të cilat mund të sintetizohen në këtë mënyrë: (i) z. E. L. nuk ka pasur burime të tijat financiare për të blerë pasurinë në fjalë dhe as nuk e ka përdorur ndonjëherë këtë pasuri, për vete apo për familjarët e tij, apo ta jepte me qira – dhe këto fakte as nuk janë kundërshtuar as nga subjekti; (ii) pretendohet se z. E. L. ka marrë totalisht hua shumë prej 3,500,000 lekë, të pretenduar si të paguar në favor të vjehrrit të subjektit, pikërisht, për një çmim total prej 3,500,000 lekë. Ky pretendim vlerësohet alogjik dhe jo bindës, pasi dikush mund të marrë (pjesërisht) hua për të blerë një pasuri për të cilën ka nevojë të menjëhershme për përdorim familjar, por jo për një send që nuk prodhon asnjë fitim dhe as nuk përdoret vet, por çuditërisht i jepet në përdorim subjektit pakundërshpërblim; (iii) subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të huadhënësit (të pretenduar), por vetëm është shprehur se kishte të ardhura nga puna në emigracion; (iv) nuk është provuar me ndonjë transfertë apo dokumentacion të vitit 2006, as marrja e huas në shumë 3,500,000 lekë, as pagimi i saj në favor shitësit (vjehrrit të subjektit), si dhe as kthimi mbrapsht i huas në vitin 2010; (v) z. E. L. e ka

blerë apartamentin *de quo* për shumën 3,500,000 lekë në Elbasan në vitin 2006, ndërkohë që ka jetuar dhe ka pasur biznesin e tij në Kavajë deri në vitin 2014 dhe e ka shitur në vitin 2010, për shumën 3,000,000 lekë në favor të subjektit, duke humbur së paku 500.000 lekë (pa përlllogaritur mobilimin e apartamentit), “thjesht” për t’i mundësuar subjektit një çmim favorizues, për më tepër, pasi ky i fundit e kishte përdorur pa kundërshtëpërblim këtë pasuri, për periudhën 2007 – 2010, duke jetuar së bashku me familjen e tij; (vi) subjekti i rivlerësimit nuk kishte burime financiare të ligjshme në vitin 2006 dhe as në vitin 2004, vite në të cilët janë kryer transaksionet pararendëse, të lartpërmendura.

69. Në vijim të arsyetimeve dhe analizimeve të mësipërme dhe nisur nga këto fakte: (i) pamundësia financiare e vjehrrit të subjektit në vitin 2004 dhe e z. E. L. në vitin 2006; si dhe nga (ii) mungesa e logjikës ekonomike që mund të justifikonte iniciativën e tyre për të kryer investime në pasurinë në fjalë dhe duke mbajtur në vëmendje se (iii) veprimet e trefishta juridike janë kryer brenda një trekëndëshi të rrethit familjar, midis: vjehrrit të subjektit, z. R. F. dhe z. E. L. – që është kushëriri i bashkëshortes së subjektit; si dhe vet këtij të fundit, i cili rezulton të ketë qenë përfituesi final dhe preferencial i këtyre transaksioneve, pasi është i vetmi që ka përfituar në mënyrë alogjike, për shkak dhe në përfundim të këtyre veprimeve juridike, për sa kohë e ka përdorur pa kundërshtëpërblim këtë pasuri dhe pastaj duke e blerë, pas shumë vitesh me një çmim më të ulët nga blerësit pararendës (3,100,000 dhe 3,500,000 lekë), por edhe më të ulët se sa ishte shitur në vitin 2004, nga shoqëria ndërtuese “E.” sh.p.k., ndërkohë që, asokohe, edhe kjo e fundit me sa duket, lidhur me këtë apartament, ka dalë me humbje, pasi ia kishte shitur vjehrrit të subjektit me një çmim 3,100,000 lekë, më të ulët se kostoja e ndërtimit (që sipas EKB-së ka rezultuar 3,300,000 në vitin 2004). Në këto kushte, trupi gjykues çmon se në mungesë të provës së kundërt, krijohet bindja se subjekti ka qenë pronari *de facto* i apartamentit në analizë prej vitit 2004 dhe se të gjitha veprimet juridike lidhur me këtë pasuri, kanë qenë fiktive dhe janë kryer me porosi, për llogari dhe në favor të subjektit të rivlerësimit, për t’i mundësuar atij: (a) blerjen e këtij apartamenti me një çmim shumë më të lirë se ai i tregut, madje edhe më të lirë se kostoja e ndërtimit; (b) përdorimin e apartamentit pa kundërshtëpërblim për një periudhë rreth 3-vjeçare (2007 – 2010); (c) fshehjen e investimit të tij për këtë pasuri prej vitit 2002 – 2010 (kur janë kryer pagesat), kur është formalizuar tjetërsimi i apartamentit në fjalë në emër të subjektit – duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Për rrjedhojë, nisur nga ky konkluzion, duhet aplikuar pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 5, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë subjekti nuk provoi të kundërtën e rezultatit specifik, që i ishte kaluar si barrë prove.

2. Automjet tip “Mercedes-Benz”

70. Automjeti tip “Mercedes-Benz” është deklaruar për herë të parë prej subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2010, si pasuri e blerë me kontratën e datës 11.2.2010, në shumën 200,000 lekë, por pa përcaktuar burimin e krijimit për blerjen e kësaj pasurie. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhurat, ndër vite, nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe kursimet. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion vërtetimin nr. *** prot., datë 31.10.2016, të DPSHTRR-së Elbasan, që konfirmon pronësinë e automjetit në emër të subjektit të rivlerësimit.
71. Kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 11.2.2010, të nënshkruar mes subjektit dhe palës shitëse V. P., i cili ka shitur automjetin kundrejt çmimit 200,000 lekë. Në kontratë, palët kanë pranuar se automjeti është marrë në dorëzim nga subjekti me të meta dhe, konkretisht, sistemi i frenimit, sistemi i drejtimit dhe xhami i parë i automjetit.

72. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, subjekti është ftuar nga Komisioni, të bëjë me dije mbi shpenzime të mundshme të kryera për këtë automjet, për sa kohë ishte blerë me të meta, të cilat duken thelbësore për funksionimin e një automjeti. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se ka kryer shpenzime në shumën 57,000 lekë, në muajt shtator – nëntor 2010. Së bashku me përgjigjet, subjekti ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë të lëshuar nga “L. M.” person fizik, i cili ka konfirmuar riparimet në automjetin e subjektit, kundrejt pagesës së sipërcituar. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni është konstatuar, se më herët, automjeti ishte blerë nga pala shitëse V. P., me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.3.2008, kundrejt çmimit 800,000 lekë.
73. Për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin e përshkruar në vijim:
- DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 11.2.2020, ka konfirmuar pronësinë e automjetit me targa AA ***, në emër të subjektit të rivlerësimit Bujar Musta dhe ka vënë në dispozicion dosjen e automjetit;
 - kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 11.2.2010, e nënshkruar mes subjektit dhe palës shitëse V. P., për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, kundrejt çmimit 200,000 lekë, me të meta.

Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë

74. Vërehet se automjeti në fjalë është blerë nga subjekti i rivlerësimit rreth 2 javë përpara blerjes së apartamentit në datën 11.2.2010, të trajtuar në pikën 1 të vendimit. Nisur nga analiza e kryer mbi kursimet e disponuara *cash* nga subjekti i rivlerësimit, duket se në fund të vitit 2009, subjekti mund të krijonte me burime të ligjshme financiare kursimet në shumën 960,681 lekë, të cilat duken të mjaftueshme për blerjen e automjetit në shumën 200,000 lekë.
75. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për blerjen e automjetit në fjalë, me burime të ligjshme financiare. Kësisoj, nuk janë gjetur problematika lidhur me burimin e krijimit apo me deklarimin e kësaj pasurie.

3. Gjendje *cash* në shumën 1,300,000 lekë

76. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, gjendje të disponuar *cash* në banesë në shumën 1,300,000 lekë. Sipas deklarimeve, kjo gjendje *cash* ishte krijuar nga kursimet, ndër vite, me burim nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të familjes së tij.
77. Komisioni ka kryer analizën financiare sa i përket mundësisë së familjes së subjektit të rivlerësimit, për të krijuar kursime në *cash*, me burime të ligjshme financiare, duke përllogaritur për çdo vit shumën e tërhequr nga llogaritë bankare të subjektit dhe të bashkëshortes, shpenzimet e kryera nga familja përgjatë vitit përkatës, si dhe përputhshmëria dhe/ose mundësia konkrete për të realizuar - me mjete monetare të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës - kursimet *cash* të pretenduara/deklaruara në fund të secilit vit.
78. Nga analiza financiare, ka rezultuar se deri në fund të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit mund të krijonte kursimet e pretenduara në shumën prej 2,283,641 lekësh, si dhe të përballonte shpenzimet e familjes, me burime të ligjshme financiare nga depozita e tërhequr në vitin 2004 dhe nga të ardhurat e viteve 2005 dhe 2006.
79. Ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se në vitin 2007, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kryer një depozitim në *cash* në “Raiffeisen Bank”, në shumën

20,000 USD (e konvertuar në 1,662,593 lekë), në datën 24.4.2007. Më pas, në datën 7.6.2007, kjo shumë është transferuar në favor të shtetases B. Q..

- 80.** Po ashtu, në datën 27.9.2007, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”, përkatësisht shumat prej 10,000 euro dhe 4,000 USD, të cilat, sipas deklaramentit të tij në përgjigje të pyetësorit nr. 1, kanë shërbyer si garanci për vijimin e procedurave për përfitimin familjarisht të lotarisë amerikane. Këto shuma janë tërhequr, më pas, prej tij në datën 19.12.2007.
- 81.** Në vijim të sa më sipër, nga analiza financiare ka rezultuar se nga shuma totale e disponueshme nga familja e subjektit, gjendja *cash* e vitit të mëparshëm dhe tërheqjet e kryera prej llogarive të tyre bankare deri në datën 24.04.2007¹⁹, pasi janë zbritur shpenzimet e kryera nga familja e tij dhe depozitimi/dhurimi i shumës prej 20,000 USD, duket se subjekti mund të dispononte kursime, me burime të ligjshme financiare në shumën 665,554 lekë, siç është detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. 4 – Kursimet deri në datën 24.4.2007

Tërheqjet janar 2007 - 24.04.2007	226 500
Të ardhura nga pensioni	40 820
Gjendje cash në fund të 2006	2 283 641
Shpenzime jetese janar-prill 2007	- 222 814
Depozituar/transferuar në favor të B.Q.	- 1 662 593
Rezultati	665 554

- 82.** Komisioni ka përllogaritur këto kursime të mbetura pas depozitimit të shumës prej 20,000 USD, së bashku me shumat e tërhequra nga llogaritë bankare të subjektit dhe të bashkëshortes, deri në datën 27.9.2007, pasi janë zbritur shpenzimet e familjes përgjatë periudhës maj – shtator dhe ka rezultuar se nuk mjaftonin për depozitimet²⁰ e kryera nga subjekti, në formën e garancisë për lotarinë amerikane. Sipas detajimit, në tabelën e mëposhtme, duket se subjekti në datën 27.9.2007, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 755,405 lekë, për të kryer depozitimet në ekuivalentin total prej 1,541,220 lekësh.

Tabela nr. 5 – Mundësitë për depozitimin e shumave 10,000 euro dhe 4,000 USD

Tërheqjet 25.04.2007 - 27.09.2007	967 280
Të ardhura nga pensioni maj -shtator	51 025
Kursime të mbetura	665 554
Shpenzime jetese maj-shtator 2007	- 647 293
Shpenzim për tarifën e US Visa	- 250 751
Depozituar garanci për llotarinë amerikane	- 1 541 220
Rezultati	- 755 405

- 83.** Në përfundim të analizës financiare ka rezultuar se në vitin 2007 subjekti ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të kryer të gjitha shpenzimet e

¹⁹Të subjektit dhe të bashkëshortes në bankat e nivelit të dytë.

²⁰Përfshirë dhe një pagesë në shumën prej 3,020 USD, e kryer nga subjekti si tarifë e pakthyeshme për US Diversity Immigrant Visa, sipas shkresës së datës 29.8.2007, të Kentucky Consular Center drejtuar subjektit.

familjes, depozitimet e parave, si dhe rikrijimin e kursimeve *cash* të pretenduara në fund të vitit prej 2,388,044 lekësh, në masën totale -1,155,938 lekë.

84. Po ashtu, në vitet 2008 dhe 2009, duket se të ardhurat e familjes së subjektit dhe të bashkëshortes nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet e tyre, si dhe kursimet e pretenduara. Në fund të vitit 2009, duket se familja e subjektit mund të dispononte kursime *cash* me burime të ligjshme financiare, vetëm shumën prej 960,681 lekësh, të cilat janë ezauruar më pas për blerjen e automjetit dhe apartamentit në vitin 2010.
85. Pas kryerjes së investimeve në pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme në shkurt të vitit 2010, subjekti ka deklaruar edhe pakësimin e kursimeve të disponuara *cash* një vit më herët, në shumën 1,873,345 lekë. Në vitin 2011, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar kthimin e një pjese të huas së marrë për blerjen e apartamentit në shumën 500,000 lekë, e cila referuar deklaratës së thjeshtë të lëshuar nga huadhënësja E. P., është shlyer prej subjektit në datën 15.12.2011. Nga analiza e vitit 2011, duket se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 690,030 lekë, për kthimin e shumës prej 500,000 lekësh huadhënëses dhe krijimin e të gjithë shtesës së kursimeve të deklaruara në atë vit në shumën 430,284 lekë, pas kryerjes së shpenzimeve të tjera të familjes në këtë vit.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare e vitit 2011

Të ardhura të vitit 2011	2 074 614
Likuiditetet në fillim të vitit 2011	528 160
Likuiditetet në fund të vitit 2011	- 958 486
Shpenzime të vitit 2011	- 1 834 318
Shlyerja e huas në 2011	- 500 000
Rezultati	- 690 030

86. Në vitin 2012, subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* nga viti i mëparshëm, në shumën 91,805 lekë, si dhe ka deklaruar, ndër të tjera, edhe kthimin pas të pjesës së mbetur të huas së marrë fillimisht në vitin 2010, në shumën 500,000 lekë, e cila referuar deklaratës së thjeshtë të lëshuar nga huadhënësja, është shlyer prej subjektit në datën 13.6.2012. Komisioni ka përlllogaritur tërheqjet e subjektit dhe të bashkëshortes, deri në këtë datë, të cilat së bashku me të ardhurat nga pensioni të nënës, kanë rezultuar në shumën 913,937 lekë. Pas zbritjes së shpenzimeve për të njëjtën periudhë, ka rezultuar se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 88,464 lekë, për shlyerjen e huas²¹.

Tabela nr. 7 – Analiza e burimeve për kthimin pas të shumës 500,000 lekë në vitin 2012

Tërheqjet janar - 13.06.2012	833 000
Të ardhura nga pensioni	80 937
Gjendje cash të mbetura në fund të 2011	-
Shpenzime janar-qershor 2012	- 502 401
Shlyerja e huas në 2012	- 500 000
Rezultati	- 88 464

87. Në vitin 2013, subjekti ka deklaruar shtimin e gjendjes *cash* nga viti i mëparshëm, në shumën 735,181 lekë. Nga analiza financiare e vitit 2013, ka rezultuar se subjekti mund të përballonte me burime të ligjshme financiare edhe kryerjen e shpenzimeve të familjes edhe krijimin e kursimeve në shumën 735,181 lekë. Në vitin 2014, subjekti ka deklaruar shtimin

²¹Megjithatë, rezultati final i vitit 2012 është pozitiv për shkak të konsiderimit në analizë të të ardhurave të gjithë vitit.

e gjendjes *cash* në shumën 160,474 lekë. Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 549,796 lekë, për të përballuar të gjitha shpenzimet e familjes dhe për të krijuar kursimet e pretenduara, nga ku duket se me burime të ligjshme financiare, mund të dispononte në fund të vitit, vetëm shumën prej 343,779 lekësh. Në vitin 2015, subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes së disponuar një vit më parë në shumën 760,474 lekë. Nga analiza financiare e këtij viti, duket se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të nënës, përfshirë dhe kursimet e vitit të mëparshëm, nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve të deklaruara prej subjektit, pasi ka rezultuar një mungesë financiare në shumën 996,199 lekë.

- 88.** Në vitin 2016, subjekti ka deklaruar shtimin e kursimeve *cash* në shumën 300,000 lekë. Duke përfshirë në analizën e këtij viti tërheqjet e subjektit, si dhe të ardhurat e bashkëshortes si personi fizik, si dhe të ardhurat e nënës së tij nga pensioni, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në shumën 61,232 lekë, për të përballuar shpenzimet e familjes, si dhe realizimin e kursimeve të pretenduara në atë vit prej 300,000 lekësh. Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka pretenduar të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortes në shumën 2,444,659 lekë, ndërkohë që referuar përgjigjes së ardhur nga DRT-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 14.2.2020, duket se fitimi *neto* i aktivitetit ka qenë në shumën 1,896,614 lekë. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë pasqyrat financiare të shoqërisë, të vitit 2016. Subjekti, së bashku me përgjigjet e tij, ka paraqitur një vërtetim të DRT-së mbi qarkullimin e realizuar dhe një vërtetim për kontributet e paguara për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Ky dokumentacion, mbi pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, referuar dhe jurisprudencës së Kolegjtit²², provon pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve të të vetëpunësuarit, por nuk provon përfitimin real të të ardhurave nga pagat dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përfshihen si të ardhura në krijimin e kursimeve familjare.
- 89.** Komisioni ka përlllogaritur, gjithashtu, mundësinë e krijimit të kursimeve përgjatë periudhës 1.1.2017 – 29.1.2017, gjatë së cilës subjekti ka kryer tërheqje nga llogaritë e tij në shumën 126,000 lekë. Pas zbritjes së shpenzimeve jetike për të njëjtën periudhë, ka rezultuar se subjekti mund të kursente gjatë kësaj periudhe shumën prej 26,811 lekësh.
- 90.** Në përmbledhje të të gjithë përlllogaritjeve të kryera më lart, duke i trajtuar veçmas kursimet e çdo viti, ka rezultuar se në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursente me burime të ligjshme financiare, vetëm shumën prej 265,579 lekësh. Nga sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1,034,421 lekë, për kursimet e deklaruara në deklaratën *Vetting* në shumën 1,300,000 lekë. Në tabelën vijuese është pasqyruar informacioni i mësipërm, në mënyrë të përmbledhur.

²²Vendimi nr. 27 (JR), viti 2019.

Tabela nr. 8 – Mundësia e krijimit të kursimeve cash

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjendje e deklaruar në cash	1 284 106	1 084 728	2 283 641	2 388 044	2 353 225	2 399 685	526 340	956 624	864 819	1 600 000	1 760 474	1 000 000	1 300 000
Shtesa/pakësime të kursimeve cash		-199 378	1 198 913	104 403	-34 819	46 460	-1 873 345	430 284	-91 805	735 181	160 474	-760 474	300 000
Të ardhura të nënës së SR		97 259	104 300	122 460	130 110	142 908	153 984	156 546	161 874	166 854	171 048	175 828	182 027
Tërheqje nga banka nga SR		154 278	1 643 500	1 375 000	878 000	1 110 000	1 065 000	1 104 679	1 090 000	1 102 000	1 346 000	1 311 000	1 472 400
Tërheqje nga banka nga b/sh		296 432	280 490	374 520	510 230	109 000	504 600	636 406	635 000	678 650	682 500	0	0
Të ardhura nga aktiviteti b/sh													1 896 614
Investime (Apart & Automjet)							3 200 000						
Marrje & Kthim të huas							-1 000 000	500 000	500 000				
Shpenzime të familjes		716 713	704 661	2 971 116	1 592 954	1 511 118	1 585 483	1 674 318	1 394 561	1 200 124	2 789 792	3 282 732	3 312 273
Tërheqje - shpenzime - kursime		30 634	124 716	-1 203 539	-39 795	-195 670	-188 554	-706 971	84 118	12 199	-750 718	-1 035 430	-61 232
Gjendje cash me burime të ligjshme	1 284 106	1 084 728	2 283 641	1 184 505	1 109 891	960 681	0	0	0	735 181	144 937	0	238 768

91. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur sa më sipër, Komisioni ka konstatuar dhe ka njoftuar subjektit me rezultatin: *Duket se për krijimin e kursimeve prej 1,300,000 lekësh, të deklaruar në deklaratën Vetting, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1,034,421 lekë.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

92. Në lidhje me kursimet e deklaruar, ndër vite, prej subjektit të rivlerësimit, ky i fundit është shprehur se mënyra e tij për llogaritjen e kursimeve në fund të çdo viti deklarues ka qenë pas përllogaritjes së shpenzimeve të familjes së tij. Subjekti ka listuar shpenzimet e përllogaritura prej tij në vitet përkatëse, konkretisht: *“Shpenzimet e familjes për vitin 2006 janë llogaritur në vlerën 800,000 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2007 janë llogaritur në vlerën 1,810,000 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2008 janë llogaritur në vlerën 1,500,000 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2009 janë llogaritur në vlerën 1,500,000 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2010 janë llogaritur në vlerën 4,500,000 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2011 janë llogaritur në vlerën 1,300,000 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2012 janë llogaritur në vlerën 1,500,000 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2013 janë llogaritur në vlerën 1,156,912 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2014 janë llogaritur në vlerën 2,013,575 lekë; shpenzimet e familjes për vitin 2015 janë llogaritur në vlerën 2,287,813 lekë; si dhe shpenzimet e familjes për vitin 2016 janë llogaritur në vlerën 3,740,133 lekë”.*

93. Gjithashtu, subjekti është shprehur se këto shpenzime janë përllogaritur sipas situatës dhe gjendjes faktike të kryerjes së shpenzimeve të konsumit. Presumohet se çmimet e sendeve, shërbimeve të ndryshme dhe të konsumit, nuk i referohen në çdo vit apo çdo ditë, praktikës së INSTAT-it dhe as publikimeve të saj ditore. Aq më tepër që INSTAT-i i harton vlerat, në të dhëna të përfituara nga përpunimi i tyre, për të karakterizuar fenomene kolektive në një popullim të dhënë. Statistika zyrtare është informacion sasior dhe përfaqësues për situatën ekonomike në vend. Saktësia e të dhënave i referohet vlerësimeve më të përafërta ndaj vlerave reale, sigurisht të panjohura, periudha që i referohet INSTAT-it nuk përputhet në çdo rast me kohën e shpenzimeve faktike/reale/rrethanore dhe të përditshme. Subjekti ka kërkuar që pas rishikimit të llogaritjeve, të kihet parasysh vendet ku ka jetuar (sipas deklarimeve në pyetësorin e parë), numrin përkatës të personave sipas periudhave të qëndrimit; fakti që në periudhat që fëmijët kanë qenë të regjistruar në shkollat përkatëse, të zbritet dhe mos merret parasysh si shpenzim, ushqimi apo fjetja e tyre, sipas përgjigjeve dhe akteve të dërguara më parë si prova shkresore. Po ashtu, subjekti është shprehur gjithashtu, mbi të ardhurat e bashkëshortes nga aktiviteti, për vitin 2016, se në DIPP-në e këtij viti, ka deklaruar konkretisht fitimin e aktivitetit në konceptin e tyre, duke zbritur nga

qarkullimi i vitit në shumën 2,630,000 lekë, shpenzimet e kryera, përkatësisht, për pagesat e kontributeve të detyrueshme të të vetëpunësuarit në shumën 163,321 lekë, taksat vendore në shumën 9,020 lekë dhe kartën e avokatisë në shumën 13,000 lekë. Në përfundim të së cilës, sipas tij ka rezultuar një fitim në shumën 2,444,659 lekë. Në fund, subjekti është shprehur se fondi i pagës prej 548,048 lekësh nuk është përlllogaritur në llogaritjet e tyre si shpenzim i aktivitetit, ndonëse në përgatitjen e pasqyrave të aktivitetit, kjo shumë prej 548,048 lekësh është zbritur si i tillë.

Vlerësimi i trupit gjykues

- 94.** Fillimisht, evidentohet fakti se lidhur me metodologjinë dhe standardin e përdorur nga Komisioni për përlllogaritjen e shpenzimeve jetike, vlen edhe në këtë rast sa është arsyetuar nga ky trup gjykues përgjatë analizës së pretendimeve të subjektit në raport me rezultatet e njoftuara për pamjaftueshmërinë financiare për blerjen e pasurisë nr. 1. Kësisoj, Komisioni ndjek të njëjtën logjikë metodologjike dhe përlllogaritje, duke konsideruar lidhur me gjendjet *cash*, deklaratimet vjetore dhe jo ndryshimet e paraqitura nga subjekti përgjatë hetimit administrativ apo të pretenduara pas njoftimit të rezultateve të hetimit.
- 95.** Gjithsesi, për të qartësuar çdo rrethanë, lidhur me shpenzimet e familjes së subjektit, edhe nëse do të aplikohet përlllogaritja e kryer nga subjekti, vërehet se diferenca mes shpenzimeve totale të pretenduara nga subjekti dhe atyre të përlllogaritura nga Komisioni, ndër vite. do të ishte: në vitin 2006 +95,339 lekë; në vitin 2007 +501,477 lekë; në vitin 2008 -92,954 lekë; në vitin 2009 -11,118 lekë; në vitin 2010 -12,243 lekë; në vitin 2011 -534,318 lekë; në vitin 2012 +105,439 lekë; në vitin 2013 -43,212 lekë; në vitin 2014 -556,219 lekë; në vitin 2015 -770,643 lekë; dhe në vitin 2016 +427,860 lekë. Edhe nëse do të përlllogariteshin këto të dhëna, duke mbajtur në vëmendje edhe sa vijon, rezultati mbi burimin e krijimit të kursimeve *cash* të pretenduara në deklaratën *Vetting* në shumën 1,300,000 lekë, do të ndryshonte me një zbutje të pamjaftueshmërisë, nga -1,034,421 lekë në -973,189 lekë.
- 96.** Sa i përket shpenzimeve familjare, si dhe shpenzimeve të fëmijëve, gjatë periudhës së shkollimit, në referencë edhe të jurisprudencës së Kolegjit, në vendimin nr. 8/2021 (JR), datë 9.3.2021, citon se: *“...edhe nëse abstragohet nga ky parim procedural, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shpenzimet e arsimit dhe kujdesit shëndetësor privat në institucione private nuk mund të argumentohen se janë pjesë e shpenzimeve bazike të jetesës. Në kushtet kur të dyja këto shërbime në Republikën e Shqipërisë ofrohen me shpenzime modeste nga institucionet publike, i njëjti shërbim i ofruar nga biznese private është përkufizimisht përtej nivelit bazik të jetesës së marrë për bazë në përlllogaritjet e institucioneve të rivlerësimit sipas informacionit të përcjellë nga INSTAT-i. Në të njëjtën qasje, është alogjike që të zbriten/mos llogariten shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë shtetit, duke i konsideruar të përfshira ato nëpërmjet shpenzimeve jetike të llogaritura nga INSTAT-i. Shpenzimet bazike që përlllogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtuashme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. Për këto arsye, këto pretendime të subjektit u gjetën të pabazuara...”*. Për rrjedhojë, gjenden të pabazuara pretendimet e mësipërme, lidhur me këtë pikë.
- 97.** Gjithashtu, Komisioni ka përlllogaritur uljen e shpenzimeve të jetesës, vetëm në tri raste, të bashkëshortes së subjektit dhe fëmijëve, gjatë periudhave që kanë qëndruar në SHBA për periudha të gjata kohore, gjatë të cilave iu janë përlllogaritur shpenzime të qëndrimit

në SHBA dhe, për rrjedhojë, janë zbritur shpenzimet jetesës të përllogaritura edhe në Shqipëri.

98. Sa i përket të ardhurave të bashkëshortes nga paga si e vetëpunësuar, ndonëse subjektit i është kërkuar bilanci i përgatitur për vitin 2016, të aktivitetit të bashkëshortes, prej tij është paraqitur vetëm deklarata e tatim-fitimit, e cila përmban vetëm zërin e të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat nuk janë të detajuara, për të evidentuar saktësisht nëse shpenzimi i pagës ka qenë i përfshirë. Në shpjegimet e subjektit, të ardhurat e deklaruara në DIPP-në e vitit 2016, të krahasuara me ato të rezultuara nga deklarimi në organet tatimore, diferenca prej 548,048 lekësh, përputhet me totalin e pagave të deklaruara nga bashkëshortja, për të cilat janë paguar kontributet e detyrueshme të të vetëpunësuarit, e provuar kjo edhe nga informacionet e ardhura nga DRT-ja dhe nga ISSH-ja, të cilat u shtuan në analizën financiare. Në përfundim të sa më sipër, rezultati i analizës financiare, për krijimin e kursimeve të pretenduara në deklaratën *Vetting*, në shumën prej 1,300,000 lekësh, do të ndryshonte nga -1,034,421 lekë në -973,189 lekë.

4. Gjendje në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank”

99. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, gjendje në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”, në shumën 697 lekë, me burim nga të ardhurat e tij nga paga. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni është konfirmuar gjendja e mësipërme në llogarinë e tij të pagës, me burim krijimi nga pagat. Ndërkohë, është konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar llogaritë e tjera në valutë të tij, po në “Raiffeisen Bank”, të përdorura prej tij për depozitim e shumave në vitin 2007, me gjendje të mbetur 5.11 euro dhe 3.69 USD. Po ashtu, është konstatuar se në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar llogarinë e bashkëshortes në “Raiffeisen Bank”, në monedhën euro.
100. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me sa më sipër, ka rezultuar se: *Duket se përputhet deklarimi i subjektit në deklaratën Vetting sa i përket gjendjes së disponuar në llogarinë e pagës si dhe është konfirmuar burimi i krijimit me të ardhurat nga pagat, si dhe duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting gjendjet e llogarive të tij në valutë në “Raiffeisen Bank”, si dhe llogarinë e bashkëshortes, po në këtë bankë – ndonëse me gjendje jo të konsiderueshme - ndryshe nga parashikimet e ligjit nr. 84/2016.*
101. Lidhur me problematikat e mësipërme, subjekti ka pretenduar se bëhet fjalë për pasaktësi dhe harresa, pasi shumat në këto llogari ishin të papërfillshme dhe me burime të ligjshme, dhe nuk do të kishte arsye për mosdeklarimin e tyre. Trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit dhe nuk çmon se këto pasaktësi mund të passjellin në vetvete pasojë për subjektin e rivlerësimit.

5. Lidhur me apartamentin në përdorim në rrugën “M. G.”, Tiranë, në pronësi të vjehrrit të subjektit, z. R. F.

102. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka bërë me dije se për periudhat qershor 2000²³ – 31.8.2007, si dhe 1.10.2013 – 1.10.2014, së bashku me familjen e tij ka

²³Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.3.2020, vëllai i subjektit A. M. ka deklaruar se për periudhën 2.5.1997 – 30.11.1997 subjekti i rivlerësimit ka qëndruar së bashku me nënën e tyre në shtëpinë e z. A., pa qira. Po ashtu, ai ka deklaruar se në periudhën dhjetor 1997 – 31.8.2007, si dhe në periudhën 1.10.2013 – 1.10.2014 nëna e tyre ka qëndruar pranë tij pa qira. Sa i përket periudhës kohore dhjetor 1997 – maj të vitit 2000, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion një vërtetim nga shtetasi A. Gj., gjyqtar, i cili ka pohuar se subjekti i rivlerësimit ka jetuar pa qira në ambientet e katit të dytë të Gjykatë së Rrethit Lushnjë.

banuar në banesën në pronësi të vjehrrit të tij R. F.²⁴, ndodhur në rrugën “M. G.”, Tiranë. Për të provuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.1.2020, në të cilën vjehrrin i tij R. F. ka deklaruar se subjekti i rivlerësimit, së bashku me familjen e tij, ka banuar në shtëpinë e tij pa qira, nga qershori i vitit 2000 deri më 31.8.2007 dhe nga 1.10.2003 deri më 1.10.2014, duke i bashkëlidhur certifikatën e pronësisë së apartamentit.

- 103.** Ky apartament ka rezultuar të jetë përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 17.9.1999, nga shoqëria ndërtuese/shitëse “G.” sh.p.k., kundrejt çmimit 3,000,000 lekë. Në këtë kontratë palët kanë deklaruar se kjo shumë është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Gjithashtu, ka rezultuar se për këtë pasuri ka qenë lidhur më herët një kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 7.11.1998, mes të njëjtëve palë, në të cilën ka qenë përcaktuar çmimi prej 2,100,000 lekësh, nga të cilat: *1,000,000 lekë janë paguar më 12.11.1998, do të paguhet 1,000,000 lekë dhe diferenca prej 100,000 lekësh me punë.*
- 104.** Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije mbi periudhat e kryerjes së pagesave në favor të shoqërisë, si dhe burimet e ligjshme të vjehrrit të tij për blerjen e pasurisë në fjalë. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit, subjekti ka paraqitur dy mandatpagesa, përkatësisht të datave 5.11.1998 dhe 12.11.1998, me nga 1,000,000 lekë secila dhe me shënimin se shuma 100,000 lekë do të likuidohet me transport.
- 105.** Lidhur me diferencën midis çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe atij në kontratën e shitblerjes nuk janë dhënë shpjegime, por subjekti është shprehur se: *“Vjehrrin im ka paguar vlerën totale të kësaj banese në favor të kësaj shoqërie, sipas të dhënave e vlerave që përmbajnë kontratat e lidhura midis tyre, kundrejt çmimit të paguar prej tij me mandatarkëtime, paguar dorazi dhe me shërbime të ndryshme transporti në favor të kësaj shoqërie. Vjehrrin ka 2 mandatarkëtime, lëshuar nga kjo shoqëri private në vitin 1998 për këtë apartament, paguar prej tij në vlerën 2,000,000 lekë (nga 1,000,000 lekë për çdo mandat). Pjesa tjetër të detyrimit monetar për këtë banesë është paguar prej vjehrrit tim (sipas shënimeve në mandate), me shërbime të ndryshme transporti dhe dorazi (paguar totalisht para lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes), për pagesa të cilat vjehrrin nuk ka dokumente të plota, pasi i ka humbur dokumentet ose nuk i gjen”.*
- 106.** Duket se nuk është i përcaktuar momenti i pagesës së diferencës prej së paku 900,000 lekë, për sa kohë shuma prej 100,000 lekësh mund të jetë shlyer me transport. Komisioni ka konsideruar në këtë fazë likuidimin e saj maksimalisht në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, më 17.9.1999.
- 107.** Sa i përket burimeve të ligjshme të të ardhurave, subjekti ka shpjeguar se vjehrrin i tij ka privatizuar një mjet transporti kamion, tip “Skoda”, së bashku me rimorkio, me anë të të cilit ka ushtruar aktivitetin e tij privat prej vitit 1993 e në vijim. Subjekti, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur një sërë dokumentesh, të cilat provojnë privatizimin e mjetit të mësipërm, me anë të kontratës së shitjes datë 11.5.1993, për privatizimin e kamionit dhe të rimorkios, kundrejt çmimit total 55,828 lekë²⁵. Janë paraqitur prej subjektit 36 fatura të lëshuara nga shoqëria “V.” sh.p.k., për transporte të ndryshme materialesh të kësaj shoqërie, të kryera nga shoferi R. F. gjatë vitit 1999; 65 fatura të vitit 2000; 108 fatura të vitit 2001²⁶; si dhe 10 fatura të vitit 2002, por nuk është

²⁴ASHK-ja Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2020, ka informuar se shtetasi R. F. (vjehrrin i subjektit) ka të regjistruar pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 75.3 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, të ndodhur në G., Kavajë. Kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 26.2.2005, me palë shitëse shtetasin D. V., kundrejt çmimit 1,950,000 lekë.

²⁵Të paguara prej vjehrrit të subjektit nëpërmjet mandatpagesave të datave 8.5.1993 dhe 11.5.1993.

²⁶Janë paraqitur edhe 3 fatura të lëshuara nga Fabrika e Tullave Kavajë, për transport të tullave në favor të shoqërisë “G.” sh.p.k., gjatë vitit 2001.

paraqitur ndonjë dokumentacion mbi ndonjë të ardhur konkrete të përfituar nga këto shërbime dhe, për rrjedhojë, as pagimi i detyrimeve tatimore mbi to.

108. Subjekti ka paraqitur një kontratë shitblerjeje mjeti të kamionit, me targa TR ***, të datës 30.9.2004²⁷, si dhe një kontratë qiraje për dhënie e kamionit të datës 17.4.2003²⁸, periudha këto të cilat datojnë pas kryerjes së investimeve prej vjehrrit të subjektit, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjnë burim për blerjen e tyre. Po ashtu janë paraqitur dy kontrata punësimi mes vjehrrit të subjektit dhe shoqërisë “G.” sh.p.k., të viteve 2006 dhe 2007, të cilat janë gjithashtu jashtë periudhës së analizës.
109. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, janë paraqitur prej subjektit një librezë kursimesh të vjehrrit të tij pranë “Raiffeisen Bank” dhe një mandat tërheqjeje nga depozita në Bankën e Kursimeve, të cilat datojnë përkatësisht në vitin 2007 dhe në korrik të vitit 2003, të cilat sërish nuk mund të ishin përdorur si burime për pagesat e kryera në vitet 1998 dhe 1999.
110. Nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit, ka rezultuar se vjehri i tij R. F. ka paguar detyrime tatimore mbi biznesin e vogël, në periudhat maj 1993 – dhjetor 1996, përkatësisht në vlerat 49,525 lekë, 79,370 lekë; 95,000 lekë dhe 95,000 lekë. Referuar legjislacionit të kohës, ligji nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, mes të cilëve përfshihet edhe veprimtaria e shërbimit të transportit, këto aktivitete i nënshtroreshin tatimit mbi të ardhurat që realizonin, të cilat përlllogariteshin me tarifa proporcionale apo me kuota fikse. Neni 4 i këtij ligji përcaktonte se personat fizikë që ushtronin veprimtari ambulante e forma të tjera të kësaj natyre, paguanin tatim me kuotë fikse, nga ku për shërbimin e transportit të mallrave për automjetet nga 10 tonë deri në 16 tonë duhet të paguanin tarifën fikse prej 85,000 lekësh.
111. Ndonëse legjislacioni nuk përcaktonte konkretisht masën përpjesëtimore të të ardhurave të realizuara, në bazë të së cilës do të përlllogaritej masa e tatimit për t’u paguar, Komisioni ka konsideruar maksimalisht masën 4 %, nga ku duke u nisur nga shuma e tatimit të paguar prej shtetasit R. F., është kryer një përlllogaritje e xhiros maksimale të këtij aktiviteti, prej 7,972,375 lekësh. Komisioni ka përlllogaritur gjithashtu, në bazë të llojit të aktivitetit, një marzh të fitimit *bruto* prej 60 % të qarkullimit të realizuar, nga ku, pas zbritjes së shumave të tatimit të paguar, ka rezultuar, një fitim *neto* prej 4,464,530 lekësh për periudhën 1993 – 1996.
112. Subjekti ka bërë me dije se, ndër të tjera, vjehri i tij, së bashku me anëtarët e familjes, kanë investuar në ish-firmat piramidale, duke vënë në dispozicion disa mandatarkëtime dhe mandate tërheqje gjatë periudhës tetor 1995 – janar 1997. Nga shqyrtimi i të gjitha mandateve të paraqitura, ka rezultuar se përgjatë periudhës së mësipërme është depozituar shumat prej 1,470,000 lekësh dhe janë tërhequr vetëm 829,081 lekë, si në vijim.
113. Megjithatë, Komisioni, për një informacion më të saktë mbi shumat e investuara dhe përfituara nga familja e vjehrrit të subjektit në ish-firmat piramidale, i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 21.7.2021, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2021, ka bërë me dije se nga kontrolli i bërë në listat dhe dosjet e kreditorëve të shoqërive huamarrëse²⁹, shtetasit në fjalë nuk kanë rezultuar kreditorë.

²⁷Kontratë shitblerje nr. ***, datë 30.9.2004, e lidhur mes shitësit R. F. dhe shoqërisë “G.” sh.p.k., në cilësinë e palës blerëse, kundrejt çmimit 300,000 lekë.

²⁸Kontratë qiraje nr. ***, datë 17.4.2003, e lidhur mes qiradhënësit R. F. dhe shoqërisë qiramarrëse “K.” sh.p.k., kundrejt qirasë mujore 10,000 lekë.

²⁹Fondacioni bamirës “D. P. Xh.”, fondacioni “P.”, A. e K. “Gj.” sh.p.k.

Tabela nr. 9 – Depozitimet dhe tërheqjet në/nga ish-firmat piramidale

Data	Shuma e investuar	Shuma e tërhequr
05/10/1995	- 50,000	
06/10/1995	- 10,000	
28/12/1995	- 20,000	
26/02/1996	- 100,000	
31/07/1996	- 60,000	
02/10/1996		262,000
04/10/1996	- 100,000	
04/10/1996	- 100,000	
16/10/1996		32,000
16/10/1996		131,000
24/10/1996	- 60,000	
07/11/1996		148,081
07/11/1996	- 90,000	
09/12/2016	- 620,000	
30/12/1996		64,000
06/01/1997		192,000
08/01/1997	- 200,000	
13/01/1997	- 30,000	
13/01/1997	- 30,000	
Totali	- 1,470,000	829,081

114. Në vijim të sa më sipër, Komisioni ka përllogaritur deri në shtator të vitit 1999 mundësitë e vjehrrit të subjektit dhe familjes së tij, duke përfshirë edhe shpenzimet e jetesës³⁰ së familjes së tij, për të kryer pagesën e shumës prej 2,900,000 lekësh³¹, në përfundim të së cilës ka rezultuar se kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, së paku prej 921,389 lekësh.

Tabela nr. 10 – Analiza e burimeve për blerjen e apartamentit në vitin 1999

Te ardhura nga aktiviteti 93 - 96	4 464 530
Shpenzime jetese 93 - 99	- 1 545 000
Shpenzim per blerje kamioni	- 300 000
Shpenzim per blerje apartamenti	- 2 900 000
Humbje nga firmat piramidale	- 640 919
Rezultati	- 921 389

115. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se: *Duket se familja e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit ka pasur pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare në shumën 921,389 lekë, për blerjen e pasurisë në fjalë.*
116. Gjithsesi, vërehet se kjo përllogaritje dhe konkluzioni përkatës, ndonëse nuk e ngarkojnë me përgjegjësi subjektin, janë mbajtur në vëmendje nga Komisioni për një vlerësim të përgjithshëm bazuar në elemente dhe informacione gjithëpërfshirëse, siç është cituar edhe më sipër lidhur me pasurinë nr. 1, të blerë nga subjekti, pasi ajo më herët ishte porositur, kontraktuar e paguar nga vjehri i subjektit, i cili ka rezultuar me mungesë të mjeteve monetare me burim të ligjshëm, edhe për faktin se më herët kishte blerë pikërisht këtë apartament ku ka jetuar edhe subjekti i rivlerësimit. Por kjo rrethanë, nisur edhe nga jurisprudenca e Kolegjtit, u vlerësua nga trupi gjykues e pamjaftueshme për të kaluar barrën e provës subjektit dhe/ose për të ngritur dyshime mbi pasurinë në fjalë, sikurse edhe për

³⁰Komisioni ka konsideruar shpenzimet e jetesës për periudhën 1993 – 1996, me 3,000 lekë/personi në muaj, ndërsa për periudhën 1997 – 1999, me 5,000 lekë/personi në muaj, për sa kohë të ardhurat e familjes së vjehrrit të subjektit përgjatë kësaj periudhe rrjedhin nga një aktivitet dhe jo nga punësimi.

³¹Duke konsideruar se shuma prej 100,000 lekësh, për të plotësuar çmimin total prej 3,000,000 lekësh, është paguar me punë.

një tjetër pasuri të vjehrrit të subjektit, për të cilën nuk rezultuan prova mbi përfshirjen e interesave të subjektit apo gëzimin e të drejtave reale prej tij.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

- 117.** Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, lidhur me të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përllogaritja krahasimore e tyre, mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës – sikurse është detajuar dhe arsyetuar më sipër përgjatë analizimit të pretendimeve të subjektit mbi zërat specifikë të analizës financiare në raport me rezultatet e njoftuara nga Komisioni.
- 118.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa i takon kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Musta, nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet e konstatuara dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara, pasi për periudhën 2003 – 2016, pasi janë marrë në konsideratë edhe disa nga pretendimet e subjektit, përfundimisht ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në masën 3,396,728 lekë, i detajuar në aneksin nr. 1 dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se në këtë rast duhet të aplikohet edhe pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	0	284,106	691,494	625,489	-210,124	-35,542	192,372	1,180,366	430,326	-75,592	719,173	160,395	-760,286	315,239
Apartament banimi në Lagjia E. M., Elbasan								3,000,000						
Automjet Mercedes Benz E210, EL**C, vp 1996								200,000						
Ndryshim likuiditeti	0	284,106	691,494	625,489	-210,124	-35,542	192,372	-2,019,634	430,326	-75,592	719,173	160,395	-760,286	315,239
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	1,000,000	1,284,106	1,975,600	2,601,088	2,390,965	2,355,422	2,547,794	528,160	958,486	882,894	1,602,067	1,762,462	1,002,176	1,317,415
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	1,000,000	-500,000	-500,000	0	0	0	0
Hua në shumën 1,000,000 Lekë (E.P)								1,000,000	-500,000	-500,000				
PASURI NETO	0	284,106	691,494	625,489	-210,124	-35,542	192,372	180,366	930,326	424,408	719,173	160,395	-760,286	315,239
Të ARDHURA dokumentuar	994,408	1,530,185	1,428,009	1,424,016	1,605,055	1,523,701	1,545,994	1,630,446	2,074,614	1,904,558	1,891,074	2,201,548	1,526,247	4,037,826
Të ardhura të SR të vërtetuara	691,474	1,205,165	1,032,938	1,033,886	1,062,254	883,135	1,112,061	1,066,053	1,281,085	1,092,014	1,103,316	1,347,332	1,350,419	1,411,137
Të ardhura të B/sh të vërtetuara	219,870	235,056	297,812	285,830	420,341	510,456	291,025	410,409	636,983	650,670	620,904	683,168	-	2,444,662
Të ardhura nënës të vërtetuara	83,064	89,964	97,259	104,300	122,460	130,110	142,908	153,984	156,546	161,874	166,854	171,048	175,828	182,027
SHPENZIME	526,210	565,320	716,713	704,661	2,971,116	1,592,954	1,511,118	1,403,323	1,726,161	1,394,561	1,200,124	2,633,960	3,133,215	3,312,273
Shpenzime jetese	430,210	469,320	547,785	547,785	615,443	683,100	683,100	500,940	574,943	705,120	705,120	944,158	971,863	1,175,460
Shpenzime për arsimimin e fëmijëve					53,000	111,500	114,000	179,500	267,000	270,000	270,000	1,102,199	1,382,780	1,056,340
Shpenzime udhëtimi			72,928	60,876	389,330	698,354	714,018	422,965	609,293	404,841	139,323	374,181	762,732	355,958
Shpenzime servisi për automjetin								57,000	160,000					
Shpenzime mobilimi														708,715
Shpenzime për pagesën e masterit						100,000		242,918	103,725					
Shpenzime për US Diversity Visa					250,751									
Transferuar për B. Q.					1,662,593									
Shpenzime për siguracion automjeti									11,200	14,600	18,650	14,580	15,840	15,800
Shpenzime transporti TR-EL	96,000	96,000	96,000	96,000							67,031	198,842		
Rezultati i analizës financiare	468,198	680,759	19,803	93,866	-1,155,938	-33,711	-157,496	46,757	-581,873	85,589	-28,233	-592,807	-846,682	410,314
CASH në lekë	0	1,284,106	1,084,728	2,283,641	2,388,044	2,353,225	2,399,685	526,340	956,624	864,819	1,600,000	1,760,474	1,000,000	1,300,000
DIFERENCA E PA MBULUAR	-3,396,728													

B. KONTROLLI I FIGURËS

- 119.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit një raport për subjektin e rivlerësimit, me nr. *** prot., datë 2.11.20217, me të cilin ishte konstatuar papërshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Q. Musta.

- 120.** DSIK-ja, me shkresën e datës 11.2.2021, i ka përcjellë Komisionit një raport vijues, duke përfshirë edhe të dhëna dhe informacion shtesë – që referojnë për përfshirje të subjektit në korrupsion pasiv dhe në veprimtari të kundërligjshme, të shfaqura edhe në formën e shpërdorimit të detyrës, në kohështrirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit – në vijim të të cilave, Grupi i Punës së DSIK-së konfirmon konstatimin fillestar për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës të subjektit Bujar Q. Musta. Raporti i lartpërmendur është deklasifikuar pjesërisht në datën 18.3.2021, me vendimin nr. ***, të KDZH-së.
- 121.** Nga ana e trupit gjykues, përgjatë hetimit administrativ, janë aksesuar, analizuar dhe vlerësuar disa materiale dhe informacione të klasifikuara dhe janë kërkuar e administruar disa dosje dhe akte profesionale që lidhen me *indicie*-t e referuara në dokumentacionin e lartpërmendur, dhe konkretisht:
- Dosja gjyqësore me nr. vendimi ***, e vitit 2005, ndaj shtetasit A. C..
 - Dosja gjyqësore me nr. vendimi ***, e vitit 2006, ndaj shtetasit A. (Th.) Q..
 - Dosja gjyqësore me nr. vendimi ***, datë 22.1.2008, ndaj shtetasit S. Ç..
 - Dosja gjyqësore me nr. vendimi ***, datë 26.5.2004, ndaj shtetasit D. T..
 - Dosja gjyqësore me nr. vendimi ***, datë 13.5.2008, ndaj shtetasës Zh. I..
 - Lidhur me çështjen gjyqësore të vitit 2014, me të pandehur shtetasin G. K., nga kërkimi në sistemin informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe zyrën e arkivës, nuk rezulton të ketë gjykim për këtë shtetas.
 - Për sa i takon çështjes gjyqësore në ngarkim të shtetasve E. M. dhe G. M., kjo çështje është në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës.
 - Për sa i takon çështjes gjyqësore në ngarkim të shtetasve L. H. dhe A. E., kjo çështje është në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës.
- 122.** Pasi janë shqyrtuar dhe analizuar këto të fundit edhe në raport me përmbajtjen e informacioneve të klasifikuara, janë konstatuar një sërë rrethanash të cilat, duke i parë në dinamikën e tyre dhe në kontekstin e dosjeve përkatëse, konfirmojnë dhe përputhen, ose së paku nuk përjashtojnë, nga njëra anë se veprimet apo mosveprimet e subjektit të kenë pasur për qëllim favorizimin e individëve të caktuar, dhe nga ana tjetër faktin që këta persona kanë përfituar një trajtim favorizues/preferencial, pra kanë përfituar vendime më të buta se të tjerë subjekte të ligjit që janë gjendur në të njëjtat kushte apo në rrethana të ngjashme – sikurse janë analizuar dhe detajuar në kapitullin vijues, referuar rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, konkretisht: (i) çështja/dosja nr. ***, e përmendur në germën “g” më lart, kundër shtetasit E. M. etj.; (ii) dosja nr. ***, kundër shtetasit G. M.; dhe (iii) dosja nr. ***, kundër shtetasit D. T..

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- 123.** Subjekti, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, ka kundërshtuar konkluzionet e arritura nga Grupi i Punës pranë DSIK-së, duke pretenduar se ka respektuar gjithmonë ligjin, ka dhënë gjithmonë vendimet që i janë dukur më të drejta, nuk është influencuar ndonjëherë nga presionet apo rrethanat e jashtme dhe se gjatë karrierës së tij ka pasur funksione të rëndësishme dhe delikate, ku nevojitej personalitet, besueshmëri dhe ruajtja e të dhënave të klasifikuara apo konfidenciale tejet delikate.
- 124.** Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se figura dhe besueshmëria e tij është verifikuar dhe është konsideruar e pastër nga autoritete të huaja, për sa kohë ka plotësuar formularë të ngjashëm me ato të kontrollit të figurës të paraqitura në DSIK, disa herë ndër vite pranë disa ambasadave të shteteve perëndimore, të cilët e kanë pajisur me vizë turistike dhe, për rrjedhojë, nuk kanë konstatuar problematika në figurën e tij.

Vlerësimi i trupit gjykues

125. Trupi gjykues, pasi ka analizuar konkluzionet dhe informacionet e përcjella nga DSIK-ja dhe ka shqyrtuar përmbajtjen e dokumenteve të klasifikuara dhe konstatimet e organeve ligjzbatuese, duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin e subjektit, çmon se – ndonëse nuk kanë rezultuar prova të qarta lidhur me kontakte të papërshtatshme të subjektit, rrethanë kjo që e bën të pamundur aplikimin e nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 86/2016 – parë në tërësi dhe në kombinim midis tyre të: (i) *indicie*-ve e informacioneve të klasifikuara, të cilat në njëfarë mënyre konfirmoheshin nga (ii) dinamika dhe konkludimi i çështjeve përkatëse; (iii) qëndrimet e subjektit në disa dosje profesionale të shqyrtuara pikërisht në funksion të *indicie*-ve mbi figurën; dhe (iv) shpjegimeve të subjektit jo shteruese dhe jo bindëse, lidhur me rrethana specifike dhe kontradiktore të mënyrës së zgjidhjes së çështjeve dhe *modus operandi* të ndryshëm përballë rrethanave faktiko-ligjore të ngjashme apo të njëjta – përbëjnë elemente që kontribuojnë në konkluzionin e cenimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe që kësaj duhet të mbahen në vëmendje në aplikimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në gërshetim me konstatimet e tjera që mund të prodhojnë paralelisht efekte dhe pasoja të këtij lloji dhe që lidhen edhe me kriterin e pasurisë dhe të aftësive profesionale.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KLD-ja

126. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, ka analizuar raportin e ish-KLD-së, të përcjellë nga KLGJ-ja pranë Komisionit, me shkresën nr. *** prot., datë 16.5.2020, për analizimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të subjektit të rivlerësimit Bujar Musta. Në të janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit, si vijon: (i) aftësitë profesionale; (ii) aftësitë organizative; (iii) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (iv) aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënave nga burimet arkivore të ish-KLD/KLGJ-së.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

127. Subjekti i rivlerësimit Bujar Musta, në datën 30.1.2017, ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë formularin e vetëdeklarimit, gjithsej 3 fletë; 6 dokumente shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit; si dhe 3 dokumente ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të llojit vendim gjyqësor, 2 prej të cilëve i përkasin vitit 2014 dhe 1 vendim i përket vitit 2015. Pas analizimit të dokumentacionit në fjalë, ky institucion, veç të tjerash, ka konstatuar, si më poshtë vijon:
- ❖ *Lidhur me dokumentin nr. 2, gjykimi ka zgjatur 1 vit, pra jashtë afatit standard 6-mujor të parashikuar nga pika 5, germa “b” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.*
 - ❖ *Lidhur me dokumentin nr. 3, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalëve dhe fjalive, por nuk përdoren rregullisht karakteret e gjuhës shqipe. Vendimi*

paraqet vështirësi në kuptimin dhe argumentimin e tij, pasi pjesa përshkruese e arsytuese ka përsëritje, duke rritur volumin e vendimit.

- ❖ *Lidhur me dosjen nr. 1, gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur gjithsej 8 muaj, kohëzgjatja është jashtë afatit standard-6 mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.*
- ❖ *Lidhur me dosjen nr. 4, kohëzgjatja e çështjes nga subjekti i rivlerësimit është në tejkalim të afatit standard 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Ju ftojme të jepni shpjegime për sa më lartpërshkruar.*
- ❖ *Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Bujar Mustaj janë paraqitur 33 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga ku 16 ankesa janë arkivuar në shqyrtimin e tyre paraprak, me arsyetimin se ato janë të përsëritura (8 ankesa) apo se pretendimet zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor të palëve (8 ankesa) dhe 17 ankesa të tjera janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë:*
 - a) *në vitin 2013 në total janë regjistruar 7 ankesa, nga ku: (i) 5 ankesa të vitit 2013 për zvarritje të gjykimit i janë regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik; (ii) 1 ankesë e vitit 2013 për mosrespektim formal të ligjit i është dërguar ministrit të Drejtësisë për vlerësim profesional dhe etik; (iii) 1 ankesë e vitit 2013 për veprimtari të parregullt të gjyqtarit është arkivuar pas verifikimit, me arsyetimin se pretendimet kanë rezultuar të pabazuara;*
 - b) *në vitin 2014 në total janë regjistruar 6 ankesa të vitit 2014 për mosrespektim formal të ligjit, janë arkivuar pas verifikimit, me arsyetimin se pretendimet kanë rezultuar të pabazuara;*
 - c) *në vitin 2015 në total janë regjistruar 4 ankesa, nga ku: (i) 1 ankesë e vitit 2015 për zvarritje gjykimi dhe është arkivuar pas verifikimit, me arsyetimin se pretendimet kanë rezultuar të pabazuara; (ii) 1 ankesë e vitit 2015 për zvarritje gjykimi, në përfundim të verifikimit gjyqtarit i është tërhequr vëmendja me shkrim; (iii) 1 ankesë e vitit 2015 për mosrespektim formal të ligjit është në verifikim në vijim deri në përfundimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë; (iv) 1 ankesë e vitit 2015 për mosrespektim formal të ligjit është në verifikim në vijim deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.*
- ❖ *Në një gjykim penal të drejtpërdrejtë është konstatuar mungesa e mbrojtësit në vleftësimin e arrestit në flagrancë, duke mos respektuar nenin 259, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, si dhe ndërprerja e gjykimit, duke mos respektuar menjëhershmerinë e tij, sipas nenit 400, pika 2, e Kodit të Procedurës Penale (shihni dosjen nr. 3). Ndërsa në 2 çështje civile është konstatuar se nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit, pasi pala e paditur nuk është njoftuar rregullisht për seancën gjyqësore, duke i dhënë vlerë mungesës së saj në seancë përgatitore (shihni dosjet nr. 1 dhe nr. 2). Ndër 5 dosje të vëzhguara është konstatuar se në asnjë rast çështja e gjykuar prej tij nuk është kthyer për rigjykim për shkelje të procedurave gjyqësore.*
- ❖ *Për gjyqtarin Bujar Mustaj janë paraqitur 33 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat janë verifikuar 17 ankesa. Ndër këto ankesa të verifikuara, 5 prej tyre për zvarritje në gjykim i janë regjistruar për vlerësim profesional dhe etik; 1 ankesë për mosrespektim formal të ligjit i është përcjellë ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor; për 1 ankesë për zvarritje gjyqtarit i është tërhequr vëmendja me shkrim.*

Nga ana tjetër, gjyqtarit Bujar Musta i është dhënë masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” për zvarritje në gjykim.

- ❖ *Aftësia e tij për gjykimin e shpejtë të çështjeve është bërë shpesh objekt ankesash. Konkretisht, në 5 raste ankesat i janë regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik, në 1 rast tjetër i është tërhequr vëmendja me shkrim, ndërsa i është dhënë edhe masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim”.*
- ❖ *Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Bujar Musta, përgjatë periudhës së rivlerësimit është regjistruar me aktin nr. *** prot., datë 12.2.2014, kërkesa e ministrit të Drejtësisë për procedimin disiplinor dhe dhënien e masës disiplinore “dërgim 1-2 vjet në një gjykatë të të njëjtit nivel jashtë rrethit gjyqësor ku gjyqtari ushtron detyrën”. Në përfundim të procedimit disiplinor, KLD-ja, me vendimin nr. ***, datë 16.7.2014, ka dhënë masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” për zvarritje në gjykim. Gjyqtari ka ankuar masën disiplinore në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 16.12.2014, ka vendosur “Moskompetencën lëndore dhe dërgimin e akteve për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”. Kjo e fundit ka vendosur “Rrëzimin e padisë”. Gjyqtari Bujar Musta ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, por deri në datën e hartimit të këtij raporti nuk ka dhënë ende vendim mbi çështjen.*

128. Nisur nga sa më sipër është konstatuar, Komisioni, me shkresën nr. *** prot, datë 20.4.2021, iu drejtua Gjykatës Administrative të Apelit, duke i kërkuar dosjen e plotë të vendimit gjyqësor me palë ndërgjyqëse paditës subjektin e rivlerësimit Bujar Musta, i paditur Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

129. Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2021, ka bërë me dije se:

- a. Çështja gjyqësore me nr. ***, datë 13.6.2016, me palë paditëse Bujar Musta, me të paditur KLD, me objekt “ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 14.10.2015, të të paditurit KLD”, është gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit me vendimin nr. ***, datë 13.6.2018, dhe ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 17.3.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, e cila kishte vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë të paditësit Bujar Musta”.
- b. Lidhur me vendimin nr. ***, datë 13.6.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paditur KLD-në, duke kërkuar “Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 14.3.10.2015, të të paditurit KLD, për sa i përket vlerësimit ‘mirë’ dhe në përfundim të vendoset vlerësimi ‘shumë mirë’ për periudhën 2007 – 2009”. Në përfundim, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë”, e cila me vendimin nr. ***, datë 17.3.2016, kishte vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë së paditësit Bujar Musta”. Nga kontrolli në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë ka rezultuar se çështja është në stadin e studimit të çështjes me nr. ***, regjistruar në datën 8.10.2018.
- c. Çështja nr. ***, datë 22.9.2015, me palë paditëse Bujar Musta, të paditur KLD, me objekt “anulimi/shfuqizimi i vendimit nr. ***, datë 16.7.2014, të KLD-së”, për masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Në përfundim, Gjykata e Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 15.3.2016, ka vendosur “Rrëzimin e padisë së z. Bujar Musta si të pa bazuar në prova dhe në ligj”. Objekt i këtij gjykimi është padia e subjektit të rivlerësimit Bujar Musta për kundërshtimin e vendimit nr. ***, datë 16.7.2014, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për dhënien ndaj tij të masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim” për shkelje të disiplinës së konstatuar në veprimtarinë e tij si gjyqtar në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan³². Kjo gjykatë, në vendimin e saj, është shprehur se: “[...] çmon se nuk ka shkaqe për cenimin e vendimit të KLD-së. Gjykata çmon të ligjshme veprimtarinë e zhvilluar nga i padituri në procedimin disiplinor të paditësit në aktet e pranuar për shqyrtim, vlerëson të motivuar në ligj konkluzionin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe masën disiplinore të dhënë”³³.

- d. Në vijim të analizimit të vendimit të sipërcituar, Komisioni ka konstatuar se Gjykata Administrative e Apelit është shprehur se: “[...] gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij gjyqësore në tri rastet e verifikuara është kryer shkelja e rëndë disiplinore ‘zvarritje e pajustificuar dhe e përsëritur e veprimeve procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, kur zvarritja ka pasjellë ose mund të sillte pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë’”, duke konkluduar se nuk ka vend për shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 1.7.2014, të KLD-së për dhënien ndaj paditësit të masës disiplinore “vërejtje më paralajmërim”. Nga kontrolli në sistemin *online* rezulton se çështja është rekursuar në Gjykatën e Lartë, me nr. ***, regjistrimi më 3.6.2016, rezulton me stadin e studimit të çështjes.

C/2. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

- 130.** Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e ish-KLD-së, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe nga organet e tjera ligjzbatuese, si dhe ka analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

B.1. LIDHUR ME KONSTATIMET E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

- 131.** Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2020, i kërkoi informacion KLGJ-së për të gjithë materialin e procedimit ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Musta, lidhur me shqyrtimin e vendimmarrjes në lidhje me çështjen penale me të pandehur shtetasin S. Ç., për aq kohë sa në raportin nr. *** prot., datë 16.5.2018, të KLD-së, për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nuk citohej kjo rrethanë. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2020, vuri në dispozicion aktet, si më poshtë vijon:
- i. vendimin nr. ***, datë 16.12.2011, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; kërkesën për procedim disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me nr. *** prot., datë 24.4.2009, të ministrit të Drejtësisë; pretendimet kundër kërkesës nr. *** prot., datë 29.7.2009, të Ministrisë së Drejtësisë, të z. Bujar Musta;
 - ii. procesverbalin datë 29.7.2009, të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë; procesverbalin datë 14.11.2011, të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë; procesverbalin datë 16.12.2011, të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- 132.** Gjithashtu, KLGJ-ja ka sqaruar se lidhur me faktin se në raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Bujar Musta, me nr. *** prot., datë 16.5.2018, të

³²Ndaj subjektit të rivlerësimit rezulton të ketë filluar procedimi disiplinor në lidhje me tri ankesa të shtetasve: (i) A. M., me nr. ***, datë 15.8.2013, kohëzgjatja nga data e regjistrimit deri në dhënien e vendimit – rezulton një periudhë 5 vjet e më shumë; (ii) Y. B., me nr. ***, datë 4.9.2013 – gjykimi i çështjes ka zgjatur 3 vjet e 2 muaj; si dhe (iii) H. Xh., me nr. ***, datë 11.11.2013 – për këtë çështje konkludohet se nuk është gjykuar nga z. B. Musta, pasi ka dhënë dorëheqjen në datën 13.6.2013, por periudha nga data e kalimit me short të çështjes civile nr. *** të vitit 2009, deri në datën e paraqitjes së kërkesës për dorëheqje nga subjekti i rivlerësimit, rezulton të jetë 4 vjet e 4 muaj në çështje ku rezultojnë të jenë palë ndërgjyqësore.

³³Referuar vendimit të gjykatës, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar procedimi disiplinor për ankesat e sipërcituara dhe pas verifikimit këto rezultate i janë dërguar ministrit të Drejtësisë, kryesisht për zvarritje të gjykimit, mosrespektim formal të ligjit dhe shkelje të etikës.

përgatitur nga KLD-ja, nuk është cituar kjo rrethanë, institucioni ka bërë me dije se: “Sipas detyrimit ligjor, bazuar në nenin 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji’. Gjithashtu, sipas ‘Rregullave për përzgjedhjen me short të 5 dosjeve për analizimin e aftësive profesionale nga Këshillit i Lartë Gjyqësor në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit’, miratuar së bashku me rregulloren e Komisionit, me vendimin nr. ***, datë 7.2.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në aneksin 2, rregullat e shortit, paragrafi 3, përcaktohet se ‘Periudha e vlerësimit e përcaktuar nga Komisioni është siç përcakton literalisht neni 43, pika 3 e ligjit për rivlerësimin, 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji’. Duke mbajtur në konsideratë se kjo periudhë përfshin intervalin kohor 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, edhe raporti i analizimit të aftësive profesionale të këtij subjekti është hartuar për këtë periudhë. Për pasojë, informacioni i dhënë në raportin e cituar nga ana juaj i përket periudhës 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016. Ndërsa procedimi disiplinor i iniciuar nga ministri i Drejtësisë në lidhje me vendimmarrjen për çështjen penale me të pandehur shtetasin S. Ç.

133. etj., i përket vitit 2009, që është jashtë periudhës së analizimit të të dhënave në raportin e rivlerësimit”. Bashkëlidhur materialit janë edhe aktet si vijon:

- i. Mbledhja e datës 29.7.2009, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku në rendin e ditës ka qenë shqyrtimi i procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. Bujar Musta, pika 9; mbledhja e datës 14.11.2011, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku në pikën 13 ka vazhduar shqyrtimi i procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. Bujar Musta, për diskutimin e projektaktit përfundimtar të vlerësimit të Kryeinspektores së Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për gjyqtarin Bujar Musta.
- ii. Mbledhja e datës 16.12.2011, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, vazhdimi i shqyrtimit të projektaktit përfundimtar të vlerësimit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për gjyqtarin Bujar Musta³⁴.
- iii. Me vendimin nr. ***, datë 16.12.2011, pika 14 e tij, është vendosur “rrezimi i masës disiplinore ‘shkarkim nga detyra’”, si dhe pas shqyrtimit të projektaktit të vlerësimit të kryeinspektores vendosi ta vlerësojë “mirë”.

Rrethanat e çështjes për të cilën është kërkuar masa “shkarkim nga detyra”

134. Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë, Drejtoria e Inspektimit të Gjyqësorit, me shkresën me nr. *** prot., datë 24.4.2009, “kërkesë për procedim disiplinor nga gjyqtari Bujar Musta”, i ka kërkuar Presidentit të Republikës, Kryetarit të KLD-së dhe kryeinspektores së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duke parashtruar gjerësisht shkeljet ligjore të subjektit të rivlerësimit Bujar Musta. Në përfundim të shqyrtimit të shkeljeve të kryera nga gjyqtari, në bazë të nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ka kërkuar KLD-së të vendosë “shkarkimin nga detyra”, duke bashkëlidhur edhe materialet shoqëruese, të cilat i kanë kaluar Inspektoratit të KLD-së, për kryerjen e procedurave të mëtejshme ligjore³⁵. Ka rezultuar se Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë, sipas urdhrit nr. *** prot., datë 9.7.2008, të ministrit të Drejtësisë, ka kryer inspektimin e zbatimit të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, gjatë gjykimit të çështjes penale me të pandehur S. Ç., akuzuar për kryerjen e

³⁴Rezultojnë se në këtë mbledhje për shkarkimin e gjyqtarit kanë qenë 2 anëtarë pro shkarkimit dhe 10 të tjerë kanë qenë kundër shkarkimit, duke rrëzuar kështu kërkesën e ministrit të Drejtësisë për shkarkimin e gjyqtarit Bujar Musta.

³⁵Bashkëlidhur shkresa nr. *** prot., datë 28.4.2009, me vendimin nr. ***, datë 22.1.2008 dhe vendimin nr. ***, datë 14.4.2009, të Gjykatës së Apelit Durrës.

veprave penale “vrasje me paramendim” dhe “prodhim e mbajtje pa leje të armëve luftarake” etj. Në përfundim të inspektimit nga kjo drejtori, është dërguar raport-kontrolli për shkeljet e konstatuara gjatë gjyqimit të kësaj çështjeje penale, me shkresën nr. ***, datë 10.9.2008, në të cilën parashikohej edhe dërgimi i observacioneve.

135. Në përmbledhje të shkeljeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit Bujar Musta, sipas këtij relacioni, ka rezultuar si vijon:

- i. *Ka treguar pamjaftueshmëri të dukshme profesionale në zbatim të ligjit procedural, duke dhënë vendime në kundërshtim me ligjin shoqëror me pasoja të rënda, duke mos zbatuar urdhërimet e dispozitave procedurale penale, ka sjellë pasoja të rënda në veprimtarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke cenuar dhe ulur autoritetin e organeve të drejtësisë.*
- ii. *Në tërësinë e tyre, veprimet e mësipërme të gjyqtarit Bujar Musta gjatë ushtrimit të detyrës janë veprime të cilat cenojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, në kuptim të nenit 147, pika 6 e Kushtetutës, dhe përbëjnë shkak për procedimin ndaj tij. Shkeljet e kryera apo të lejuara konsistojnë në moskryerjen e veprimeve të cilat ishte i detyruar t'i kryente për përmbushjen e rregullt të detyrës, me veprimet apo me mosveprimet e veta ka favorizuar në mënyrë të njëanshme të pandehurit, duke cenuar besueshmërinë e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.*
- iii. *Gjyqtari Bujar Musta, në gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve S. Ç., J. Xh. e F. M., ka shkelur urdhërimet e neneve 131/2, 149, 152, 357, pikat 1 e 2, 362/4, 366,367,383, pika 1, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale.*
- iv. *Moszbatimi nga ana e gjyqtarit i urdhërimeve të neneve 131/2, 149, 152,357, pikat 1 e 2, 362/4, 366, 367,383, pika 1, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale në gjykimin e të pandehurve është kryer me dashje, pasi në tërësinë e provave shkresore të administruara në dosjet gjyqësore vërtetohet ekzistenca e rrethanave të cilat kanë qenë evidente dhe shumë të qarta për gjykatësin, por qëllimisht nuk janë analizuar nga ana e gjyqtarit Bujar Musta. Qëndrimi i mbajtur tregon për një pamjaftueshmëri profesionale të gjyqtarit, si dhe përbën një diskreditim të rëndë të pozitës dhe figurës së gjyqtarit.*
- v. *Referuar sa më sipër është përshkruar, ministri i Drejtësisë i ka propozuar KLD-së procedimin disiplinor të gjyqtarit Bujar Musta, si dhe në përfundim të shqyrtimit të shkeljeve të kryera nga gjyqtari, bazuar në nenin 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, t'i kërkojë KLD-së të vendosë “shkarkimin nga detyra”.*

B.2. DISA KONSTATIME TË TJERA NË DOSJEN PROFESIONALE

136. Në vijim të hetimeve administrative, Komisioni ka konstatuar se në dosjen profesionale të ardhur nga KLD-ja rezulton të jetë procesverbali me nr. *** prot., datë 6.4.2018, “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së 5 dosjeve për subjektin e rivlerësimit Bujar Musta”, bashkëlidhur të cilit evidentohet materiali i formatit të marrë nga posta elektronike³⁶, në të cilin bëhet me dije se: “Sistemi i regjistrimeve audio të seancave gjyqësore është implementuar në gjykatë në 30 janar të vitit 2013. Nga kjo datë deri në fund të vitit 2017 regjistrimet audio të seancave bëheshin vetëm në dy sallat penale, të vetmet në gjykatën e vjetër të Elbasanit. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së sallave, regjistrimet audio janë bërë kryesisht për çështje penale, por edhe në disa raste për çështje civile, kur është kërkuar nga palët. Pjesa më e madhe e çështjeve civile janë zhvilluar në

³⁶Posta elektronike e kryeinspektore M. Xh., me lëndë “informacion për përdorimin e sistemin audio në Gjykatën e Elbasanit”.

zyrat e gjyqtarëve, ku nuk ishte instaluar sistemi për regjistrimin audio të seancave. Që nga janari i vitit 2018, me fillimin e punës në gjykatën e re, të gjitha seancat gjyqësore zhvillohen me sistem audio, të instaluara në të gjitha sallat e gjykatës”.

B.3. LIDHUR ME INFORMACIONIN E ARDHUR NGA PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

- 137.** Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. *** prot., datë 5.3.2020, dhe me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2021, ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme, drejtorinë gjyqësore, se nuk rezulton që në emër të shtetasit Bujar Musta të jetë regjistruar ndonjë procedim penal, duke bërë gjithashtu me dije informacionin, si më poshtë vijon:
- a. Nga verifikimet e kryera rezulton se emri i shtetasit Bujar Musta është përmendur gjatë kryerjes së hetimeve në kuadër të procedimit penal nr. *** të vitit 2019, i cili ka ardhur për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme kundër Krimit të Organizuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Ky procedim është në fazën e hetimit dhe nuk ka emër të regjistruar.
 - b. Ndaj këtij shtetasi është regjistruar në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kallëzimi penal nr. *** i vitit 2019, për të cilin pas verifikimit është vendosur “mosfillimi i këtij procedimi”.
 - c. Pas verifikimit të regjistrimit të njoftimit të veprave penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk rezulton që në emër të shtetasit Bujar Musta të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.
 - d. Nga verifikimet e kryera rezulton se emri i shtetasit Bujar Musta është përmendur gjatë kryerjes së hetimeve në kuadër të procedimit penal nr. *** të vitit 2014, për të cilin pas përfundimit të hetimeve është vendosur “pushimi i procedimit”, datë 24.6.2015, informacioni i konfirmuar edhe nga shkresa nr. *** prot., datë 1.7.2021, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
 - e. Ndaj këtij shtetasi është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda kallëzimi penal nr. *** i vitit 2018, për të cilin pas verifikimit është vendosur “mosfillimi i këtij procedimi”.
 - f. Nga verifikimet e kryera rezulton se emri i shtetasit Bujar Musta është përmendur në kallëzimin penal nr. *** të vitit 2019, për të cilin pas verifikimit është vendosur “mosfillimi i këtij procedimi”.
- 138.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2020, ka informuar se nga verifikimi dhe kërkimi i bërë (për vitet e fundit) në regjistrat përkatës të saj për shtetasin Bujar Musta, rezulton si vijon:
- a. Rezulton të jenë regjistruar materialet hetimore nr. ***, datë 28.4.2010, të cilat janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Kavajë në datën 5.5.2010.
 - b. Janë regjistruar materialet hetimore nr. ***, datë 18.5.2010, të cilat janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Kavajë në datën 28.5.2010.
 - c. Janë regjistruar materialet hetimore nr. ***, datë 16.9.2010, të cilat janë dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë në datën 16.9.2010.
- 139.** Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, me shkresën nr. ***, datë 24.2.2020, ka informuar se për subjektin Bujar Musta rezulton ankesa nr. *** prot., e vitit

2018, e shtetasit Z. B.³⁷; ankesa nr. *** e vitit 2013, e shtetasit D. M.³⁸; dhe ankesa nr. *** e vitit 2016, e shtetasit A. E.³⁹.

140. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2020, ka informuar së nuk është proceduar dhe nuk rezultojnë të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë për fillimin e hetimeve dhe nuk rezultojnë të dhëna të identifikimit të subjektit në kontakte të papërshtatshme.
141. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 22.4.2020, ka informuar se nga verifikimi i kryer në regjistrat e kallëzimeve penale dhe statistikave elektronike të procedimeve penale për periudhën 2009 – 2019, ka rezultuar se janë regjistruar gjithsej 5⁴⁰ kallëzime penale, për të cilat është vendosur “mosfillimin e procedimit”.
142. Nga sa më sipër, në vijim të hetimit administrativ, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., ka kërkuar pranë prokurorisë dosjet penale, si vijon:
 - a. Fashikullin penal që i përket procedimit penal nr. ***, “Për pushimin e procedimit penal nr. ***” nga shtetasit K. S. dhe B. P.. Nga shqyrtimi i materialit të dosjes penale evidentohet se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit kanë ekzistuar dyshime se kishte konsumuar dhe vazhdonte të kryente vepra penale “të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, etj.”, ku pas shqyrtimit është vendosur “pushimi i procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”.
 - b. Fashikulli penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, që i përket kallëzimit nr. ***, me datë regjistrimi 8.3.2018, të shtetasit T. Z., i cili ka kallëzuar shtetasin Bujar Musta, që sipas tij ka kryer veprat penale “shpërdorim detyre”, “shkelje të barazisë së shtetasve”, “korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, për të cilin është vendosur “mosfillim i hetimeve për kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2018.
 - c. Kallëzimi penal nr. ***, i datës 6.2.2019, i regjistruar pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për të cilin është vendosur më 6.2.2019, “mosfillimi i procedimit penal nr. ***, datë 6.2.2019, pasi fakti nuk ekziston”, i shtetasit E. B., për të cilin është njoftuar edhe kallëzuesi.
 - d. Fashikulli i kallëzimit penal nr. *** të vitit 2019, nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për kallëzimin e shtetasit B. I., i cili është përfunduar me vendimin nr. *** të “mosfillimit të procedimit penal”.
 - e. Kallëzimi penal nr. *** i vitit 2016, për të cilin nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur “mosfillimi në datën 30.12.2016”, sa i përket kallëzimit penal të dosjes së ardhur nga Elbasani me nr. ***, volumni ***, që i përket kallëzimit penal të shtetasit A. E..

³⁷Shtetasi Z. B. ka depozituar kallëzimin penal “shpërdorim detyre” ndaj subjektit të rivlerësimit Bujar Musta.

³⁸Shtetasi D. M. ka kallëzuar subjektin e rivlerësimit për veprën penale “zhdukje ose humbje e fashikullit”, procedimi penal nr. ***, datë 31.7.2013, për të cilin është vendosur më 5.11.2013 “pushimi i çështjes”. Kallëzuesi D. M. ka kundërshtuar në gjykatë vendimin e pushimit, e cila me vendimin nr. ***, datë 13.1.2013, ka vendosur të deklarojë moskompetencën, pasi i kallëzuar ka qenë Bujar Musta, duke e transferuar këtë dosje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

³⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2016, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Task-Forcë, ka informuar se është regjistruar me nr. *** prot., datë 20.9.2016, kallëzimi i shtetasit A. E., kundrejt shtetasve Bujar Musta dhe M. Ç..

⁴⁰Kallëzimi nr. *** i vitit 2014, i shtetasit P. P., vendosur mosfillim më 5.11.2014; kallëzimi nr. *** i vitit 2014, i shtetasit Y. M., vendosur mosfillim më 16.7.2014; kallëzimi nr. *** i vitit 2014, i shtetasit Y. M., vendosur mosfillim më 29.7.2014; kallëzimi nr. *** i vitit 2015, i shtetasit B. I., vendosur mosfillim më 12.10.2015; dhe kallëzimi nr. *** i vitit 2016, i shtetasit A. E., vendosur mosfillim më 31.12.2016.

B.4 LIDHUR ME DOSJET E ARDHURA NGA GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

- 143.** Nisur nga informacione nga organe të tjera ligjzbatuese, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.2020, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan disa dosje gjyqësore, e cila, me shkresën nr. *** prot., datë 22.10.2020, ka vënë në dispozicion dosjet, si vijon:
- a. Dosja gjyqësore nr. *** vendimi e vitit 2005, ndaj shtetasit A. C..
 - b. Dosja gjyqësore nr. *** vendimi e vitit 2006, ndaj shtetasit A. (Th.) Q..
 - c. Dosja gjyqësore nr. *** vendimi, datë 22.1.2008, ndaj shtetasit S. Ç..
 - d. Dosja gjyqësore nr. *** vendimi, datë 26.5.2004, ndaj shtetasit D. T..
 - e. Dosja gjyqësore nr. *** vendimi, datë 13.5.2008, ndaj shtetasve Zh. I..
 - f. Lidhur me çështjen gjyqësore të vitit 2014, me të pandehur shtetasin G. K., nga kërkimi në sistemin informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe zyrën së arkivës, nuk rezulton të këtë gjykim për këtë shtetas.
 - g. Për sa i takon çështjes gjyqësore në ngarkim të shtetasve E. M. dhe G. M., kjo çështje është në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës.
 - h. Për sa i takon çështjes gjyqësore në ngarkim të shtetasve L. H. dhe A. E., kjo çështje është në gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës.
- 144.** Më tej, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2020, vuri në dispozicion dosjen civile nr. ***, datë 1.2.2019, me palë paditëse G. M. dhe të paditur N. M., me objekt “ zgjidhje martese”, si dhe dosjen civile nr. ***, vendimi, datë 25.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me palë paditëse G. M. dhe N. M.. Në referim të sa më sipër është përshkruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2021, iu drejtua Gjykatës së Apelit Durrës për vënien në dispozicion të dokumentacionit⁴¹, e cila, me shkresën nr. *** prot, datë 22.4.2021, ka informuar se:
- a. Lidhur me çështjen civile me palë ndërgjyqëse paditëse M. M. dhe E. M. me objekt “zgjidhje martese” pas përfundimit të gjykimit dosja është dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në datën 28.12.2020.⁴²
 - b. Ndërsa, për çështjen civile me palë L. H. dhe të paditur A. E., pas përfundimit të gjykimit, në Gjykatën e Apelit Durrës, në datën 16.1.2014, i është dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- 145.** Nga studimi i dosjeve dhe dokumentacionit në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka rezultuar si vijon:
- 146. Dosja nr. 1** – lidhur me shqyrtimin e dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. *** të vitit 2005, ndaj shtetasit A. C., rezulton së vendimi është dhënë nga trupi gjyqësor i përbërë nga Bujar Musta, A. K. dhe E. M., të cilët kanë gjykuar të pandehurin A. C., për veprën penal “shfrytëzim prostitucioni”, parashikuar nga neni 114/a - 4,5 i Kodit Penal⁴³, të cilët në përfundim, me vendimin nr. *** akti, ***, datë 7.7.2005, kanë vendosur “deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A. C., për akuzën e kryerjes së veprës penale ‘shfrytëzim të

⁴¹Vendimet dhe proces verbalet për 2 çështjet civile me objekt “zgjidhje martese” të vitit 2019 me palë ndërgjyqëse E. M. (tek njëra) dhe shtetasi G. M. (tek tjetra), si dhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan procesverbalet e seancave gjyqësore, vendimet dhe fletë -thirrjet drejtuar personave të tretë lidhur me çështjen me palë shtetasen L. H. dhe shtetasin A. E..

⁴²Periudha e dërgimit të kësaj çështjeje është më shumë së 1 muaj më vonë nga kthim përgjigjja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

⁴³Kodi Penal i pa ndryshuar i viti 2004, neni 114/a -4,5, përcakton: “ Shfrytëzim prostitucioni i kryer me ‘mashttrim, shtrëngim, dhunë ose duke përfitur nga paafëzia fizike ose mendore e personit, pika 5, ndaj një personi qe shtyhet ose shtrëngohet për të ushtruar prostitucionin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

prostitucionit në rrethana rënduese’, heqjen e masës së sigurimit ndaj këtij të pandehuri, duke urdhëruar lirimin e tij”. Ky vendim rezulton të jetë ankimuar nga Prokuroria e Apelit Durrës, duke kërkuar “ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 8.7.2005, duke deklaruar fajtor shtetasin A. C. dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim”. Ka rezultuar se Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 6.2.2006, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 8.7.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dërgimin e saj për gjykim me një tjetër trup gjykues”. Gjykata, në analizimin e vendimit, ka prishur vendimin pasi ka konstatuar se vendimi është pasojë e “[...] shkeljeve procedurale që kanë të bëjnë me dispozitivat që lidhen me kushtet për qenien gjyqtar në çështjen e mësipërme e për pasojë, bazuar në nenin 428/ç të Kodit të Procedurës Penale, vendimi duhet të priset pasi: ‘I pandehuri A. C. është deklaruar fajtor për veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit, me vendimin nr. ***, datë 23.12.2003’, ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Durrës, duke e kthyer çështjen për rigjykim. Rigjykimi i çështjes ka filluar me trupën gjyqësore të përbërë nga Bujar Musta, A. K. dhe A. B.. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, në bazë të nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka tërhequr dosjen, e ku në kuptim të nenit 377 ka tërhequr akuzën. Në këto kushte, gjykata me trupën gjyqësore të sa më sipërcituar, me vendimin nr. ***, datë 25.5.2004, ka vendosur ‘Kalimin e akteve të dosjes me nr. ***, Prokurorisë së Rrethit Elbasan, me arsyetimin se është e pamundur vazhdimi i këtij gjykimi dhe dhënia e një vendimi pushimi apo pafajësie, në gjendjen që janë aktet”.

- 147.** Pas dhënies së këtij vendimi, organi i akuzës ka sjellë përsëri në gjykim të pandehurin për akuzën e parashikuar në dispozitat e nenit 114/a-4-5 të Kodit Penal, për të cilin gjykata është shprehur me vendimin nr. ***, datë 8.7.2005 se: “Në rastin konkret konstatohet se gjyqtarët B. Musta dhe A. K., si anëtarë të trupës gjyqësore, kanë pasur pengesë ligjore për marrjen pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje, pasi në vendimin nr. ***, datë 25.5.2004, kanë shfaqur mendimin për objektin e procedimit, duke i kaluar aktet prokurorit, sikurse është përshkruar më sipër”. Gjykata e Apelit Durrës ka vlerësuar se duke qenë se ndodhemi përpara një shkeljeje të tillë procedurale që ka të bëjë më formimin e trupit gjykues, pretendimet e prokurorit dhe të mbrojtjes nuk mund të merren parasysh, meqenëse jemi përpara akteve absolutisht të pavlefshme, parashikuar nga neni 128/a i Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, dhe pas këtij arsyetimi, Gjykata e Apelit Durrës ka prishur vendimin nr. ***, datë 8.7.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- 148.** Në rigjykim, ky vendim është gjykuar nga trupa gjyqësore e përbërë nga D. Sh., P. F. dhe K. Ç., të cilët, pas shqyrtimit të dosjes penale, kanë arritur në përfundimin se shtetasi A. C. nuk ka shfrytëzuar apo detyruar dëshmitaren K. G. në “veprimtari antiligjore” duke vendosur “deklarimin e pafajshëm të të pandehurit A. C. për kryerjen e veprës penale ‘shfrytëzim prostitucioni-heqjen e masës së sigurimit etj.’”. Ky vendim është ankimuar nga prokuroria dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 9.7.2007 ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.
- 149.** Nga sa më sipër përshkruar, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe trupa gjyqësore kanë pasur pengesë ligjore për marrjen pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje, pasi në vendimin nr. ***, datë 25.5.2004, kanë shfaqur mendim për objektin e procedimit, duke i kaluar aktet e prokurorit, në bazë të nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale, ashtu sikurse është shprehur edhe Gjykata e Apelit Durrës në vendimin nr. ***, datë 6.2.2006, ku ka cituar se: “Meqenëse ndodhemi përpara një shkeljeje të tillë procedurale, që ka të bëjë me formimin e trupit gjykues, pretendimet e prokurorit e pretendimet e mbrojtjes, për lënien në fuqi të vendimit, nuk mund të merren parasysh, meqenëse jemi përpara akteve absolutisht të pavlefshme, parashikuar nga neni 128/a i Kodit të Procedurës Penale, ku

thuhet se 'aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete'".

- 150.** Në vijim dhe në lidhje me sa më lart, në mbyllje të hetimit administrativ, Komisioni i ka njoftuar subjektin rezultatin si vijon: *“Duket se është shkelur parimi kushtetues për zhvillimin e një procesi të rregullit ligjor nga një gjykatë e paanshme, pasi pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në gjykimin e çështjes duket se ka cenuar objektivitetin dhe paanësinë e gjykatës në gjykimin e çështjes, edhe pse gjatë rigjykimit të kësaj çështjeje është rikonfirmuar ‘deklarimi i pafajshëm i të pandehurit’”.*
- 151. Dosja nr. 2** – që i përket vendimit nr. *** të vitit 2006, ndaj shtetasit A. (Th.) Q.. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 8.5.2006, të dhënë nga gjyqtarja P. F., ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit Th. Q.⁴⁴ për veprën penale ‘prodhim dhe mbajtje armëve pa leje’”, duke e dënuar me 7 muaj e 15 ditë burgim, si dhe “deklarimin fajtor të shtetasit K. Q. për veprën penale ‘prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve’”, duke e dënuar përfundimisht me 4 muaj e 15 ditë burgim. Gjykimi i çështjes është zhvilluar sipas rregullave mbi gjykimin e shkurtuar. Vendimi i sipërcituar është ankimuar nga Prokuroria e Apelit Durrës, në të cilin janë parashtruar edhe pretendimet e të pandehuri Th. Q., i cili ka kërkuar një masë dënimi më të ulët. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 11.1.2006, dhe ka vendosur “Mospranimin e ankimit për vendimin nr. ***, datë 8.5.2006, pasi nga materialet që rezultojnë në dosje shtetasi e kishte kryer dënimin, e si rrjedhojë, nuk kishte rënë shkak për të cilin ishte bërë ankimi”.
- 152. Dosja nr. 3** – që i përket vendimit nr. ***, datë 22.1.2008 ndaj shtetasit S. Ç.. Në dosjen gjyqësore ndodhet diskutimi përfundimtar i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila ka kërkuar deklarimin fajtor të shtetasit S. Ç., për veprën penale “vrasje me paramendim” dhe dënimin e tij me 25 vjet burg, deklarimin fajtor për veprën penale “prodhim e mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit” dhe dënimin e tij më 3 vjet burgim; deklarimin fajtor të shtetasit J. Xh. dhe dënimin e tij me gjobë në masën 1,000,000 lekë dhe deklarimin e shtetasit F. M. dhe dënimin e tij më 700,000 lekë gjobë, për veprën penale “përkrahje e autorit të krimit”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 22.1.2008, ka vendosur “Deklarimin e pafajshëm të shtetasit S. Ç. dhe deklarimin e pafajshëm të shtetasve J. Xh. dhe F. M.”.
- 153.** Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 14.4.2009, ka vendosur “Prishjen e vendimit penal nr. ***, datë 22.1.2008”. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 8.7.2009, ka vendosur “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës me nr. ***, datë 14.4.2009, dhe kthimin për rigjykim me një tjetër trup gjykues”.
- 154.** Në rigjykim, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 31.5.2010, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 22.1.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim prokurori në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar “Prishjen e vendimit”.
- 155.** Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 17.9.2010, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga prokurori ndaj vendimit nr. ***, datë 31.5.2010, duke lënë në fuqi vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”, të dhënë nga trupa gjyqësore,

⁴⁴Th. Q., i biri i P. dhe V., i datëlindjes 1975, lindur dhe banues në Gj. dhe K. Q., i biri i K. dhe R., i datëlindjes 14.11.19888, lindur dhe banues në Gj.. Kërkesa e Komisionit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan i referohet shtetasit A., ndërkohë, në kthim përgjigje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në kllapa, tek emri Th., ka të shënuar emrin (A.).

ku si kryesues ka qenë subjekti i rivlerësimit Bujar Musta. Kjo dosje është trajtuar gjerësisht në kapitullin B.1, të konstatimeve nga KLGJ-ja.

- 156. Dosja nr. 4** – që i përket vendimit nr. ***, datë 26.5.2004, ndaj shtetasit D. T.. Çështja penale është gjykuar nga trupa gjyquese e përbërë nga kryetar Bujar Musta dhe anëtarë P. F. dhe I. P., kundër të pandehurit D. T., i akuzuar për veprën penale “të kalimit të paligjshëm të kufirit 2 herë”. Nga shqyrtimi i dosjes ka rezultuar se prokuroria ka sjellë për gjykim pranë gjykatës të pandehurin, duke e akuzuar për veprën penale “trafikim të fëmijëve”, të parashikuar nga neni 128/b-1 i Kodit Penal⁴⁵. Në seancën gjyqësore të datës 18.5.2004, prokurori ka kërkuar ndryshimin e akuzës, duke kualifikuar veprën penale në “kalim të paligjshëm të kufirit”. Gjykata, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit, deklarimeve të familjarëve të të miturit G. M. dhe vetë dëshmitarëve, ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit D. T., për veprën penale ‘të kalimit të paligjshëm të kufirit’ dhe dënimin me 6 muaj burgim, deklarimin fajtor për të pandehurin D. T. me 15 muaj burgim, në bashkim të dënimeve”.
- 157.** Pas ankimit të vendimit në Gjykatën e Apelit Durrës, kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë 9.9.2004, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”. Pa analizuar themelin e vendimit i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës, konstatohet se nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbajtura me shkrim dore rezulton se në datën 18.5.2004, përpara depozitimit të konkluzioneve përfundimtare, prokurori ka ndryshuar akuzën nga “trafikim i të miturve”, neni 128/b i Kodit Penal, në “kalim i paligjshëm i kufirit”, të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal 2 herë, kjo bazuar në dëshmitë e dhëna nga shtetasit G. M., Z. M. dhe A. M. Bazuar në nenin 372 të Kodit të Procedurës Penale, ai ka kërkuar ndryshimin e akuzës, duke e akuzuar për veprën penale “kalim i paligjshëm i kufirit”, të parashikuar nga neni 297 i Kodit Penal 2 herë, akuza i është komunikuar të pandehurit në seancën gjyqësore, duke parashtruar edhe në pretendimet përfundimtare, duke kërkuar vazhdimin e hetimit për akuzën e re.
- 158.** Gjykata ka riçelur hetimin, e në bazë të nenit 367 të Kodit të Procedurës Penale, i kanë komunikuar palëve akuzën e re, të cilët nuk kanë kërkuar kohë, pasi nuk kanë pasur prova të reja për të paraqitur. Avokati i të pandehurit nuk ka qenë dakord me ndryshimin e akuzës së bërë nga prokurori, me pretendimin se nuk është e vërtetë që i akuzuari është dënuar më parë për të njëjtën ngjarje, si dhe në mbështetje të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar gjykimin e shkurtuar. Më tej, gjykata e rrethit gjyqësor ka marrë vendim për vazhdimin e procedimit mbi akuzën e komunikuar nga prokurori, sipas nenit 297 të Kodit Penal, e në datën 26.5.2004, trupa gjyquese e ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor, duke vendosur deklarimin fajtor të shtetasit D. T. për veprën penale “të kalimit të paligjshme të kufirit” dhe në bazë të neneve 297 (pjesa e parë) e 49 të Kodit Penal, dënimin e tij me 6 muaj burgim. Deklarimin fajtor të shtetasit D. T. “të kalimit të paligjshëm të kufirit” dhe në bazë të neneve 297 (pjesa e parë) e 49 dhe 50 /h të Kodit Penal, dënimin e tij me 1 vit burg, në bashkim të dënimeve, dënimin në 15 muaj burg.
- 159.** Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. ***, datë 26.05.2004 (edhe kopja e mbajtur më shkrim dore) nuk rezulton të ketë nga pikëpamja formale elementin e firmosjes nga e gjithë trupa gjyqësore e përbërë nga Bujar Musta kryetar i seancës dhe gjyqtar I. P. anëtar, ky vendim rezulton të jetë firmosur vetëm nga gjyqtarja P. F..
- 160.** Lidhur me këtë dosje, Komisioni i ka njoftuar subjektin këto rezultate:

⁴⁵Referuar Kodit Penal të vitit 2004, vepra penale “trafikimi i të miturve”, dënohen me burgim nga 7 deri në 15 vjet dhe me gjobë nga 4 deri në 6 milionë lekë.

- Në analizimin e arsyesimit të vendimit dhe të dhënë nga gjykata është analizuar konsumimi tërësisht i elementëve të veprës penale “të kalimit të paligjshëm të kufirit”, por nuk ka një arsyetim të thelluar nga ana e gjykatës, sa i takon elementëve të vendimit, duke përshkruar rrethanat e faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi, për aq kohë sa ishte pranuar ndryshimi i veprës penale nga trafikimi i të miturve në kalim i paligjshëm i kufirit, ndërkohë që në gjykim nuk ishin sjellë prova të reja nga ana e prokurorisë.
- Duket se në shqyrtim të elementëve të vendimit nr. ***, trupi gjykues nuk ka kryer një analizë/arsyetim të qartë e të plotë ligjor lidhur me arsyet, rrethanat e faktit dhe provat mbi të cilat kanë pranuar ndryshimin e akuzës së veprës penale nga “trafikim i fëmijëve⁴⁶” në “kalim i paligjshëm i kufirit”, por është mjaftuar vetëm me përshkrimin e argumentit të prokurorit, se nga ky i fundit nuk akuzohet për këtë vepër penale me qëllim fitimi, si dhe nga dëshmitarët G., Z. A. e M. M., nuk ka rezultuar qëllimi i fitimit.

161. Dosja nr. 5 – që i përket vendimit nr. *, datë 13.5.2008, ndaj shtetases Zh. I.**

162. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. ***, datë 13.5.2008, të dhënë nga gjyqtari E. P., ka vendosur “Deklarimin e pafajshëm të shtetases Zh. I., të akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, të parashikuar nga neni 89 i Kodi Penal. Vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 13.5.2009, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

163. Dosja nr. 6 – që i përket çështjes civile me palë ndërgjyqëse G. M. dhe N. M.

164. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 25.11.2020, ka vënë në dispozicion dosjen e plotë të vendimit nr. ***, datë 1.2.2019, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit Bujar Musta. Nga shqyrtimi i vendimit konstatohet se në datën 29.8.2018 subjekti ka marrë vendimin për “lënien pa veprim të padisë”, pasi ka konstatuar se pala nuk ka përcaktuar saktë vendndodhjen/vendbanimin dhe në datën 1.2.2019 ka vendosur “Kthimin e padisë” rezulton se dëftesa e komunikimit për vendimin me nr. ***, datë 4.2.2019 nuk i është njoftuar palëve. Vendimi nr. ***, datë 25.4.2019, në të cilin konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka vendosur përsëri “Kthimin e padisë”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se në dosje ndodhet një kërkesë e datës 5.4.2019, e firmosur nga paditësi G. M., i cili ka bërë me dije gjykatën për adresën e të paditurës “Via M.S. nr. ***, O. *** S.” *Sardegna, Italia,*” por nuk rezulton se subjekti të këtë marrë masat e duhura për njoftimin e palëve sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile, në adresën e dhënë nga palët, në Njësinë Administrative, Zyrën e Gjendjes Civile, sipas parashikimeve të neneve 154 dhe 156 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile apo adresën e dhënë nga palët, etj.

165. Dosja nr. 7 – që i përket çështjes nr. * vendimi, datë 21.2.2020, me palë ndërgjyqëse M. K., A. E. etj. dhe i paditur L. H., me objekt “konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave për shitjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë “A.” sh.p.k.**

166. Referuar shkresës nr. *** prot., datë 22.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kjo e fundit vuri në dispozicion procesverbalet dhe vendimin nr. ***, datë 21.2.2020, i cili është ankimuar dhe dosja ka shkuar në Gjykatën e Apelit Durrës. Vendimi i sipërcituar është dhënë nga gjyqtarja M. F. dhe, në përfundim të gjykimit, ka vendosur “Rrëzimin e padisë së shtetasi A. E.” etj.⁴⁷

⁴⁶Referuar Kodit Penal të kohës, dispozita e nenit 128/b, pika 1, është “trafikim i të miturve”.

⁴⁷Shtetasi A. E. ka depozituar kallëzim penal ndaj gjyqtarit Bujar Musta, çështje që është trajtuar në kapitullin B.3, pika v.

- 167. Dosja nr. 8** – që i përket çështjes me palë paditëse M. M. dhe i paditur E. M. me objekt “Zgjidhje martesë, lënie për rritje dhe edukim të fëmijës”.
- 168.** Me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2021, Gjykata ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 28.2.2020, të subjektit të rivlerësimit R. A., i cili ka vendosur “Pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fjalë ka rezultuar se kjo çështje fillimisht i ka kaluar subjekti të rivlerësimit, e më pas, pasi palët e përfshirë në këtë proces kanë depozituar kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi (pasi rezulton nga sistemi elektronik edhe një padi tjetër e ngritur nga palët në proces me objekt: “Përjashtimin nga gjykimi i çështjes me objekt “Kundërshtimin e atësisë së fëmijës”, si dhe një sërë pretendimesh të tjera, si rolin aktiv të gjyqtarit në marrjen e provave, me faktin se nuk është kthyer padia nga ky i fundit, pasi nuk kishin vendosur adresën e saktë të banimit - ndërkohë që në padinë e tyre nuk rezultonte të kishte adresë, ndryshe nga sa ky gjyqtar ka praktikën e zakonshme të kthimit të padive, duke pretenduar për interesa të ngushta etj. Gjykata Rrethit Gjyqësor Elbasan, pas shqyrtimit të kësaj kërkesë me vendimin nr. ***, datë 19.6.2020, ka vendosur “Deklarimin e papranueshëm të kërkesës se shtetasit E. M. për përjashtimin e gjyqtarit nga çështja”. Në vijimësi, ata kanë ngritur një tjetër padi, atë me objekt “Kundërshtimit të atësisë”, çështje e cila është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit dhe me vendimin nr. ***, datë 22.6.2020, është vendosur “Pranimi i kësaj padie”. Më tej, nga shtetasi E. M. është depozituar një kërkesëpadi me objekt “Shkaktim dëmi nga subjekti i rivlerësimit Bujar Musta për dëmin e shkaktuar nga përgatitja e dokumentacionit dhe ankimi”. Kjo çështje është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe me vendimin nr. ***, datë 9.1.2020, ka vendosur “Kthimin e padisë dhe aktet palës paditëse”⁴⁸.

B.5. KONSTATIME TË TJERA

- 169.** Referuar dokumentacionit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, ashtu sikurse konfirmohet edhe nga kthim përgjigjja e tij më 4.1.2020, ora 15:11, ai ka dërguar disa kërkesa institucioneve/organeve të ndryshme me vulën e institucionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe me firmën e tij, sigluar me përshkrimin “Gjyqtar Bujar Musta” e konkretisht, përmendin disa si : *Akti nr. *** datë 27.12.2019, drejtuar Bashkisë Elbasan; zyrës së Gjendjes Civile të qytetit Durrës, akti nr. ***, datë 12.12.2019, ASHK – Mat, akti nr. ***, datë 20.12.2019, email në adresën elektronike, ministria.brendshme@mb.gov.al, etj.* Nga informacioni i përshkruar në kërkesat dhe i disponuar fizikisht nuk qartësohet elementi formal dhe personal i kërkesës individuale në kuadër të procesit të rivlerësimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve, bazuar në ligjin nr. 84/2016. Evidentohet se në përmbajtjen e tyre kërkohet informacion dhe dokumentacion sipas kërkesave specifike të gjithsecilës, por ato duket se nuk janë, ose së paku, nuk përshkruajnë qartësisht argumentin ligjor të kërkesës së bërë nga një gjyqtar, në funksion të ushtrimit të detyrës dhe/apo të një procesi gjyqësor. Dokumentacioni i disponuar është nën titullin e gjyqtarit dhe me vulën e institucionit, çka të bën të mendosh se bëhet fjalë për një kërkesë institucionale, dhe kjo, në kapërcim të ushtrimit të detyrave funksionale të subjektit të rivlerësimit, duke përdorur pozitën dhe vulën institucionale për marrje informacioni dhe dokumentacioni, në funksion të procesit të rivlerësimit në fjalë, me karakter dhe interes kryesisht individual.

⁴⁸Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata, konkretisht nga procesverbalet e seancave gjyqësore të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit për padinë me objekt “Zgjidhje martesë..”, në datën 24.1.2019, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për kryerjen e aktit të ekspertimi, duke njoftuar psikologun, ashtu sikurse përcaktohet në dispozitat e Kodit të Familjes, ndryshe nga sa ai ka vepruar në rastin e shtetasit R. Ç., trajtuar në rubrikën e denoncimeve.

DENONCIME NGA PUBLIKU

170. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku 28 denoncime (nga të cilët 5 nga i njëjti denoncues), të cilët janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit Bujar Musta. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka rezultuar si vijon:

1. Denoncimet nr. * prot., datë 12.10.2020 dhe nr. *** prot., datë 21.11.2018, të shtetases H. H.**

Kryesisht, denoncimi i shtetases është kundrejt një tjetër subjekti rivlerësimi. Nga dokumentacioni në dispozicion konstatohet se shtetasja ka depozituar kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit dhe me vendimin nr. ***, datë 14.12.2019, kërkesa e denoncueses është pranuar dhe gjykimi është përfunduar nga një tjetër gjyqtar.

2. Denoncimi nr. * prot., datë 11.1.2018, i shtetases K. K. T.**

Shtetasja denoncon subjektin e rivlerësimit Bujar Musta, i cili nuk ka respektuar procedurën ligjore për gjykimin e urdhrin të mbrojtjes, si dhe ka kërkuar pezullimin dhe heqjen dorë nga subjekti i rivlerësimit për shqyrtimin e çështjes, kërkesa të cilat sipas saj në shkelje të ligjit nuk janë pranuar. Gjithashtu, shtetasja pretendon se çështja nuk është gjykuar me sistem audio dhe se pretendimet e saj nuk janë shënuar në procesverbalin e seancës gjyqësore. Nga dokumentacioni në dispozicion evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimet nr. ***, datë 18.5.2017 dhe vendimin nr. ***, datë 1.6.2017 “Për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes” në dobi të paditësit I. T., kundrejt denoncueses K. T..

Lidhur me pretendimin e denoncueses se gjykimi i çështjes nuk është gjykuar me sistem audio, lidhur me sa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 6.5.2021, ka informuar se nuk ka regjistrim audio të çështjes në fjalë. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 25.7.2017, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 1.6.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 20.11.2017, i shtetasit L. H.**

Kryesisht denoncimi drejtohet ndaj subjekteve të tjera të rivlerësimit dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk rezulton që gjyqtari Bujar Musta të këtë dhënë vendim me palë ndërgjyqëse denoncuesin.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 1.10.2018, i shtetasit L. B.**

Shtetasi denoncon subjektin e rivlerësimit pasi ky i fundit në kundërshtim me ligjin ka ndryshuar dispozitivin e vendimit të gjykatës dhe se ka marrë vendimi në mungesë të palës paditëse, për të cilën nuk ka marrë një vendim për gjykimin në mungesë⁴⁹. Denoncuesi ka vënë në dispozicion vendimin nr. *** (nr. ***, datë 10.4.2018), nga shqyrtimi i të cilit konstatohet se gjyqtari Bujar Musta, ka rrëzuar në themel pretendimet e paditësave lidhur me konstatimin e pavlefshmërisë absolute etj⁵⁰, pasi nga ana e tyre është hequr dore më vullnetin e tyre të lirë për disa kërkime, pjesë të objektit të padisë për të cilat ai ka vendosur pushimin e gjykimin⁵¹, ndërsa lidhur me detyrimin e paditësve të pagesës në dobi të të paditurit M. B. të vlerës prej

⁴⁹ Vendimi është dhënë në mungesë të njëjës palë paditëse E. B. e cila është bashkëshortja e shtetasit L. B..

⁵⁰Për më shumë referojuni objektit të padisë “Konstatim pavlefshmëri absolute, detyrimi i të paditurit M. B. të paguajë demin e shkaktuar, kthimin e akteve në gjendjen e mëparshme, detyrimin e të paditurit M. B. për kthimin në dobi të paditësve të banesës private, detyrimin për pagesën e shpenzimeve gjyqësore etj.

⁵¹Bazuar në nenet 201/4 dhe 299 të Kodit të Procedurës Civile.

48.000 lekësh, si shpenzime gjyqësore, ai ka zbatuar procedurat ligjore të parashikuara në nenin 106/2 të Kodit të Procedurës Civile⁵². Konstatohet se në fazën përkatëse procedurale gjykata kishte marrë vendim për vazhdimin e seancës në mungesë të paditëses si dhe të mos e pushonte gjykimin për këtë palë, meqë paditësja dhe bashkëshorti i saj kanë pasur të njëjtat interesa dhe pretendime. Nga sa më sipër, nuk vërtetohet pretendimi i denoncuesit se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar dispozitivin e vendimit. Ndërkohë nga shqyrtimi i faqes zyrtare si dhe nga kthim përgjigjja e shkresës nr. *** prot., datë 6.5.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan rezulton se çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës.

5. Denoncimet nr. * prot., datë 2.3.2020; nr. *** prot., datë 23.9.2018; nr. *** prot., datë 13.12.2017; nr. *** prot., datë 4.2.2020; nr. *** prot., datë 23.12.2019, të shtetasit B. I.**

Ky shtetas ka depozituar disa denoncime për subjektin e rivlerësimit për korrupsion duke pretenduar se gjyqtari të gjitha gjyqet e masave të sigurimit i bën pa avokatë dhe pa audio, me përjashtim të atyre rasteve që kërkojnë me këmbëngulje avokatët e tyre, duke shkelur në këtë mënyrë dispozitën e nenit 259 të Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me këtë pretendim, ai ka bashkëlidhur një praktikë në të cilën vërehet “se jo në pak raste” denoncuesi ka ushtruar “rolin e avokatit”, duke nënshkruar akte të natyrës civile dhe penale. Ky shqetësim është ngritur edhe nga subjekti i rivlerësimit duke iu drejtuar disa herë organeve kompetente. Duket se ky moment është bërë edhe pjesë e konfliktit në vazhdimësi ndërmjet tyre, pasi sa herë që ka pasur akte apo përfaqësim nga ky shtetas (denoncuesi) në seancat gjyqësore të zhvilluara, duket se subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë nga shqyrtimi i padive. Shtetasi B. I. akuzon subjektin se në bashkëpunim me shoferin e tij H. S. kanë tjetërsuar një pjesë të pronës së tij, veç të tjerash në denoncimin ai përshkruan se:

- a. Në datën 7.10.2014 është regjistruar procedimi penal për veprat penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”. Ndër vite nga ky shtetas janë paraqitur kërkesa të shumta për zëvendësimin e prokurorëve, nga të cilat disa janë pranuar dhe disa jo, pas ndjekur me një valë kallëzimesh ndaj prokurorëve që caktoheshin për të përfaqësuar këtë çështje në gjykatë⁵³.
- b. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka depozituar kallëzimin nr. *** , të shtetasit B. I., i cili ka kallëzuar shtetasit Bujar Musta dhe S. K. për “Shpërdorim detyrë”. Në përfundim Prokuroria e Tiranës me vendimin e datës 12.10.2015, ka vendosur “Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. *** , të vitit 2015”.

5.1 Në denoncimin nr. *** prot., datë 4.2.2020, shtetasi ka vënë në dispozicion vendimin nr. *** , datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese lidhur me gjykimin e një çështjeje jo brenda afateve të arsyeshme. Nga shqyrtimi i vendimit⁵⁴ konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka marrë për shqyrtim çështjen me nr. akti *** , më 21.6.2012 dhe pas rihedhjes së shortit, më datë 9.12.2012 është përjashtuar nga gjykimi i çështjes në datën 8.7.2014, si dhe është zëvendësuar

⁵²Neni 106, Gjykata, në vendimin përfundimtar ngarkon palën së cilës i është rrëzuar padia me pagimin e shpenzimeve gjyqësore sipas nenit 102 të këtij Kodi, duke përfshirë edhe shpërblimin për një avokat.

⁵³Sidoqoftë, të gjitha pretendimet që ngre ky shtetas lidhen me pakënaqësitë e tij për arrestimin në kuadër të procedimit penal të mësipërm dhe dërgimin për gjykim të çështjes në ngarkim të tij, gjë që rezultoi nga kallëzimet e shumta të tij për çdo prokuror që merr përsipër përfaqësimin e çështjes në ngarkim të tij.

⁵⁴Kërkuesi Y. M. i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ai ka pretenduar se gjyqtari B. M., që është caktuar të gjykojë padinë e tij, e ka zvarritur çështjen gjyqësore duke e vonuar 24 muaj gjykimin e saj. Ky fakt, sipas kërkuesit, është vënë në dukje edhe nga KLD-ja, e cila nga hetimi i dosjes ka arritur në përfundimin se është shkelur nga gjyqtari vendimi nr. *** , datë 14.4.2010, i KLD-së dhe e drejta për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Kërkuesi ka evidentuar në kërkesë faktin e mospërfundimit të gjykimit në shkallë të parë dhe mosmarrjen e vendimit nga gjykata në lidhje me çështjen e themelit.

me gjyqtaren R. A. Gjykata Kushtetuese, me vendimin e sipërcituar, ka vendosur “Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit në një afat të arsyeshëm”. Për shkak të përjashtimit të gjyqtarit B. M., në datën 8.7.2014, është rihedhur shorti elektronik dhe është zëvendësuar nga gjyqtari R. A. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë vendim në lidhje me çështjen e themelit gjatë kohës që kërkesa e paraqitur nga kërkuesi ka qenë në proces shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me vendimin nr. ***, datë 27.3.2015. Në përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit është i bazuar dhe duhet pranuar, pasi si rrjedhojë e mosgjykimit brenda afatit të arsyeshëm, atij i është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, duke vendosur “*Pranimin e kërkesës. Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare*”⁵⁵.

5.2 Në denoncimin nr. *** prot., datë 23.12.2019, shtetasi B. I. referon disa problematika dhe shkelje procedurale, të cilat i janë referuar nga avokati O. J., duke bashkëlidhur disa vendime gjyqësore të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur ai parashtron se:

- a. Në çështjen e dorëzuar nga shtetasja R. K. paditëse dhe i paditur A. Xh. janë kryer shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit në dhënien e vendimit nr. ***, datë 25.10.2019, pasi nuk ka njoftuar palët ndërgjyqëse për zhvillimin e procesit gjyqësor. Nga anaizimi i vendimit nr. ***, datë 25.10.2019, konstatohet se subjekti ka kthyer padinë për të metat e konstatuara referuar nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi pala paditëse kishte marrë njoftimin dhe nuk kishte plotësuar të metat e padisë⁵⁶. Në datën 24.10.2019 subjekti ka marrë vendimin për gjykimin në mungesë në dhomë këshillimi më 25.10.2019 ka vendosur “Kthimin e padisë”. Nga dokumentacioni në dosje rezulton se në datën 22.10.2019 është dërguar nga avokati shkresa plotësimi i të metave referuar aktit ***, datë 23.9.2019, njoftuar më 18.10.2019, brenda afatit 5-ditor, ky dokument rezulton të ketë datën 22.10.2019 dhe për veprime i është sigluar gjyqtarit Bujar Musta.

171. Për sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se: *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në konsideratë dokumentacionin e depozituar nga përfaqësuesi me prokurë, depozituar më 22.10.2019, për plotësimin e të metave.*

- b. Në çështjen gjyqësore me palë ndërgjyqëse H. K. dhe i paditur F. K.⁵⁷ me objekt padie “zgjidhje martesë” subjekti ka dhënë vendimin pa njoftuar palët ndërgjyqëse. Nga shqyrtimi i vendimit të vënë në dispozicion konstatohet subjekti ka pushuar gjykimin e çështjes, pasi palët ishin në mungesë me argumentin se ata kishin qenë prezent në seancën e datës 19.11.2019 paraardhëse të njoftuar palëve⁵⁸. Edhe nga shqyrtimi i procesverbaleve të vëna në dispozicion nuk konstatohet njoftimi i përfaqësuesit me prokurë, më tej ka rezultuar se i padituri ka qenë prezent në disa seanca gjyqësore të zhvilluara, por nuk ka mundur të japë shpjegime, pasi gjykata nuk kishte verifikuar gjendjen e tij mjekësore nga mjekët e I. M. L., të cilët edhe pse kishin marrë disa herë njoftimin nga gjykata, nuk ishin paraqitur dhe nuk kishin njoftuar për shkakun e ligjshëm të mungesës. Konstatohet se gjykimi i çështjes në fjalë është përfunduar nga gjyqtarja Z. V., ku në përfundim ka vendosur “Pranimin e padisë” në mungesë të palës së paditur.

⁵⁵ Vendimi ka edhe 2 vendime pakice.

⁵⁶ Më datë 18.10.2019, është njoftuar dhe njohur avokati O.J. me vendimin nr. *** regjistri, datë 23.9.2019 dhe për lënien e afatit 5-ditor për plotësimin e të metave.

⁵⁷ I padituri rezulton të ketë qenë i shtruar në spitalin psikiatrik “S. D.”.

⁵⁸ Nuk ka informacion lidhur me përfaqësuesin av. O. J., i cili sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 7.6.2019 përfaqësonte në praninë dhe në mungesë të shtetases H. K..

- c. Denoncuesi gjithashtu ka pretenduar se ai ka shkelur procedurat ligjore lidhur me njoftimin e palëve si dhe pa ndonjë akt apo rrethanë të ndryshme ka dhënë një vendim në kundërshtim me ligjin, konkretisht vendimet: nr. ***, datë 31.7.2019; nr. ***, datë 13.9.2019; dhe nr. ***, datë 14.6.2019. Nga dokumentacioni i disponuar rezulton se vendimi nr. ***, datë 31.1.2019, me palë ndërgjyqëse A. Ç. dhe i paditur N. Ç., me objekt “zgjidhje martesë dhe lënie të fëmijës për rritje⁵⁹ e edukim nënës”, dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka marrë formë të prerë më 26.2.2019, pa u ankimuar nga palët. Konstatohet se ky vendim është marrë nga gjyqtari Bujar Musta pa marrë më parë mendim /akt ekspertim nga Psikologu, e më tej duke dhënë vendim në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Familjes, neni 6, paragrafi 4, ku citohet se: “Në çdo procedurë që i përket të miturit, prania e psikologut është e detyrueshme për të vlerësuar thëniet e të miturit në përputhje me zhvillimin mendor dhe situatën e tij sociale”, nenin 155, nenin 267 të Kodit të Familjes etj⁶⁰.
- 172.** Nisur nga sa është përshkruar më sipër, Komisioni ka konstatuar se: *Duket se subjekti i rivlerësimit ka marrë një vendim gjyqësor në kundërshtim me dispozitat ligjore të parashikuara nga Kodi i Familjes, pasi ka vendosur lënien për edukim dhe rritje të fëmijës së mitur R. Ç., pa dëgjuar këtë të fundit në prani të psikologut, bazuar në nenin 273 të Kodit të Familjes, si dhe pa marrë një mendim të psikologut.*
- d. Lidhur me vendimet e tjera të referuara nga denoncuesi, rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. ***, datë 4.2.2019, me palë L. O. nuk është dhënë nga subjekti i rivlerësimit⁶¹, vendimi nr. ***, datë 24.1.2019, me palë Bashkia Elbasan nuk është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit Bujar Musta.
- e. Në çështjen me palë shtetasin S. Z., denoncuesi pretendon se gjyqtari ka dhënë vendimet nr. ***, datë 3.11.2017 dhe nr. ***, datë 13.5.2019, duke vendosur “Pranimin e kërkesës pa prova dhe dokumentacion ligjor, si dhe ka ndërruar objektin e padisë me iniciativë”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan konstatohet se vendimi nr. ***, datë 13.5.2019 ka për objekt: “Sqarim dhe interpretim vendimin civil nr. *** (L/U Ekzekutimit)”, me bazë ligjore nenin 314/ të Kodit të Procedurës Civile, ndërkohë bashkëlidhur është edhe vendimi me nr. ***, datë 13.5.2015, që ka objekt “Lëshimin e urdhrit për detyrimin monetar në shumën 700 mijë kundër debitorit sipas deklaratës noteriale”, ku si bazë ligjore përshkruhen nenet 510 dhe 511 të Kodit të Procedurës Civile. Duket se, janë dy vendime të ndryshme të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ku i pari për të interpretuar dhe sqaruar vendimin civil nr. *** dhe vendimi i dytë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.
- f. Konstatohet se vendimi nr. ***, datë 3.11.2017, me objekt “Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të debitorit B. D. për detyrimin e tij monetar, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., datë 10.10.2017”, është rrëzuar nga subjekti i rivlerësimit me argumentin se akti noterial në atë fazë të shqyrtimit nuk përbënte titull ekzekutiv, pra duke e marrë në shqyrtim dhe në vlerësim aktin noterial objekt gjykimi.
- 173.** Lidhur me sa më lart, Komisioni ka konstatuar se: *Duket se subjekti i rivlerësimit, lidhur me aktin nr. ***, vendimi datë 13.5.2019, duhet të kishte hequr dorë nga shqyrtimi i çështjes, pasi kishte marrë pjesë në gjykimin e çështjes më parë me vendimin e datës*

⁵⁹Shtetasi R. Ç. rezulton të jetë i vitlindjes 2008 në momentin e gjykimit të padisë viti 2019, shtetasi kishte kaluar moshën 10 vjeç, ku bazuar në nenin 273 të Kodit të Familjes parashikohet se: “Gjatë gjykimit duhet të dëgjohet dhe i mituri që ka mbushur moshën 10 vjeç, në praninë e psikologut”.

⁶⁰ Lutemi referojuni pikës 50, të dosjes nr. ***, ku subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për thirrjen e psikologut.

⁶¹Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan informon se datat e vendimeve të kërkuara nuk përputhen me datat e vendimeve të depozituara nga kjo gjykatë.

3.11.2017, duke dhënë vendimin për “Rrëzimin e padisë”, bazuar në nenet 71, 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 13.7.2018, i shtetas M. M.**

Shtetasja denoncon disa subjekte rivlerësimi dhe ndërmjet tyre edhe gjyqtarin Bujar Musta, nuk ka bashkëlidhur dokumentacion, por pretendon për zvarritje të gjykimit. Nga shqyrtimi i vendimeve të ardhura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, konstatohet se tre vendimet gjyqësore të dhëna me palë shtetasen M. M. nuk janë dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

7. Denoncimi nr. * prot., datë 7.6.2018, i shtetasit B. S.**

Shtetasi denoncon gjyqtarin duke pretenduar se ka marrë vendim pa respektuar procedurën ligjore për thirrjen e tij në gjykatë. Nga kthim përgjigjja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. *** Prot, datë 06.05.2021 bëhet me dije se nuk ka çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse shtetasin B. S.⁶².

Denoncimi nr. * prot., datë 18.5.2018, i shtetasit A. Ç.**

Kryesisht denoncimi drejtohet drejt subjektit të rivlerësimit Z. Sh..

8. Denoncimi nr. * prot., datë 7.3.2018, i shtetasit L. H.**

Shtetasi pretendon për vendimmarrje të padrejtë nga gjyqtari Bujar Musta, në dhënien e vendimit nr. ***, datë 6.10.2016, me objekt “Deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv” vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 14.11.2017. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, pasi pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë kryesisht me themelin e çështjes, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni.

9. Denoncimi (kallëzimi penal) nr. * prot., datë 27.2.2018, i shtetasve T. Z. dhe I. B.**

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur “Mosfillimin e kallëzimit nr. ***, të vitit 2018”. Kjo çështje është përshkruar në kapitullin B. 3, germa “ii”. Në denoncimin e tij, qytetari pretendon se subjekti ka kryer veprat penale “shkelje e barazisë së shtetasve” dhe “shpërdorim të detyrës”. Shtetasi T. Z., i cili përfaqësohet nga av. I. B., ka paraqitur 2 padi për të njëjtën pronësi më të njëjtat palë ndërgjyqëse, por me objekt të ndryshëm, e para me objekt “shtyrje afati të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, sigurimin e padisë përmes pezullimit të vendimit të gjykatës etj...”, ndërsa padia e dytë ka objektin “zgjidhja e pasojave të pavlefshmërisë së kontratës së shitjes, saktësimi i kufijve etj.”. Shtetasi pretendon se subjekti nuk ka zhvilluar deri ditën e depozitimit të kallëzimit penal datë 24.2.2018, seancën e parë gjyqësore, ndërsa lidhur me padinë e dytë pretendon se subjekti ka “kthyer padinë” me pretendimin se ajo është me të “meta”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se me vendimin nr. ***, datë 14.2.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Kthimin e padisë”, pasi palët nuk kishin plotësuar të metat e padisë me argumentimin se *ato nuk përcaktojnë adresën e plotë të vendbanimit/ose vendqëndrimit, emërtimin e rrugës, hyrjen e pallatit, katin nr. e pallatit, aktet e ZRPP-së nuk përmbajnë emrin, mbiemrin dhe detyrën e nëpunësit të kësaj zyre që ka legalizuar këto akte, mungon konfirmimi i kësaj gjykate nëse vendimi jopërfundimtar civil nr. ***, i datës 4.1.2018, nëse ka marrë formë të prerë, duke vlerësuar se edhe pas kalimit të afatit të gjatë kohor të vënë në dispozicion, të metat e padisë nuk janë plotësuar sipas dispozitës përkatëse të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile.*

⁶²Lutemi referojuni dosjes së Komisionit ku është vënë në dispozicion edhe kopje edhe nga sistemi ICMISS.

10. Denoncimi nr. * prot., datë 8.2.2018, i shtetases M. Gj.**

Shtetasja ka depozituar ankesën e saj lidhur me prokurorin F. L., denoncimi ka të bëjë kryesisht me një tjetër subjekt rivlerësimi.

11. Denoncimi nr. * prot., datë 8.2.2018, i shtetasit A. E.**

Shtetasi denoncon për vendimmarrje të padrejtë shumë subjekte dhe ndërmjet tyre edhe gjyqtarin Bujar Musta, në faqen nr. 26 të ankesë së tij përshkruan “*se prokurore A. Xh. kur iu paraqit kallëzimi për falsifikimin e dokumenteve nga Bujar Musta, pranoj ta shqyrtonte çështjen e cila në përfundim vendosi mosfillimin*” trajtuar më sipër në pikën B3, v.

12. Denoncimi nr. * prot., datë 30.1.2018, i shtetasit H. V.**

Ky denoncim kryesisht lidhet me subjektin e rivlerësimit A. V.. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, për sa kohë nuk ka pretendime të ngritura për subjektin e rivlerësimit.

13. Denoncimi nr. * prot., datë 18.1.2018, i shtetases R. A.**

Shtetasja denoncon gjyqtarin pasi ky i fundit ka dhënë 2 vendime me të njëjtin objekt padie. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2021, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar dhe nuk ka vënë vendim me palë ndërgjyqëse denoncuesen⁶³.

14. Denoncimi nr. * prot., datë 26.2.2020, i shtetasit M. R.**

Shtetasi denoncon gjyqtarin për vendimmarrje të padrejtë në dhënien e vendimit të datës 7.2.2020 për mospranimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit për K. M., duke shkelur dispozitat e ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, neni 263, pika 1, germa “c”, pika 2, germa “c”, të Kodit të Procedurës Penale. Nga shqyrtimi i vendimit të depozituar nga gjykata, konstatohet se vendimi është dhënë nga trupa e gjyqtarëve e përbërë nga E. K., B. M. dhe M. F. Dhe se janë respektuar dispozitat ligjore të nenit 263, neni 263, pika 1, germa “c”, pika 2, germa “c” të Kodit të Procedurës Penale⁶⁴. Vendimi është ankimuar bazuar në ankesën e K. M. dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 24.2.2020 ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit të ndërmjetëm datë 7.2.2020”. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit.

15. Denoncimi nr. * prot., datë 11.2.2020, i shtetasit M. M. H.**

Shtetasi denoncon subjektin e rivlerësimit për figurë të ulët morale dhe integriteti.

16. Kërkesëpadi me nr. * prot., datë 4.11.2019, drejtuar Komisionit**

Studioja ligjore “J.” ka depozituar një kërkesëpadi në emër të subjekteve të rivlerësimit Bujar Musta dhe R. A.. Nuk ka informacion të mëtejshëm lidhur me këtë kërkesëpadi.

17. Denoncimi nr. * prot., datë 9.10.2018, i shtetasit A. D.**

Shtetasi denoncon subjektin e rivlerësimit për mungesë serioziteti, korrupsion, si dhe shfaqje të mungesës së etikës në zhvillimin e seancave gjyqësore, duke pretenduar se ka kërkuar thirrjen e ekspertit dhe marrjen e disa provave, por nga gjyqtari nuk janë pranuar si kërkesa të ligjshme. Gjyqtari me vendimin nr. ***, datë 28.12.2017, ka vendosur “Rrëzimin e padisë”,

⁶³Vendime në të cilën denoncuesja ka qënë palë në proces si vijon: Vendimi nr. ***, datë 26.2.2021, nga gjyqtari T. T.; vendimi nr. ***, datë 24.1.2019, nga shtetase P. F.; vendimi nr. ***, datë 22.2.2007 nga shtetasi A. V.; vendimi nr. ***, datë 28.12.2009, nga shtetasi F. Ç.; vendim nr. ***, datë 15.11.2019, nga shtetase M. F.; vendimi nr. ***, datë 7.7.2015, nga shtetasi I. P..

⁶⁴Nga analizimi i vendimit konstatohet se data e kalimit të çështjes për gjykim, në rastin konkret përkon me datën 1.3.2019, si dhe rezultoi se deri në datën e gjykimit të vendimit të ndërmjetëm 7.3.2020, ende nuk është plotësuar afati 12 i paraburgimit për gjykimin në shkallë të parë, për më shumë referojuni vendimit nr. s’ka, datë 7.2.2020, në dosjen e Komisionit.

vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 12.3.2019, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 28.12.2017 dhe dërgimin e saj për rigjykim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues”, me argumentimin veç të tjerash se “... vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan duhet të priset për mosformim të drejtë të ndërgjyqësisë”. Lidhur me pretendimin e denoncuesit për mosthirrjen në gjykim të ekspertit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka vlerësuar të panevojshme kryerjen e aktekspertimit topografik dhe thirrjen e dëshmitarëve, pasi paditësi A. D. nuk provoi deri në fazën e gjykimit të kundërtën e përmbajtjes apo falsitetin e akteve.

18. Denoncimi nr. * prot., datë 29.10.2018, i shtetas M. A.**

Shtetasja denoncon subjektin e rivlerësimit për zvarritje të procesit gjyqësor dhe, sipas saj, subjekti i rivlerësimit nuk ka zhvilluar asnjë seancë gjyqësore më pretendimin se kërkesa e depozituar ka pasur të meta procedurale. Referuar dokumentacionit të bashkëlidhur, evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka lenë pa veprime kërkesën e denoncueses, pasi kishte të meta procedurale pasi nuk ishte përshkruar adresa e saktë, nuk ishte depozituar çertifikata e lindjes, si dhe nuk saktësonte “objektin e kërkimit”. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit⁶⁵.

19. Denoncimi nr. * prot., datë 14.8.2018, i shtetasit T. M.**

Shtetasi denoncon gjyqtarin për vendimmarrje të padrejtë, palët kanë depozituar një padi dhe kanë kërkuar që çështja të mos gjykohej nga subjekti i rivlerësimit. Kjo kërkesë është shqyrtuar dhe me vendimin nr. ***, datë 17.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk është pranuar nga gjyqtari E. K. Më tej, subjekti ka vendosur me vendimin nr. ***, datë 8.5.2017, “Pranimin pjesërisht të padisë...”. Denoncuesi në fjalë pretendon për shkelje dhe fyerje të etikës gjatë zhvillimit të këtij procesi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan është konstatuar se:

a. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. ***, datë 26.10.2010 dhe ka vendosur “Rrëzimin e padisë”, vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 15.12.2011, ka vendosur “Prishjen e vendimit civil nr. ***, datë 26.10.2010, dërgimin e çështjes për gjykim me një trup tjetër gjykues, me argumentimin se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan “... nuk ka kërkuar dhe nuk ka administruar dokumentacion praktika të objekteve të konfliktit gjyqësor, nuk ka thirrur ekspertë të fushës në mënyrë të tillë që t’u jepte përgjigje pretendimeve të palëve gjatë gjykimit”. Vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 18.6.2015, ka vendosur “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës”. Pas rigjykimit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 10.5.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 26.10.2010”, duke konfirmuar kështu vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit.

b. Nga fashikulli i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2021, konstatohet se subjekti me vendimin nr. ***, datë 8.5.2017 ka vendosur “Pranimin pjesërisht të padisë. Rrëzimin e kundërpadisë të shtetasit T. M., rrëzimin e kundërpadisë së shtetasit R. M., si dhe rrëzimin e kundërpadisë së shtetasit B. Sh. ⁶⁶”. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. ***, datë 16.4.2018, ka

⁶⁵Kërkesa datë 9.7.2018, kërkesa datë 10.10.2018; vendimi nr. ***, datë 15.5.2018, ku kërkuesja nuk ka identifikuar emrin e personit të tretë në padi; vendimi nr. ***, datë 12.4.2018; vendimi nr. ***, datë 1.6.2018 për depozitimin e akteve provuese objekt gjykimi; vendimi nr. ***, datë 13.7.2018, për depozitimin e certifikatës së lindjes; vendimin nr. ***, datë 27.9.2018, për plotësimin e një sërë të metave procedurale ndërmjet tyre edhe të pagesës së taksës së kërkesës.

⁶⁶Sipas vendimit nr. ***, datë 17.5.2014, të gjyqtarës E. K., në përmbajtje të procesverbalit të seancës gjyqësore të zhvilluar nga gjyqtari Bujar Musta, pas vënies në dijeni për kërkesën për përjashtimin e tij, ky i fundit nuk e ka ndërprerë gjykimin duke çmuar se në fazën në të cilën ishte çështja nuk duhet të ndërpritet çështja. Kërkesa e shtetasve B. Sh. dhe T. M. janë rrëzuar nga gjykata.

vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 8.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan” me argumentimin se: “... mohimi i parashtrimit të konkluzioneve përfundimtare të të paditurve kundërpaditës⁶⁷ është bërë në kundërshtim me nenin 303, të Kodit të Procedurës Civile. Mohimi i fjalës së të paditurve vjen në kundërshtim me nenin 18 të Kodit të Procedurës Civile, pasi nuk i ka dhënë mundësinë atyre të shterojnë kërkesën për prova dhe të parashtrorjnë qëndrimin e tyre për padinë dhe kundërpadinë. Këto janë shkelje të rënda, në atë masë që sjellin pavlefshmërinë e vendimit dhe në bazë të nenit 467/e të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Apelit Durrës vlerëson se vendimi duhet të priset dhe të dërgohet për rigjykim. Gjithashtu, gjykata në mënyrë të pashpjegueshme nuk ka vendosur pushimin e gjykimit për të paditurit kundërpaditës dhe paditësin e kundërpaditur, megjithëse nuk janë paraqitur në gjykim dhe se për gjykatën nuk ka rezultuar se shkaku të ketë qenë i arsyeshem”.

Së pari: “... në gjykim është cenuar procesi i rregullt ligjor sa i përket parimit të kontradiktoritetit që lidhet edhe me të drejtën e palëve ndërgjyqëse për t’u dëgjuar, për t’i bërë të njohur njëra - tjetrës mjetet dhe faktet mbi të cilat i mbështesin të gjitha pretendimet e tyre, provat e grumbulluara”.

Së dyti: Gjykata ka vendosur të marrë në shqyrtim pretendimet në kundërpadi të paditurve të kundërpaditur pa i dëgjuar ata. Të paditurit të kundërpaditur nuk kanë mundur të parashtrorjnë kundërshtimet e tyre në lidhje me aktekspertimin dhe nuk kanë mundur të parashtrorjnë pretendimet e tyre përfundimtare për kundërpadinë, madje i padituri kundërpaditës, në seancën gjyqësore të datës 2.5.2017, megjithëse ka qenë i pranishëm në gjykim i është mohuar e drejta e tij procedurale në mënyrë flagrante dhe të pashpjegueshme për të dhënë konkluzionet përfundimtare, pasi paditësi i kundërpaditur ka parashtruar konkluzionet përfundimtare. Mohimi i parashtrimit të konkluzioneve përfundimtare të të paditurve kundërpaditës është bërë në kundërshtim me nenin 303 të Kodit të Procedurës Civile. Mohimi i fjalës së të paditurve kundërpaditës vjen në kundërshtim me nenin 18 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se “*asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim*”, pasi nuk u ka dhënë mundësinë atyre të shterojnë kërkesën për prova dhe parashtrorjnë qëndrimin e tyre për padinë dhe kundërpadinë⁶⁸. Këto shkelje janë të rënda, në atë masë që sjellim pavlefshmërinë e vendimit dhe në bazë të nenit 467/e të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon: “*Gjykata e Apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur: mungojnë ose janë të pavlefshme padia, procesverbali gjyqësor, ankimi, si dhe çdo dokument tjetër që ka ndikuar në dhënien e vendimit*”.

Së treti: Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pashpjegueshme, nuk ka vendosur pushimin e gjykimit për të paditurit kundërpaditës dhe paditësin e kundërpaditur, megjithëse nuk janë paraqitur në gjykim dhe për gjykatën nuk ka rezultuar se shkaku të ketë qenë i arsyeshem duke mos respektuar nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile, pasi padia dhe kundërpadia ndjekin të njëjtin rregull procedural.

174. Lidhur me sa është përshkruar më sipër, Komisioni ka konstatuar se: *Duket se subjekti i rivlerësimit ka shkelur një nga parimet kryesore të shtetit të së drejtës, parimin e kontradiktoritetit, pasi duket se ka marrë një vendim, pa dëgjuar palët ndërgjyqëse, nuk u*

⁶⁷Të paditurit të kundërpaditur nuk kanë mundur të parashtrorjnë kundërshtimet e tyre në lidhje me aktekspertimin, në datën 2.5.2017, shtetasi T. M., megjithëse ka qenë i pranishëm i është mohuar e drejta procedurale në mënyrë flagrante dhe të pashpjegueshme për të dhënë konkluzionet përfundimtare.

⁶⁸Në seancën e datës 19.4.2017 nuk është paraqitur i padituri kundërpaditës B. Sh., ndërsa T. M. ka kërkuar shtyrjen, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar mungesën e B. Sh. dhe ka vazhduar gjykimin në mungesë edhe të T. M., por ndërkohë nuk është shprehur fare për mungesën e të paditurit kundërpaditës R. B., ka administruar provat dhe ka mbyllur shqyrtimin. Në datën 2.5.2017 nuk i ka dhënë të drejtën të parashtrorjë konkluzionet përfundimtare të padituri kundërpaditës T. M.

ka dhënë atyre mundësinë të mbrohen apo të parashtrojnë pretendimet apo kundërshtimet e tyre, veprime këto në kundërshtim me nenin 18 të Kodit të Procedurës Civile.

20. Denoncimi nr. * prot., datë 26.4.2019, i shtetasit E. B.**

Shtetasi denoncon subjektin e rivlerësimit për sjellje joetike kundrejt tij dhe në procesin e zhvilluar nga gjyqtari ai pretendon se nuk i janë vënë në dispozicion vendimi nga gjyqtari, procesverbalet dhe kopje e CD-së së seancave gjyqësore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se subjekti ka dhënë vendimin nr. ***, datë 24.1.2014, duke i “kthyer padinë” denoncuesit E. B., pasi ky i fundit nuk kishte paguar diferencën e taksës së padisë dhe diferencën në vlerën 1% të pretendimit prej 50.000 euro, si dhe nuk paraqiti në gjykatë deri në datën 24.12.2018, kopje të padisë dhe akteve provuese. Nga shqyrtimi i vendimit rezulton se në seancën e datës 24.1.2019 paditësi E. B. është shprehur se “... ai ka marrë CD e seancës së kaluar...”. Nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, për aq kohë sa depozitimi i aktit të kërkesëpadisë dhe kryerja e shpenzimeve gjyqësore nga pala paditëse është një detyrim ligjor që nuk është përmbushur në zbatim të dispozitave ligjore të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile. Shtetasi ka depozituar edhe një kallëzim penal, i cili është trajtuar në germën “iii”, të kapitullit B.3.

21. Denoncimi nr. * prot., datë 7.2.2019, i shtetases Z. T.**

Shtetasja denoncon subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë, pasi nuk ka marrë në konsideratë prova dhe dokumente të depozituara gjatë procesit. Rezulton nga dokumentacioni se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. ***, datë 31.1.2018, duke vendosur “*Pranimin pjesërisht të padisë kundër të paditësit ‘K. O.’ sh.p.k., detyrimin e të paditurit ‘K. O.’ të paguajë në dobi të paditësit S. T., detyrimin kryesor monetar në vlerën 100.000 euro*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka informuar se dosja gjyqësore është dërguar për gjykim në Gjykatën e Apelit Durrës.

22. Denoncimi nr. * prot., datë 6.2.2019, i shtetasit Gj. Gj.**

Denoncuesi denoncon disa subjekte rivlerësimi ndërmjet tyre edhe gjyqtarin Bujar Musta, i cili ka dhënë vendimin nr. ***, datë 19.1.2011 me kërkesë Gj. Gj.. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezulton se vendimi është prishur nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 21.6.2012, duke vendosur “*prishjen e vendimit nr. ***, datë 19.1.2011 dhe kthimin e akteve për gjykim me një tjetër trup gjykues*”, me argumentimin se: “*Gjykata e faktit ka pasur detyrimin ligjor që të vazhdonte gjykimin e çështjes pavarësisht mosparaqitjes së përfaqësuesit të kërkuarit Gj. Gj., e pas të konstatonte mosparaqitjen e tij, duhet të deklaronte mungesën e kërkuarit dhe të vazhdonte gjykimin duke u shprehur me vendim përfundimtar për zgjidhjen në themel*”.

Subjekti i rivlerësimit ka dhënë edhe një vendim tjetër me palë kërkuar Gj. Gj., kundër Prokurorisë, me objekt të ndryshëm nga vendimi i parë i sipërcituar “ankim kundër vendimit datë 22.2.2013, “Për pushimin e çështjes penale” në procedimet penale nr. ***, të vitit 2012, nr. ***, datë 8.5.2014, duke vendosur: “*rrëzimin e kërkesës*”, vendim i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 18.1.2016.

22.1 Denoncuesi ka vënë në dispozicion shkresën nr. *** prot., datë 13.12.2018, të KLD- së, drejtuar gjyqtarit Bujar Musta “Për fillimin e hetimit disiplinor për zvarritje të çështjes penale nr. *** akti, datë 6.6.2017”. Nga shqyrtimi i këtij dokumenti konstatohet se çështja gjyqësore nr. *** akti, datë 6.6.2017 është mbajtur për gjykim nga gjyqtari deri më datë 16.1.2018 dhe më datë 17.1.2018, ai ka paraqitur kërkesën për dorëheqje kryetarit, pra duke kaluar një interval kohor prej 7 muaj e 10 ditë pa u përfunduar. Në vështrim të pikës 5/j të vendimit nr. ***, datë 14.4.2010, të KLD- së “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”, gjykimi i këtyre çështjeve duhet të zgjasë jo më tej se 2 muaj, subjekti i rivlerësimit ka hequr dorë pas 9 seancave

gjyqësore joproductive dhe gjykimi rezulton se ka qenë në fazën fillestare të legjitimitit të palëve në proces. Gjithashtu, në kërkesën e bërë për heqje dore subjekti është shprehur se ka “gjykuar këtë ngjarje më parë duke dhënë vendimin nr. ***, datë 8.5.2014”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar, ka rezultuar se më parë shtetasi ka kërkuar dorëheqjen e gjyqtarit, kërkesë e cila nuk është pranuar. Por më pas ka qenë vet gjyqtari më datë 16.1.2018 që ka paraqitur dorëheqjen - pra pas 4 muajve, edhe pse ka qenë i njohur me shkaqet e parashtruara nga ankuesi kohë më parë. Nisur nga sa më sipër, për subjektin e rivlerësimit është nisur “*fillimi i hetimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit Bujar Musta*”.

23. Denoncimi nr. *, prot., datë 8.1.2020, nga “R. L.”**

Ky subjekt denoncon subjektin e rivlerësimit pasi ka kthyer kërkesat si palë kreditore pa asnjë argument dhe se në asnjë rast nuk janë njoftuar për ndreqjen apo plotësimin e të metave. Raiffeisen Leasing ka bërë me dije se gjyqtari në mënyrë abuzive kthente kërkesat duke i vlerësuar si “me të meta” duke vënë në dispozicion edhe vendimin nr. ***, datë 30.4.2019, i cili është prishur me vendimin nr. ***, datë 3.7.2019 nga Gjykata e Apelit Durrës, dërgimin e çështjes në atë gjykatë dhe vazhdimin e gjykimit me të njëjtin trup gjykues. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 6.5.2021, konstatohet se në datën 7.11.2018 subjekti “R. L.” ka depozituar kërkesën për lëshimin e urdhërezekutimi, duke bashkëlidhur edhe ekstraktet e shoqërive “C.” Sh.p.k. dhe “M. T.” Sh.p.k të datës 6.9.2018. Nga procesverbali i datës 9.11.2018 rezulton se subjekti, pas pranimit dhe administrimit të provave praktike të datës 6.11.2018, të sjella nga pala kërkuese ka vendosur “Kthimin e akteve”. Me vendimin nr. ***, datë 9.11.2018, ai ka shqyrtuar vendimin e lëshimit të urdhërezekutimi, referuar dispozitave të nenit 511, të ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, paragrafi b /2, “shqyrtimi i kërkesës për lëshimin e urdhërezekutimi zhvillohet nga gjyqtari pa praninë e palëve”. Referuar vendimit, subjekti ka kthyer kërkesën e denoncuesit, pasi ky i fundit nuk kishte paraqitur ekstraktin tregtar, ai i paraqitur datonte në gusht të vitit 2018.

Lidhur me vendimin nr. ***, datë 8.3.2019, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka “kthyer kërkesën” pasi denoncuesi nuk kishte depozituar ekstraktin e shoqërisë, por referuar dëftesës së komunikimit datë 11.3.2019, nuk rezulton të jetë firmosur marrja e vendimit nga denoncuesi apo përfaqësuesi i saj. Lidhur me vendimin nr. ***, datë 2.10.2019, subjekti ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës” së shoqërisë “R. L.”. Në përfundim, konstatohet se nuk provohen pretendimet e denoncuesit, pasi shqyrtimi i kërkesës është bërë në përputhje me dispozitat procedurale të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, ndryshuar me ligjin nr. 38/2017.

24. Denoncimi nr. * prot., datë 15.7.2021, i shtetasit E. K.**

Në denoncimin e tij, shtetasi E. K.⁶⁹ denoncon subjektin e rivlerësimit Bujar Musta, për shkelje procedurale në çështjen me palë ndërgjyqëse K. H., zvarritje të procesit me palë ndërgjyqëse me palë shtetasin M. D., njëanshmëri në zgjidhjen e konflikteve gjyqësore në çështjet e inceneratorëve të Elbasanit dhe shoqëritë për të cilat ka vendosur heqjen e sekuestrove të llogarive bankare, gjithashtu po në të njëjtin denoncim ngrihet pretendimi për pasurinë e llojit palestër pranë stadiumit, ku subjekti i rivlerësimit ka apartamentin e tij. Denoncuesi, ndër të tjera, shprehet se edhe pse kjo pasuri është në administrim të familjes V. dhe E. P., është një pronë e fshehur nga subjekti i rivlerësimit, duke shfrytëzuar marrëdhënien shoqërore me këtë familje, e cila, sipas denoncuesit ka pasur shumë probleme me drejtësinë, për të cilat ai i ka ndihmuar për t’u mbyllur.

⁶⁹Ngelet e paqartë lidhja e denoncuesit me denoncimin dhe çështjet në shqyrtim.

Komisioni, nisur nga pretendimi se pasuria e paluajtshme e llojit palestër në pronësi të shtetasës E. P.⁷⁰, konstaton se pas verifikimit të dokumentacionit të disponuar nga ASHK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 16.12.2019, e në vijim rezulton se shtetasi, i ndjeri V. S. P., janë pronarë të disa pasurive të paluajtshme të llojeve njësi dhe apartamente. Gjithashtu, nga kontrolli në faqen www.qkb.gov.al ka rezultuar se shtetasja E. P. ushtron veprimtarinë e llojit palestër në z. k. ***, në pasurinë nr. ***, k. ***, nën emrin tregtar “A. G.”, informacion i cili konfirmohet edhe nga kartela e pasurisë me sip. 161.96 m². Për rrjedhojë, nga hetimi i mësipërm rezulton se pasuria në fjalë është në pronësi të shtetasës E. P., e cila ka përfituar këtë të fundit nëpërmjet kontratës së shkëmbimit të truallit datë 12.7.2004, me shoqërinë ndërtuese “E.” sh.p.k. dhe, për rrjedhojë, pretendimi i denoncuesit mbi pronësinë e kësaj pasurie nuk qëndron. Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shprehur qëndrimin e tij distancues lidhur me këtë familje, për shkak të problemeve me drejtësinë. Lidhur me sa pretendohet nga denoncuesi për zvarritje gjyqimor dhe njëanshmëri, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vënien në dispozicion të procesverbaleve, njoftimit të palëve, si dhe vendimeve lidhur me çështjet e përmendura në këtë denoncim, nga ku ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2021, vuri në dispozicion vendimet dhe procesverbalet e seancave. Nga analizimi i 7 vendimeve me objekt “kundërshtimi i vendimit të sekuestros të Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Elbasan të dhëna nga gjyqtari Bujar Musta në datat 18 - 19.9.2017, me palë kërkuese administratorët dhe ortakët e shoqërive të inceneratorëve si “A. A. T.”, “E. A. F.”, “I. T. S.”, “E. O. A.” “C.G.C”, “A. E.”, ka rezultuar se çështjet i janë kaluar dorazi gjyqtarit Bujar Musta në sistemin elektronik nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, bashkëlidhur edhe praktikat⁷¹. Lidhur me vendimet gjyqësore të dhëna nga subjekti për çështjen civile që i përket palëve T. D. me objekt padie “Zgjidhje martesë” rezulton se subjekti ka marrë 2 vendime “Për kthimin e akteve”, vendimi nr. ***, datë 22.9.2020 dhe vendimi nr. ***, datë 19.1.2021, të kthyer me argumentimin se në momentin e depozitimit të padisë, padia ka pasur të meta. Nga analizimi në tërësi i dokumentacionit në dispozicion rezulton se vendimet i janë dërguar palës paditëse në mungesë, por së paku jo në adresën e përshkruar në vendim, po ashtu edhe nga analizimi i vendimit nr. ***, datë 14.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me palë shtetasen M. L. dhe të paditur Ministria e Financave dhe Ekonomisë është kthyer për shkak të të metave të padisë, por edhe ky vendim me nr. ***, datë 14.7.2020, “Për kthimin e akteve” rezulton të jetë dërguar së paku, jo në adresën e përshkruar.

Pasi është njohur me rezultatet e hetimit, subjekti ka paraqitur shpjegimet e tij dhe ka depozituar edhe dokumentacion mbështetës edhe për sa i përket problematikave të konstatuara lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të përshkruara në rezultatet e hetimit administrativ e të njoftuara nga Komisioni dhe, konkretisht, lidhur me konstatimet e kryera nga ish-KLD-ja dhe KLGJ-ja dhe/ose nga Komisioni, është shprehur si vijon:

a) *Lidhur me vlerësimin e aftësive për kriterin ‘shpejtësinë e gjykimit’ apo kritere të tjera (që kanë lidhje me sistemin e regjistrimit të seancave audio), të kryhet duke marrë në konsideratë ngarkesën shumë të lartë në punë, ashtu edhe peshën që zë kriteri i aftësive përkatëse organizative, në tërësinë e kritereve/nënkritereve të tjera vlerësuese. Në lidhje me aftësitë profesionale të kihen parasysh këto faktorë: në vitin 2013 kam marrë pjesë në provimin përkatës të organizuar nga ish-KLD-ja, organizmat e huaj ndërkombëtar (sipas ligjit nr. 49/2012) dhe jam vlerësuar me 91 pikë. Ky fakt duhet të merret si argument, i cili*

⁷⁰Shtetasja E. P. është person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak të huadhënies në masën prej 1.000.000 lekësh, të cilat kanë shërbyer për pagesën e apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka konfirmuar se nuk ka asnjë çështje me palë ndërgjyqësore E. P. etj., të shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit.

⁷¹Aktet për vendimin nr. ***, datë 6.2.2017, urdhrin nr. ***, datë 31.7.2017, vendimi nr.***, datë 5.7.2017, i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

mund të përdoret për vlerësimin aftësive të tij profesionale, sipas parashikimeve të nenit 41/3 ligjit nr. 84/2016.

- b) Kërkoj të merren parasysh nga ana juaj faktet/qëndrimet vijuese: Vonesat në gjykime/zvarritjet kanë ardhur si rezultat i ngarkesës së lartë në punë dhe nuk kanë qenë të qëllimshme; kompleksiteti i çështjeve dhe vonesat administrative, vitet e gjata që kam në detyrë, nuk kam gabime thelbësore/serioze, nuk kam seri të qarta e të përsëritura, në mënyrë të vazhdueshme të gjykimeve të gabuara apo të jenë me defekte të rëndësishme profesionale, materiale e procedurale, përqindja e dosjeve/gjykimeve të dorëzuara/zhvilluara me vonesë, në raport me ato të dorëzuara/zhvilluara në kohë, rezulton e ulët.*
- c) Çështjet që rezultojnë me ndonjë mangësi (të konstatuar nga ana juaj), të konsiderohen të pamjaftueshme për kualifikimin tim 'me mangësi' apo 'i papërshtatshëm', në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, sepse kam aftësi të mira/të pranueshme/të besueshme/kualifikuese profesionale, kam treguar aftësi të mira/të pranueshme/të mjaftueshme kualifikuese, organizative e profesionale, kam treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, kam treguar aftësi personale/kualifikuese dhe angazhim profesional, kam treguar cilësi të pranueshme/të besueshme/kualifikuese në punë dhe në gjykim, kam respektuar të drejtat e palëve, jam eficient dhe efektiv në kryerjen e detyrës, mendoj se shfaq aftësi kualifikuese në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit e në kryerjen e veprimeve të nevojshme/të domosdoshme procedurale (për organizimin e procesit gjyqësor) dhe zotëroj njohuritë ligjore dhe njohuritë e arsytimit ligjor, shkeljet janë të justifikuara, nuk kam kryer shkelje të qëllimshme të dispozitave urdhëruese procedurale civile e penale.*
- d) Denoncimet nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova kundër meje në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional.*
- e) Mund të kem bërë edhe gabime (me vendime që kanë ndikuar në jetën e njerëzve), por përbejnë përjashtime, nuk kam qenë në anën e të fuqishmit/të fortit, kundër të pafuqishmit/të dobëtis dhe këto gabime nuk janë kryer/bërë me qëllim apo me paragjykim”.*

175. Dokumentacioni i depozituar bashkëlidhur prapësimeve:

- a) akti origjinal nr. ***, datë 21.12.2007, të ish-KLD-së;*
- b) fragment i faqes ***, datë 31.10.2014, të regjistrit të subjektit Bujar Musta; praktika e akteve nr. ***, datë 5.4.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; praktika e akteve nr. ***, datë 17.11.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- c) praktika e akteve të viteve 1997 – 2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe të të tretëve/organe të ndryshme;*
- d) praktika e akteve nr. ***, datë 1.4.2015, të kësaj gjykate dhe parashtrimet e subjektit Bujar Musta të datës 17.4.2015;*
- e) kërkesa nr. *** akti, datë 13.7.2020, e subjektit Bujar Musta;*
- f) praktika e akteve nr. *** prot., datë 8. 9.2020, të kancelarit të Gjykatës Elbasan; praktika e akteve vijuese që përmban: kërkesa origjinale nr. *** akti, datë 1.9.2020 dhe kërkesa origjinale nr. *** akti, datë 4.9.2020, të subjektit Bujar Musta;*
- g) kërkesa origjinale elektronike datë 11.9.2020 nga posta elektronike e subjektit Bujar Musta, në postën elektronike të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; përgjigjja elektronike datë 15.9.2020 e kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan në postën elektronike të subjektit Bujar Musta;*
- h) kërkesa elektronike origjinale datë 15.9.2020, dërguar nga subjekti Bujar Musta, në postën elektronike të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan kërkesa elektronike origjinale datë 29.9.2020 e subjektit Bujar Musta dërguar në postën elektronike të KLGJ-së;*

- i) *praktika e akteve vijuese që përmban: kërkesa origjinale me e-mail nr. ***, datë 29.9.2020 e subjektit Bujar Musta*⁷²,
- j) *kërkesat nr. ***, datë 10.7.2019, nr. ***, datë 26.11.2019 (dhe kërkesa nr. ***, datë 29.9.2020, e subjektit Bujar Musta, drejtuar Postës Publike sh.a.;*
- k) *ankimi datë 26.3.2013 i subjektit Bujar Musta (drejtuar ish- KLD-së); praktika e akteve origjinale nr. ***, datë 25.4.2013, të ish-KLD-së;*
- l) *vendimi penal nr. ***, datë 12.11.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- m) *vendimi origjinal civil nr. ***, datë 4.1.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- n) *vendimi origjinal civil nr. ***, datë 14.2.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- o) *vendimi origjinal civil nr. ***, datë 28.3.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- p) *vendimi origjinal civil nr. ***, datë 12.12.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- q) *vendimi origjinal civil nr. ***, datë 24.1.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- r) *vendimi origjinal civil nr. ***, datë 12.1.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- s) *vendimi origjinal civil nr. ***, datë 11.5.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- t) *vendimi origjinal penal i veçantë nr. ***, datë 10 .11.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- u) *vendim civil nr. ***, datë 1.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (dhe kopje e legalizuar e dëftesës se komunikimit nr. ***, datë 4.2.2019, të së njëjtës gjykate, për këtë vendim);*
- v) *vendimi civil nr. ***, datë 25.4.2019, i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Elbasan, kopje e legalizuar;*
- w) *vendimi civil nr. ***, datë 25.10.2019, i Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Elbasan, kopje e legalizuar kopje e legalizuar e dëftesës se komunikimit nr. ***, datë 28.10.2019;*
- x) *vendimi civil nr. ***, datë 19.11.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kopje e legalizuar;*
- y) *vendimi i legalizuar i veçantë civil nr. ***, datë 31.10.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe vendimi i veçantë origjinal civil nr. ***, datë 5.2.2019, i Gjykatës së Apelit Durrës;*
- z) *vendimin origjinal i veçantë penal nr. ***, datë 18.10.2017 (i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me kërkuese R. A.;*
- aa) *deklarimet datë 11.1.2019 të subjektit Bujar Musta, në adresë të KLD/inspektorit përkatës;*
- bb) *vendimet origjinale penale nr. ***, datë 18.9.2017; nr. ***, datë 18.9.2017; nr. ***, datë 18.9.2017; nr. ***, datë 18.9.2017; nr. ***, datë 18.9.2017; nr. ***, datë 18.9.2017 dhe nr. ***, datë 19.9.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;*
- cc) *vendimet e veçanta civile nr. ***, datë 22.9.2020 dhe nr. ***, datë 19.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kopje të legalizuara secila;*
- dd) *praktika e akteve vijuese që përmban: prapësimet origjinale datë 4.11.2019, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për padinë nr. *** akti, të vitit 2019 të paditësve B. T. etj.; procesverbalet e mbajtura; vendimin origjinal civil nr. ***, datë 21.11.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; fletën elektronike origjinale të shortit civil RIV nr.*

⁷²Dërguar në postën elektronike të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; kërkesa origjinale me e-mail nr. ***, datë 5.10.2020 e subjektit Bujar Musta, dërguar në postën elektronike të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; përgjigjja, me e-mail të datës 6.10.2020, kancelarit të kësaj gjykate, dërguar në postën elektronike të subjektit Bujar Musta; kërkesa origjinale me e-mail nr. ***, datë 6.10.2020 e subjektit Bujar Musta, dërguar në postën elektronike të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; kërkesa origjinale me e-mail nr. *** dhe ***, datë 21.10.2020 e subjektit Bujar Musta, dërguar në postën elektronike të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; kërkesa origjinale me e-mail nr.***, ***, *** dhe ***, datë 22.10.2020, e subjektit Bujar Musta, dërguar në postën elektronike të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; kërkesa origjinale me e-mail nr. ***, datë 22.10.2020, e subjektit Bujar Musta, dërguar në postën elektronike të kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

***, të vitit 2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, pas kthimit të kësaj çështjeje për rigjykim dhe aktin origjinal të datës 20.8.2021, të kryesekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;

ee) aktin origjinal datë 19.8.2021 të Arkivit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (sipas së cilës dosja civile e paditësit "K. O." është në Gjykatën e Apelit Durrës;

ff) raportet elektronike origjinale të datave 5.1.2018 dhe 7.2.2018, të kryetarit dhe kancelarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

176. Lidhur me raportin profesional, subjekti ka parashtruar se:

- a) Parashtrime për dokumentin nr. 1 që i përket vendimit nr. ***, datë 8.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Subjekti ka parashtruar se: *"Jam dakord, që edhe mund ta parashikoja në vendim faktin/elementin se kur fillon afati i ankimit sipas nenit 415 të Kodit të Procedurës Penale. Mospasqyrimi prej meje i këtij elementi formal nuk cenon në thelb të drejtat e palëve. Megjithëse për palët e kësaj çështjeje, afati fillonte nga dita e shpalljes së vendimit, përsëri secila palë ka pasur mundësi të njihet me vendimin përfundimtar të gjykatës, për këtë çështje, në afatin e arsyeshëm dhe palët kanë pasur mundësi të ushtrojnë efektivisht të drejtën e tyre të ankimit".*
- b) Parashtrime për dokumentin nr. 2 që i përket vendimit nr. ***, datë 25.5.2014, subjekti ka shpjeguar: *"Mund të ketë zgjatje të procedurave, por nuk tregon se unë kam vonuar veprimet ose të kem periudhë pasiviteti, sepse vendimet e ndërmjetme në këtë çështje janë të arsyetuara. Pra, konstatimi i ish-KLD-së, në raport me dinamikën, rrethanat konkrete të çështjes për ngarkesën time në punë, kuadrit ligjor të zbatueshëm procedural e material, në fuqi dhe rolit tim në çdo seancë mendoj se nuk përbejnë sjelljen time të zakonshme, në këtë çështje edhe zvarritja e pretenduar e humbet relevancën trajtimin e saj si mangësi të vlefshme, për t'u evidentuar në drejtim të aftësive të mia organizative apo për të administruar dosjet. Nuk mund të qëndroj si shkak një shkelje që në vetvete përmban arsye objektive justifikimi, qoftë kjo edhe e përsëritur.*
- c) *Nga ish-KLD-ja nuk është marrë parasysh ngarkesa ime shumë e lartë në punë, në periudhën përkatëse; zvarritjet në këtë çështje nuk janë të qëllimshme dhe ish-KLD-ja ka mbajtur qëndrime me dy standarde, për të njëjtat problematika, që kanë pasur gjykatësit e tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; vonesa në gjykimin e çështjeve nuk duket të jetë një problematikë e kufizuar në gjyqtarë të veçantë. Nga burimet e hapura të informacionit (sikurse janë edhe studimet e kryera nga institute jopublike), ky fenomen rezultonte evident edhe në vetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (ndonëse ata asistohen nga këshilltarë ligjorë e staf ndihmës /mbështetës); për gjithë sa më sipër, unë jam tërësisht i vetëdijshëm për rëndësinë që ka shpejtësia në gjykim) dhe ndonëse ky pohim duket sikur nuk përputhet me realitetin e evidentuar nga ju, më duhet të shpjegoj rrethanat dhe arsyet e kësaj suate. Nuk më ka munguar dëshira për zgjidhjen e çështjes në afate të arsyeshme, por kanë qenë kushte të tjera që nuk lidhen me detyrën time dhe nuk varen, në parim, nga gjyqtari, me kohën time të punës apo me aftësinë për të menaxhuar kryerjen e detyrës; veprimet administrative e procedurale janë kryer prej meje personalisht dhe nën kujdesin apo mbikëqyrjen time. Asnjë nga pretendimet e mia në KLD e Ministrinë e Drejtësisë nuk janë verifikuar në pikëpamjen administrative apo procedurale.*
- d) *Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion edhe aktet me datë 4.9.2020, të cilat nuk gjenden në këtë gjykatë për shkaqe që ose janë humbur, zhdukur, grisur apo çdolloj shkaku tjetër, por e rëndësishme është se ato mungojnë dhe nuk jepet (nga kancelari) shkaku i mungesës së tyre; unë ju kam paraqitur me datë 4.9.2020 aktet përkatëse që kisha ruajtur unë; bashkëlidhur këtij materiali po ju paraqes kërkesën time nr. *** akti, të datës 13.7.2020 (drejtuar kancelarit të kësaj gjykate) dhe përgjigjen e tij datë 8.9.2020, për aktet*

që u gjendën në këtë gjykatë (ku sigurisht nuk janë asnjë prej akteve, që unë ju kam dërguar në datën 4.9.2020)”.

- e) Parashtrime mbi dosjen nr. ***, që ka të bëjë me çështjen nr. ***, datë 6.6.2013, ka cituar se: *“I padituri ka marrë dijeni për padinë e provat, u ftua që të dëgjohet, ai nuk u paraqit dhe nuk njoftoi mungesën; për këto shkaqe u deklarua mungesa e të paditurit në seancë përgatitore dhe nuk u çmua thirrja e tij në seancë gjyqësore; vendimi përfundimtar është arsyetuar me shpejtësi, i padituri ka pasur dijeni për vendimin përfundimtar dhe ai nuk ka paraqitur ankim. Pra, i padituri nuk ka paraqitur pretendime për njoftimet e dërguara në adresë të tij, për këtë çështje (përfshirë edhe njoftimin për seancën në të cilën u deklarua mungesa e tij); i padituri nuk ka pretenduar padijeninë e tij për padinë, provat dhe për procesin; për këto shkaqe mendoj se mosthirrja e tij në seancë gjyqësore nuk do të thotë se ndaj te paditurit nuk është respektuar parimi i kontradiktoritetit.*
- f) Gjykimi mund të jetë jashtë afatit, por jo për shkaqe që lidhen me kryerjen e detyrës prej meje/subjekti i rivlerësimit, për shkaqet vijuese mund të ketë zgjatje të procedurave, por nuk tregon se unë kam vonuar veprimet ose të kem periudhë pasiviteti, sepse vendimet e ndërmjetme në këtë çështje janë të arsyetuara, me tekst të qartë, duke referuar qartë shkaku e shtyrjes (që kanë lidhje me nenet 125, 315 etj. të Kodit të Procedurës Civile) dhe në kohën/fazën e duhur procedurale; pas çdo seance janë kryer veprime në funksion të seancës së radhës; këto veprime ose vendime të ndërmjetme (për ndërprerjen e seancave) ishin të motivuara/arsyeshme/të domosdoshme. Shtyrjet e seancave kishin qëllim për të mos passjellë cenimin e procesit gjyqësor; aktet janë renditur e kontrolluar për çdo seance (e deri në ditën e dorëzimit sekretares, që ajo ta dorëzojë në kryesekretari), nën kujdesin tim; me përjashtim të fletëthirrjeve, të gjitha aktet e tjera të njoftimit përmbajnë nënshkrimin tim; për të gjitha këto veprime/akte njoftimi dhe administrimi tyre kam pasqyruar në çdo dosje shënimet e mia të kontrollit/verifikimit, për të evituar humbjet/heqjet e akteve nga të tretë; por të kryhet gjithë kjo veprimtari e domosdoshme administrative e procedurale kujdesi, për çdo dosje, kërkohet një kohë/vëmendje e caktuar, që ndikon dhe passjell zvarritje të gjykimit të çështjeve në tërësi; pra, konstatimi i ish- KLD-së në raport me dinamikën, rrethanat konkrete të çështjes, ngarkesën time në punë, kuadrit ligjor të zbatueshëm procedural e material, në fuqi dhe rolin tim në çdo seancë mendoj se nuk përbejnë sjelljen time të zakonshme në këtë çështje dhe zvarritja e pretenduar e humbet relevancën trajtimin e saj si mangësi të vlefshme, për t’u evidentuar në drejtim të aftësive të mia organizative. Nuk mund të qëndroj si shkak një shkelje që në vetvete përmban arsye objektive justifikimi, qoftë kjo edhe e përsëritur; përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje pretendimeve/prapësimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që kam arritur. Në nxjerrjen e konkluzioneve kam pasur parasysh analizën e çështjes e provave, nisur nga çmuarja e tyre/provave në tërësi dhe jo nga prioriteti i ndonjë prove të caktuar; opinionet ligjore janë të qarta, të drejtpërdrejta; vendimi paraqitet i thjeshtë, i kuptueshëm dhe është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor; për sa i takon afatit (që përcaktohej sipas Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit që ka miratuar KLD-ja), në vetë këtë aneks thuhet se ‘... afati është orientues dhe jo detyrues’; pra, edhe vlerësimi duhet të jetë në raport me specifikat e çështjes konkrete. Standardi i KLD-së prezumon mundësi objektive e subjektive për të kryer detyrën pa cenuar asnjë komponent tjetër të punës sime. Në fakt, evidentohet se numri i çështjeve të gjykuara prej meje është shumë më i lartë nga standardi sasior i përcaktuar nga KLD-ja; për rrjedhojë, tejkalimi i ngarkesës standard, prezumon edhe tejkalimin e kohës së punës, që konsiderohet e arsyeshme për një gjyqtar. Fatkeqësisht, koha e punës është gjithnjë e njëjtë, ndaj brenda saj, gjyqtarit do t’i duhet të përmbushë të gjitha detyrimet e tij duke bërë maksimumin. Parimisht, duke marrë në konsideratë të gjithë elementet që

(sipas eksperiencave më të mira ndërkombëtare dhe sipas legjislacionit tonë të brendshëm) merren në konsideratë për vlerësimin e gjyqtarit dhe që përfshijnë të gjithë procesin e tij të punës, një vend të rëndësishëm e zënë edhe aftësitë organizative të tij, e në këtë kuptim eficienta në punë. Ky kriter vlerësues lidhet drejtpërdrejt edhe me garancitë për zhvillimin e një procesi gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, si një ndër komponentët e procesit të rregullt. Në çdo rast jam orientuar nga standardet që lidhen me organizimin dhe menaxhimin e kohës, në mënyrë të veçantë nga aktet e Komisionit European për Eficiencën e Drejtësisë. Meqenëse gjykimi i një dosjeje të caktuar kërkon thellim, reflektim dhe kohën e saj të nevojshme. Në rast se nuk do të kihet kjo kohë në dispozicion (që quhet 'kohë cilësore për vlerësim'), gjykimet do të jenë pa cilësi, të shpejta dhe në dëm të interesave të palëve; ky është fenomen që ka ndodhur dhe është vënë në dukje edhe në vendet me sistem gjyqësor të konsoliduar (siç ndodhi në muajin qershor të vitit 2016 në Belgjikë, ku gjyqtarët protestuan kundër qeverisë, për të ruajtur pavarësinë e sistemit); përkufizimi se '... kohëzgjatja e procedimeve gjyqësore është ajo kohëzgjatje, e cila mund të përkufizohet si një triologji qëllimesh për sistemet gjyqësore, funksionimi i të cilave duhet të jetë: i drejtë, i përballeshëm dhe në një kohë të arsyeshme ...' tregon për rëndësinë e harmonizimit të kohës gjyqësore (pjesë e afatit të arsyeshëm), me cilësinë e dhënies së drejtësisë, përfshirë edhe cilësinë e një vendimi gjyqësor bindës e të argumentuar. Në parim, mendoj se afati i gjykimit nuk mund të merret i shkëputur nga analiza e çështjeve konkrete dhe specifikat e tij, nga volumi i provave të nënshtruara debatit gjyqësor, si dhe veprimeve procedurale të kryera nga gjykata, pretendimeve e prapësimeve të palëve, numrit të palëve që marrin pjesë në gjykim dhe kohës që nevojitet për njoftimin e palëve; çdolloj vendimmarrjeje është dëshmi e një procesi mendimesh e qëndrimesh sipas bindjes së brendshme; seancat janë parashikuar për të qenë produktive dhe shtyrjet e tyre kanë qenë përherë të motivuara/të arsyeshme; nga ish-KLD-ja nuk është marrë parasysh ngarkesa ime shumë e lartë në punë, në periudhën përkatëse. Bazuar në nenin 14 të Kodit të Procedurës Civile, jam kujdesur të zhvilloj një proces të rregullt gjyqësor, të zhvilloj hetim të plotë e të gjithanshëm në përputhje me ligjin; prandaj nuk ishte në interesin e palëve, që procesi të përfundojë pa marrë provat e nevojshme, pa kryer veprimet e nevojshme procedurale, pa sqaruar pretendime e prapësimet, njëkohësisht duhet të merret parasysh koha që nevojitet për njoftimin e palëve; pra, një proces i kontestuar nga pikëpamja procedurale, rrezikon fatin e vendimit përfundimtar ose jopërfundimtar të çështjes përkatëse, pavarësisht besueshmërisë së tij; njëkohësisht duhet të merret parasysh koha që nevojitet për njoftimin e palëve; zvarritjet në këtë çështje nuk janë të qëllimshme dhe ish-KLD-ja ka mbajtur qëndrime me dy standarde për të njëjtat problematika, që kanë pasur gjykatësit e tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; vonesa në gjykimin e çështjeve nuk duket të jetë një problematikë e kufizuar në gjyqtarë të veçantë. Nga burimet e hapura të informacionit (sikurse janë edhe studimet e kryera nga institute jopublike), ky fenomen rezultonte evident edhe në vetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (ndonëse ata asistohen nga këshilltarë ligjorë e staf ndihmës/mbështetës); për gjithë sa më sipër, unë jam tërësisht i vetëdijshëm për rëndësinë që ka shpejtësia në gjykim dhe (ndonëse ky pohim duket sikur nuk përputhet me realitetin e evidentuar nga ju) më duhet të shpjegoj rrethanat dhe arsyet e kësaj situate. Nuk më ka munguar dëshira për zgjidhjen e çështjes në afate të arsyeshme, por kanë qenë kushte të tjera, që nuk lidhen me detyrën time dhe nuk varen, në parim, nga gjyqtari me kohën time të punës apo me aftësinë për të menaxhuar kryerjen e detyrës; veprimet administrative e procedurale janë kryer prej meje personalisht dhe nën kujdesin e mbikëqyrjen time. Asnjë nga pretendimet e mia në KLD e Ministrinë e Drejtësisë nuk janë verifikuar në pikëpamjen administrative apo procedurale; kam qenë i kujdesshëm në akte dhe në arsyetim; kam mbajtur aparençë korrektësie e modestie, pa teprime procedurale apo administrative dhe nuk kam rrezatuar asgjë të privilegjuar; kam punuar në kushte jonormale dhe me ngarkesë

disproporcionale. Këtu nuk ishte fjala për sakrificë për të kryer detyrën (sepse jam mësuar me vështirësitë), por bëhej fjalë për ngarkesë artificiale me prapavijë të caktuar dhe çështjet më jepeshin pa short të rregullt, nga kryetari dhe kancelari i gjykatës, pikërisht që të kisha ngarkesë; për çdo dosje që kam marrë për veprime, kam bërë shënimin 'pa short', në regjistrin e marrjes së dosjes përkatëse në dorëzim. Këto fakte u janë bërë të ditura ish-KLD-së (në periudhën kohore të viteve 2009 - dhjetor 2017), ministrisë së Drejtësisë (në periudhën kohore të viteve shkurt 2008 - korrik 2013) dhe nuk janë verifikuar asnjëherë, nëse jepeshin ose jo, pa short të rregullt; që prej shkurtit të vitit 2008, nuk më janë dhënë nga kryetari i Gjykatës, kancelari dhe/ose pjesa tjetër e administratës, as vendimet e Gjykatës së Apelit dhe/ose të Gjykatës së Lartë (që lidheshin me vendimet e mia) dhe as që bëhej fjalë të më jepeshin vendimet e Gjykatës së Lartë apo të Apelit, që lidheshin me vendimet e gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (shihni disa nga aktet që ju kam dërguar me datë 4.9.2020). Këto të meta të strukturës drejtuese të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (kryetar e kancelar), i janë vënë në dukje ish-KLD-së, në vitin 2015, për efekt vlerësimit prej tyre të gjykatësit A. V., në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (sipas praktikës së akteve nr. ***, datë 1.4.2015, të kësaj gjykate), ku unë i kam parashtruar KLD-së të gjitha të metat, shkeljet dhe parregullsitë e tij administrative e procedurale, vihen në dijeni mosdhënia e kodekseve etj. (rrethana e të meta të cilat ndikonin në mbarëvajtjen e veprimtarisë time administrative e procedurale); por KLD-ja, jo vetëm që nuk i verifikoi këto pretendime të miat, por e transferoi kryetarin përkatës, në muajin prill të vitit 2016, në detyrën e gjykatësit, në Gjykatën e Apelit Durrës; aktet që ju kam dërguar me datë 4.9.2020, nuk gjenden në këtë gjykatë për shkaqe që ose janë humbur, zhdukur, grisur apo çdolloj shkakut tjetër, por e rëndësishme është se ato mungojnë dhe nuk jepet (nga kancelari) shkakut i mungesës së tyre; unë ju kam paraqitur me datë 4.9.2020 aktet përkatëse që kisha ruajtur unë; bashkëlidhur këtij material po ju paraqes kërkesën time nr. *** Akti, të datës 13.7.2020 (drejtuar kancelarit të kësaj gjykate) dhe përgjigjen e tij për aktet që u gjendën në këtë gjykatë (ku sigurisht, nuk janë asnjë prej akteve, që unë ju kam dërguar datë 4.9.2020); pra, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka ruajtur korrespondencën që unë kam pasur me strukturat e saj (kryetar, kancelar dhe pjesën tjetër të administratës gjyqësore), në funksion të ushtrimit të detyrës sime. Po, nëse nuk do të kisha ruajtur një kopje të këtyre akteve (që ju kam dërguar me datë 4.9.2020), si do t'i provoja unë kërkesat apo pretendimet e mia, që ju parashtrova më lart?! Sigurisht, nuk do jua provoja, në asnjë mënyrë tjetër, duke pasur parasysh këtë sjellje jo profesionale dhe pa përgjegjësi të strukturave të kësaj gjykate, që nga muaji shkurt i vitit 2008 e deri në muajin maj të vitit 2021. E theksoj këtë periudhë fundore, sepse e njëjta mënyrë sjellje të strukturave të kësaj gjykate vijoi edhe në periudhën kohore, prej muajit shtator të vitit 2020 e deri në muajin maj të vitit 2021, megjithëse ju kam kërkuar Këshillit të Gjykatës e kancelarit të kësaj gjykate, të evitojnë parregullsitë e konstatuara në veprimtarinë administrative dhe procedurale të kësaj gjykate (për pjesën që ndikonte edhe në kryerjen e detyrës time) dhe ka vijuar e njëjta natyrë pune administrative e procedurale; bashkëlidhur këtij material po ju paraqes edhe aktet vijuese: kërkesat e mia origjinale nr. *** Akti, datë 1.9.2020, nr. *** Akti, datë 4.9.2020; të njëjtat kërkesa, por të dërguara në datën 11.9.2020 nga posta ime elektronike, në postën elektronike të kancelarit të kësaj gjykate; përgjigjja joshteruese, që kancelari i kësaj gjykate më dërgoi më 15.9.2020, nga posta e tij elektronike në postën time elektronike; kërkesën time të përsëritur të datës 15.9.2020, dërguar nga posta ime elektronike në postën elektronike të kancelarit të kësaj gjykate dhe kërkesën time datë 29.9.2020 dërguar nga posta ime elektronike në postën elektronike të KLGJ-së, për të njëjtën problematikë; deri në muajin maj të vitit 2021, nuk kam marrë asnjë vendim të Gjykatës së Apelit Durrës apo të Gjykatës së Lartë, që të ketë shqyrtuar vendimet e mia (me përjashtime të vendimeve e dosjeve përkatëse, që janë prishur dhe më paraqiten për

vazhdimin e gjykimit, po prej meje); pra, në vlerësimin në tërësi të rrethanave të sipërcituara ju parashtroj se nuk kisha mundësi objektive e subjektive të njihesha as me praktikën e gjykatave më të larta për çështje që gjykonin vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për t'u njohur me qëndrimet e konsoliduara/pratikën e tyre të momentit), nuk evidentohet, nëpër aktet procedurale detyra e personave të caktuar; nuk rinovoheshin pajisjet e mia teknologjike (kompjuterat e printerat etj.), megjithëse nuk mungonin dhe megjithëse ju kam bërë kërkesa të ndryshme, në periudha të ndryshme; shumica e gjyqtarëve (veçanërisht gjyqtarët e dhomës penale), për periudhën kohore të viteve shkurt 2008 - maj të vitit 2011, ju plotësoheshin kërkesat e tyre të ndryshme, nga titullarët përkatës (kryetar, zëvendëskryetar + kancelar + zyra e buxhetit + arkivi) edhe pa kërkesë me shkrim të gjyqtarëve të caktuar e duke përfutur avantazhe disproporcionale. Në këto zyra, megjithëse, unë ju kam bërë kërkesa me shkrim, nuk janë plotësuar, me keqdashje, pa shkaqe ligjore dhe tendencioze; Pra, përmbushja e kërkesave të gjyqtarëve të tjerë, realizohej për shkak të tarave dhe interesave të ngushta/meskine, që nuk kanë lidhje me parimet e gjithëpranuara të miradministrimit gjyqësor (dhe funksionimit të administrimit gjyqësor e procedural të gjykatës), paanësisë, drejtësisë dhe përgjegjshmërisë/përgjegjësisë (me këtë rast, unë nuk pretendoj diskriminimin); por, nëse kancelari do t'u kthente përgjigje kërkesave të mia, do të vërtetoheshin pretendimet e mia dhe (njëkohësisht) përgjegjësia për mosushtrimin e detyrës, të strukturave drejtuese të kësaj gjykate, për periudhat e caktuara kohore, që kanë lidhje me aktet e sipërcituara. Edhe sot e kësaj dite, kancelari nuk i ka kthyer përgjigje kërkesave të mia të sipërcituara, duke sfiduar aktet ligjore e nënligjore. Ka munguar stafi mbështetës, organizimi jo efikas i administratës gjyqësore dhe i shërbimit postar publik, për njoftimet e palëve me seli/banim jashtë qytetit Elbasan; ka munguar pjesëmarrja e nëpunësve në salla dhe efektiviteti joefikas i ftuesve të gjykatës (shihni disa nga aktet që ju kam dërguar me datë 4.9.2020, ku evidentohen kërkesat e mia për t'u njohur me këto vendime); kryetari i gjykatës dhe kancelari i gjykatës (në periudhat kohore nga muaji shkurt i vitit 2008 e deri në fund të muajit maj të vitit 2021), janë njohur në vazhdimësi, me këto akte/kërkesat/ankesat e miat, në lidhje me mangësitë e veprimeve të ftuesve të gjykatës dhe mangësitë e shërbimit postar për të njoftuar aktet rregullisht (përveçse duhet të ushtrojnë kontroll kryesisht, për veprimtarinë e ftuesve të gjykatës; përveçse duhet të ndjekin marrëdhëniet administrative me shërbimin postar) dhe nuk kanë marrë masa ndaj ftuesve (bashkëlidhur keni kërkesat e mia/subjekti nr. ***, datë 10.7.2019, nr. ***, datë 26.11.2019 e nr. ***, datë 29.9.2020, drejtuar Postës Publike sh.a., në lidhje me parregullsitë e njoftimeve për palët në proces); eliminimi/evitimi i parregullsisë dhe çdolloj shkakut tjetër, që e krijon/ndikon në zvarritjen e gjykimit të çështjeve, e kam vlerësuar jo vetëm personalisht (me detyrën e gjyqtarit), por ka qenë natyrë pune e imja, edhe kur kam qenë drejtues në këtë gjykatë (bashkëlidhur po ju dërgoj praktikën e akteve të viteve 1997- 2005 të kësaj gjykate, të përpiluar prej meje apo të tretë, që kanë lidhje me aktivitetin e gjykatës) e në vijimësi; zvarritjet nuk janë kryer me qëllim apo për shkak të neglizhencës në ushtrimin e detyrës, prej meje; por palët e kësaj çështjeje, kanë marrë dijeni për vendimet e ndërmytme, kanë marrë dijeni për vendimin përfundimtar, duke iu dhënë mundësia për t'u ankuar në rrugë procedurale dhe administrative; nuk kam gabime serioze apo thelbësore apo mangësi thelbësore profesionale, në këtë dosje. Unë jam i mendimit që një ligj i mirë ka më shumë rëndësi se një gjyqtar i mirë; me ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Civile është rritur efikasiteti i veprimtarisë time administrative e procedurale, në përputhje me mundësitë teknike dhe administrative që ka në dispozicion. Kam pasur ngarkesë në punë (përveçse m'i jepnin çështjet pa short, në periudhën shkurt 2008 - maj 2021), me dy salla me audio, gjykimet zhvilloheshin në zyre, çka mund të pengonte pjesëmarrjen e shumë palëve dhe përjashtuar publikun (për të cilët nuk kishte mundësi objektive për pjesëmarrjen në gjykim). Por palët janë njohur me procesverbalet e seancave manuale dhe nuk kanë

pasur vërejtje me përmbajtjen e tyre; në afatin e gjykimit ka ndikuar edhe kompleksiteti i çështjes dhe sjellja e palëve në gjykim, kërkesat procedurale të bëra nga palët, të cilat kanë ndikuar në zgjatjen e procesit gjyqësor. Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit, për çështje të së njëjtës natyrë nuk kanë mbajtur qëndrim të unifikuar, në interpretimin e ligjit; trupa gjyqësore në Elbasan, në periudha të caktuara, nuk ka qenë e plotë; është marrë ngarkesa e gjyqtarëve të tjerë (të cilët ishin transferuar ose mungonin për një kohë të gjatë); nuk ka pasur një sistem elektronik efikas dhe punohej në mënyrë manuale; nuk ka funksionuar sistemi në tërësi. Kanë ndryshuar ligjet, por ky sistem nuk i përshtatej ndryshimeve ligjore dhe organizimit të veprimtarisë administrative e procedurale me personel (ftues të tjerë etj.), si nga ministria apo KLD-ja, ashtu edhe organizimi i vetë gjykatës. Numri i çështjeve, jashtë afatit, janë në një përqindje të vogël. Duke marrë parasysh edhe detyrimin ligjor (që të gjitha proceset gjyqësore duhet të zhvilloheshin në sallën e gjykimit, ku të regjistrohej në sistemin audio); sistemi i regjistrimit audio të seancave gjyqësore është implementuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan në vitin 2013; por nga ky vit e deri në fund të vitit 2017 regjistrimet audio të seancave bëheshin vetëm në dy sallat penale, në katin 1, të vetmet në gjykatën e vjetër të Elbasanit. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së sallave, regjistrimet audio janë bërë kryesisht për çështje penale (themeli e masa sigurimi) dhe rrallë për ndonjë çështje civile, me shumë palë ose ndonjë çështje civile (kur është kërkuar prej palëve) ose për ndonjë çështje tjetër të veçantë penale, me objekt ‘kundërshtim vendimi të Prokurorisë’. Pjesën më të madhe të çështjeve civile i kam zhvilluar në zyrën time në katin e 2-të, ku nuk ishte instaluar sistemi për regjistrimin audio të seancave. Si konkluzion, mendoj dhe kërkoj që vlerësimi i aftësive për kriterin ‘shpejtësinë e gjykimit’, të kryhet, duke marrë në konsideratë sa ngarkesën shumë të lartë në punë, ashtu edhe peshën që zë kriteri i aftësive përkatëse organizative, në tërësinë e kriterëve/nënkriterëve të tjera vlerësuese, paragraf ky i cili është përsëritur disa herë nga subjekti i rivlerësimit”.

g) Parashtrime për dosjen nr. 4, subjekti ka shprehur se: “Çështja më është caktuar pa short të rregullt; vendimi im ‘për caktimin e seancës përgatitore ‘është disponuar brenda afatit ligjor; shtyrjet e seancave janë të motivuara/me arsye dhe palët nuk kanë pasur pretendime; në caktimin e seancave të reja është mbajtur parasysh ngarkesa me gjykime të tjera. Afati 6-mujor standard është kaluar vetëm për 2 muaj (pra, nuk është tejkallim në muaj të konsiderueshëm). Gjykimi mund të jetë jashtë afatit, por jo për shkaqe që lidhen me kryerjen e detyrës, prej meje, për shkaqet vijuese: (në të cilën ai shprehet sikurse në paragrafin më sipër lidhur me problematikat administrative dhe kërkesat e tij të depozituara kancelarit dhe kryetarëve të gjykatës ndër vite për miradministrimin e procesit të punës), si dhe kërkesave në vijimësi dërguar ish-KLD-së)”.

177. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, në prapësimet në analizë, ka përsëritur të njëjtin fragment (si më lart) përgjatë të gjitha prapësimeve të depozituara nga ana e tij, duke parashtruar të gjitha argumentet e sipërcituara dhe problematikat e përmendura në këtë paragraf të shoqëruara me dokumentacion të depozituar në ish-KLD dhe kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nga viti 2008 e në vijim, kërkesa të cilat kanë të bëjnë me administrimin, menaxhimin dhe zhvillimin e proceseve gjyqësore, të cilat kanë sjellë si pasojë problematikat në vijimësi, si mungesa e shortit dhe/apo mosnjoftimi i palëve për shkak të mungesës së logjistikës.

178. Parashtrime lidhur me të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së, ku subjekti ka parashtruar se:

a) Ju qëndroj të njëjtave shkaqe që kam parashtruar në çështjen/padinë gjyqësore me nr. ***, datë 13.6.2016, që i përket padisë time kundër ish-KLD-së, me objekt “ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 14.10.2015, të të paditurit KLD. Për sa i përket vlerësimit ‘mirë’ dhe

në përfundim të vendoset vlerësimi 'shumë mirë', për periudhën 2007 – 2009", të gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

- b) Ju qëndroj të njëjtave shkaqe që kam parashtruar, në apelimin e kësaj çështjeje; ju qëndroj të njëjtave shkaqe që kam parashtruar në rekursin e kësaj çështjeje. Për më tepër theksoj se ish-KLD-ja nuk e ka arsyetuar vendimin e saj nr. ***, datë 14.10.2015, objekt i padisë time; pra, edhe mbrojtja ime në atë çështje nuk ishte efektive.*
- c) Në lidhje me çështjen civile nr. ***, datë 22.9.2015, që i përket padisë time kundër ish-KLD-së, me objekt "anulimi/shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 16.7.2014, të ish-KLD-së, për masën disiplinore "vërejtje me paralajmërim", ju parashtroj, se: ju qëndroj të njëjtave shkaqe që i kam parashtruar ministrit të Drejtësisë (për materialin që i kishte referuar ish-KLD-së); ju qëndroj të njëjtave shkaqe që i kam parashtruar ish-KLD-së; ju qëndroj të njëjtave shkaqe që kam paraqitur në padinë time, kundër kësaj vendimmarrjeje të KLD-së; ju qëndroj të njëjtave shkaqe që kam parashtruar në rekursin tim ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ.*
- d) Për më tepër e theksoj se ish-KLD-ja nuk e ka arsyetuar vendimin e saj nr. ***, datë 16.7.2014, objekt i padisë time, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative në fuqi dhe sipas ligjit organik në fuqi për KLD-në; pra, edhe mbrojtja ime në atë çështje nuk ishte efektive; ndërsa Gjykata Administrative e Apelit nuk i është përgjigjur, nuk ka arsyetuar të gjitha pretendimeve/kërkesave të mia (të parashtruara në padi e gjatë gjykimit) dhe nuk ka arsyetuar shkaqet për të cilat nuk janë të bazuara kërkesat/prendimet/parashtrimet e mia, siç përcakton Kodi i Procedurës Civile dhe ligji nr. 49/2012.*

179. Gjithashtu, veç të tjerash, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar, sa vijon:

- e) Në përputhje me shkaqet e rrethanat e sipërcituara, kërkoj të merren në shqyrtim parashtrimet/prendimet/prapësimet e mia që i kam drejtuar ministrit të Drejtësisë dhe ish-KLD-së për atë procedim disiplinor.*
- f) Të vlerësohen e çmohen pretendimet/parashtrimet e mia në këtë material dhe provat shkresore bashkëlidhur këtij materiali (që i drejtohem KPK-së).*
- g) Të mos merren në konsideratë pretendimet, referimet, parashtrimet e ish-KLD-së dhe as materiali i ministrit të Drejtësisë për çështjet civile objekt procedimi disiplinor; kriteret parimore e procedurale të vlerësimit tim të trajtohen e vlerësohen nga ana juaj në përputhje me tërësinë e procedurave të ndjekura prej meje në këto çështje, sipas drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe praktikës së konsoliduar procedurale civile dhe administrative, që ishin në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjeve përkatëse civile .*

180. Parashtrime për rivlerësimin e aftësive profesionale që ka kryer Komisioni

- a) Parashtrime për procedimin disiplinor të ministrisë së Drejtësisë, të vitit 2009, ndaj meje/subjektit, për gjykimin e çështjes penale (në vitin 2008), ndaj të pandehurve S. Ç. etj., të akuzuar për kryerjen e veprave penale "vrasje me paramendim", subjekti i rivlerësimit është shprehur se: ju qëndroj të gjitha shkaqeve që kam parashtruar në pretendimet/parashtrimet/observacionet, kundër akteve/materialit të ministrit të Drejtësisë për këtë procedim disiplinor; ju qëndroj të gjitha shkaqeve/arsyeve që kam parashtruar me shkrim apo verbalisht para KLD-së, për të njëjtin procedim, sepse nuk kam treguar pamjaftueshmëri/të meta profesionale në zbatim të ligjit procedural; nuk kam dhënë vendim në kundërshtim me ligjin, kam zbatuar urdhërimet e dispozitave procedurale penale dhe nuk kam ulur autoritetin e organeve të drejtësisë. Pra, vendimi i pafajësisë penale përbën një nga llojet e disponimeve gjyqësore penale përfundimtare/themeltare, që*

mund të jepet gjatë gjykimit në themel të çështjes penale; nuk kam kryer veprime të cilat cenojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit; nuk kam kryer/lejuar shkelje që të konsistojnë në moskryerjen e veprimeve të caktuara procedurale; nuk kam kryer/lejuar veprime apo mosveprime për të favorizuar në mënyrë të njëanshme të pandehurit; nuk kam treguar pamjaftueshmëri profesionale dhe me vendimin përkatës përfundimtar; nuk është cenuar besueshmërinë e publikut në pavarësinë dhe/ose paanshmërinë e gjykatës.

*b) Po ju paraqes edhe disa kundërshtime, mendime, qëndrime shtesë për procedimin disiplinor. Sipas kërkesës tuaj, kam edhe parashtrimet/kundërshtimet/pretendimet shtesë vijuese: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton se gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve, i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve dhe se ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit [...]. Unë kam dhënë sqarime në KLD e në ministri dhe ju qëndroj atyre pretendimeve. Ministria e Drejtësisë ushtroi presion politik. Ministri i Drejtësisë vepronte me tendencë dhe në konflikte interesi sepse në hetimin penal të kësaj çështjeje gjatë vitit 2006 dhe në seancën e masës së sigurimit (sipas vendimeve të veçanta penale nr. ***, datë 12.11.2006, nr. ***, datë 19.11.2006, të kësaj gjykate; për orientim, po ju dërgoj një kopje të vendimit të veçantë gjyqësor penal nr. ***, datë 12.11.2006, të kësaj gjykate), njëri prej të pandehurve (F. M.) është mbrojtur nga avokat P. B. (shihni faqet 730 -735, 738 dhe 744 të fashikullit të prokurorit dhe procesverbalet e seancave të masave të sigurimit që kanë lidhje me këto vendime, për këtë të pandehur). Por z. P. B. harton me aktin e datës 10.9.2008 raportin e kontrollit të kësaj dosjeje (tashmë me cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë) dhe ky raport kontrolli, hartuar nga z. P. (sipas aktit datë 10.9.2008, nënshkruar nga drejtoresha e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë), më dërgohet për njohje dhe observacion. Pra, z. P. veproi në kundërshtim me ligjin organik në fuqi nr. 8678/2001, “Për Ministrinë e Drejtësisë”, veproi në kundërshtim me nenin 37 të ligjit nr. 8485/1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, veproi në kundërshtim me ligjin nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave ...” (dhe akteve nënligjore përkatëse), veproi në kundërshtim me ligjin nr. 9131/2003, “Për rregullat e etikes ...” (dhe akteve nënligjore përkatëse), gjithashtu veproi në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil” (dhe akteve nënligjore përkatëse). Ai ishte nëpunës i lartë publik i administratës shtetërore, ngarkuar me kontrollin e raportin e kësaj dosjeje dhe këto dispozita ligjore kishin lidhje me detyrën e tij në kohën e inspektimit prej tij të kësaj dosjeje gjyqësore.*

181. Në lidhje me parashtrimet e informacioneve të dërguara në Komision nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe prokuroritë e tjera, subjekti është shprehur se:

*c) Nuk kam dijeni për kallëzimin dhe shkaqet/të dhënat e procedimit penal nr. ***, të vitit 2019; nuk kam dijeni për kallëzimin dhe shkaqet/të dhënat e procedimit penal nr. *** të vitit 2019; jam dakord me verifikimet e përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar kjo prokurori për vendimin e saj “Mosfillimi i këtij procedimi” dhe nuk kam sqarime/parashtrime shtesë; nuk kam dijeni për kallëzimin dhe shkaqet/të dhënat e procedimit penal nr. *** të vitit 2014; jam dakord me verifikimet e përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar kjo prokurori për vendimin e saj “Pushimi i procedimit.*

*d) Kam marrë dijeni indirekt (kur është kërkuar përjashtimi në gjykimet përkatëse civile) për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2018 të palës civile T. Z.; jam dakord me verifikimet e përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar kjo prokurori për vendimin e saj “Mosfillimi i këtij procedimi” nuk kam sqarime/parashtrime shtesë dhe nuk i përket periudhës parimore*

*kohore rivlerësuese (2013 – 2016); kam pasur në proces palën T. Z. dhe për paditë e tij kam disponuar, sipas vendimeve jopërfundimtare gjyqësore civile nr. ***, nr. *** dhe nr. *** të vitit 2018, të cilat kanë marrë formë të prerë (pasi nuk janë kundërshtuar prej paditësit). U qëndroj të njëjtave shkaqe ligjore/përfundime/arsyetime, për të cilat janë administruar provat e janë zhvilluar proceset dhe në përfundim është disponuar me këto vendime gjyqësore civile.*

- e) Nuk kam dijani për kallëzimin dhe shkaqet/të dhënat e procedimit/kallëzimit penal nr. *** të vitit 2019; jam dakord me verifikimet e përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar kjo prokurori për vendimin e saj “Mosfillimi i këtij procedimi” dhe nuk kam sqarime/parashtrime shtesë.*
- f) Nuk kam dijani për kallëzimin dhe shkaqet/të dhënat e pretenduara në vitin 2018, nga shtetasi Z. B.; nuk kam dijani për ecurinë e vendimmarrjes nga prokuroria kompetente; kam pasur në proces palën Z. B. dhe për paditë/kërkesat e tij penale kam disponuar, sipas vendimeve gjyqësore nr. *** dhe nr. *** të vitit 2011, si dhe nr. *** të vitit 2015, të cilat kanë marrë formë të prerë (pasi nuk janë kundërshtuar prej palëve). U qëndroj të njëjtave shkaqe ligjore/përfundime/arsyetime, për të cilat janë administruar provat e janë zhvilluar proceset dhe në përfundim është disponuar me këto vendime gjyqësore civile e penale. Me këtë gjendje aktesh, nuk kam sqarime shtesë.*
- g) Nuk kam dijani për kallëzimin dhe shkaqet/të dhënat e pretenduara në vitin 2013, prej shtetasit D., jam dakord me verifikimet dhe përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar prokuroria kompetente për vendimin e saj “Pushimi i çështjes” dhe nuk kam sqarime/parashtrime shtesë.*
- h) Nuk kam dijani për kallëzimin dhe shkaqet/të dhënat e pretenduara në procedimin penal nr. *** të vitit 2016, nga pala A. E., jam dakord me verifikimet dhe përfundimet/konkluzionet, që ka vlerësuar kjo prokurori për vendimin e saj “Mosfillimi i procedimit” dhe nuk kam sqarime/parashtrime shtesë.*
- i) Jam dakord me vlerësimet/konkluzionet/përfundimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, sipas të cilave unë nuk kam pasur kontakte të papërshtatshme.*
- j) Jam dakord me verifikimet dhe përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për secilën vendimmarrje “Mosfillimi i procedimit”, që kanë lidhje me kallëzimet dhe shkaqet/të dhënat e pretenduara nga palët e interesuara P. P. (kallëzimi i vitit 2014), Y. M. (dy kallëzimet e vitit 2014) dhe B. I. (kallëzimi i vitit 2015). Nuk kam sqarime/parashtrime shtesë për këto kallëzime e vendimmarrje.*
- k) Jam dakord me verifikimet dhe përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë për vendimin e saj në procedimit penal nr. ***, “Për pushimin e procedimit penal”, në procedim të cilin janë bashkuar veç e veç kallëzimet e shtetasit N. P. dhe kallëzimi i shtetasit K. S.. Por pala N. ishte në proces gjyqësor civil me palën Y. M.; edhe pala Y. kishte paraqitur kallëzimet e sipërcituara të vitit 2014 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Jam dakord me verifikimet dhe përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar kjo prokurori për vendimin e saj “Pushimi i procedimit”, sepse (me gjithë shtrirjen në kohë të gjatë të hetimit), nuk ka rezultuar kryerja e asnjë veprë penale; faktet e kallëzuara dhe të hetuara, nuk kanë elementet e veprës penale të kallëzuar/të hetuar apo të ndonjë veprë tjetër penale (në të gjitha format/mënyrat e parashikuara në dispozitat e Kodit Penal) dhe nuk evidentohet asnjë palë e dëmtuar apo që të kishte dijani për veprën penale. Nuk rezulton, që ky vendim të jetë kundërshtuar nga palët e interesuara, në gjykatë apo tek prokurori më i lartë. Kam pasur në proces palën K. S. dhe për padinë e tij kam disponuar sipas vendimit*

*jopërfundimtar gjyqësor civil nr. ***, datë 12.12.2013, që ka marrë formë të prerë (pasi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe nuk është ushtruar rekurs). U qëndroj të njëjtave shkaqe ligjore/përfundime/arsyetime, për të cilat është disponuar me këtë vendim gjyqësor civil.*

- l) Jam dakord me verifikimet dhe përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, për vendimin e saj në procedimit penal nr. *** të vitit 2018 (që i përket kallëzimit të palës civile T. Z.). Për këtë kallëzim dhe për këtë vendimmarrje dhashë sqarime në pikën e sipërcituar “iv” të materialit tim.*
- m) Jam dakord me verifikimet e përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, për vendimin e saj “Mosfillimi i procedimit, për kallëzimin penal nr. *** datë 6.2.2019, të palës E. B.”. Nuk rezulton që ky vendim të jetë kundërshtuar nga pala e interesuar në gjykatë. Kam pasur në proces palën E. B. dhe për padinë e tij kam disponuar sipas vendimit jopërfundimtar gjyqësor civil nr. ***, datë 24.1.2019. U qëndroj të njëjtave shkaqe ligjore/përfundime/arsyetime, për të cilat është disponuar me këtë vendim gjyqësor civil dhe kjo dosje nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016).*
- n) Jam dakord me verifikimet e përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit Tiranë, për vendimin e saj “Mosfillimi i procedimit për kallëzimin nr. *** të vitit 2019 të palës B. I.”. Jam dakord me verifikimet dhe përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për vendimin e saj “Mosfillimi i procedimit penal nr. *** të vitit 2016 të shtetasit A. E.”.*

182. Parashtrime në lidhje me dosjet që janë dërguar në Komision nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe informacionet e Gjykatës së Apelit Durrës

- o) Lidhur me çështjen e të pandehurit A. C., pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), po ju parashtroj qëndrimin tim vijues:*
- p) E respektoj vendimin e Gjykatës së Apelit; edhe sot kam mendimin se (në parim e në kuptim të nenit 377 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi, kur u shqyrtua çështja) vendimi gjyqësor penal nr. ***, datë 25.5.2004, i kësaj gjykate (që ka vendosur “Kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Elbasan dhe unë kam qenë anëtar i trupit gjykues) nuk është vendim përfundimtar, nuk është shprehur mendim për provat e për themelin e akuzës dhe nuk janë marrë në analizë provat e palëve. Kalimi i akteve në prokurori nuk konsiderohet teorikisht shprehje mendimi; nuk konsiderohet paanësi; nuk përbën rrethanë konkrete apo arsye serioze njëanshmërie, në baze e në kuptim të neneve 15-17 të Kodit të Procedurës Penale; nuk cenohet objektiviteti i shqyrtimit gjyqësor, sipas dispozitave kushtetuese dhe ky disponim nuk ka lehtësuar pozitën procedurale të të pandehurit. Disponimi i Gjykatës së Apelit Durrës lidhet me mënyrën e çmuarjes teorike (nga kjo gjykatë apeli) të neneve 15-17, 128 e 377 të Kodit të Procedurës Penale. Në mbështetje të standardeve ndërkombëtare (që garantojnë pavarësinë e gjyqtarit) dhe vendimeve përkatëse të gjykatës tonë kushtetuese, mendoj se vendimet gjyqësore të cenuara (për shkak të vlerësimit të ndryshëm të dispozitës procedurale, siç është edhe ky vendim gjyqësor), nuk përbëjnë arsye për përgjegjësi disiplinore. Për shkaqet e sipërcituara në përfundim mendoj se (me pjesëmarrjen time në trupin gjykues, kur u disponua sipas vendimit penal nr. *** të vitit 2005, ndaj të pandehurit A. C. dhe unë jam anëtar i trupit gjykues) nuk janë cenuar parimet për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, në lidhje me formimin e trupit gjykues dhe përbën rast të veçuar praktik procedural.*

- q) Për dosjen nr. 2 (që i përket vendimit penal nr. *** të vitit 2006 ndaj të pandehurit A. (Th.) Q.), ju parashtrij se nuk është gjykuar prej meje (sepse i referohet gjyqtares P. F.).
- r) Për dosjen nr. *** (që i përket vendimit penal nr. ***, datë 22.1.2008, ndaj të pandehurve S. Ç. etj.) kam shprehur mendimet, qëndrimet, vlerësimet, parashtrimet, kundërshtimet, shpjegimet e kërkesat, ne faqet e sipërcituara.
- s) Për dosjen nr. *** (që i përket vendimit penal nr. ***, datë 26.5.2004, ndaj të pandehurit D. T.), pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), po ju parashtrij qëndrimin tim vijues: Ka qenë praktikë procedurale e pakontestuar deri në Gjykatën Kushtetuese (si dhe nga kontrollet tematike apo të veçanta), se vetëm vendimi origjinal (me dorëshkrim) nënshkruhej nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues; ndërsa vendimi tjetër i zbardhur (për marrëdhënie me të tretët/prokuroria etj.) nënshkruhej vetëm nga gjyqtari relator. Ky fakt nuk është konsideruar si e metë e çdo karakteri. Jam dakord që në arsyetimin e këtij vendimi duhet të kishte analizë më të thelluar dhe të plotë për arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi (për aq kohë sa ishte pranuar ndryshimi i veprës penale nga trafikim i të miturve në kalim i paligjshëm i kufirit.
- t) Për dosjen nr. *** (që i përket vendimit penal nr. vendimi ***, datë 13.5.2008, ndaj të pandehurës Zh. I.), nuk është gjykuar prej meje (sepse i referohet gjyqtarit E. P.).
- u) Për dosjen nr. *** (që i përket dy çështjeve civile me palë G. M. – N. M.), pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), po ju parashtrij qëndrimin tim vijues: Për shkak të të metave të konstatuara në kohën e paraqitjes së saj dhe me vendim të ndërmjetëm, padia nr. *** akti, e paditësit G. u la pa veprime, duke përcaktuar afatin për plotësimin e tyre (pasi përbënin elemente të nevojshëm për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të gjyqimit, sipas objektit të padisë, rrethanave të faktit, neneve 154 e 156 të Kodit të Procedurës Civile dhe dispozitave në fuqi të Kodit të Familjes). Megjithëse kishte dijeni, që nga data 25.1.2019 dhe ishte detyrimi i tij, paditësi nuk paraqiti në gjykatë adresën e plotë të vendbanimit ose vendqëndrimin (të kohës së paraqitjes së padisë), për vete dhe për të paditurën; certifikatën e gjendjes së tij civile personale të përditësuar; certifikatën e gjendjes së tij civile familjare të përditësuar; si dhe certifikatën e gjendjes civile personale të përditësuar të të paditurës. Sipas nenit 154/a të këtij kodi parashikohet: “Kur paditësi nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, padia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit”. Meqenëse i ishte dhënë afat i gjatë/i arsyeshëm, nuk u provuan shkaqe të përligjura që të justifikojë mosplotësimin e të metave përkatëse, në baze të neneve 154/a, 306 - 310, 102 - 106 të Kodit të Procedurës Civile dhe sipas vendimit civil nr. ***, datë 1.2.2019, u çmua kthimi i padisë dhe paditësit iu ngarkuan shpenzimet gjyqësore. Vendimi civil nr. ***, datë 1.2.2019, për këtë çështje prezumohet që i është njoftuar paditësit dhe (ky vendim mori formë të prerë), pa ankim prej paditësit (bashkëlidhur këtij material, është ky vendim gjyqësor dhe dëftesa e komunikimit, dërguar paditësit).
- v) Për dosjen nr. *** (që i përket çështjes civile nr. *** vendimi, datë 21.2.2020, me palë A. E. etj., i paditur L. H., me objekt “konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave për shitjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë A. etj.”), nuk është gjykuar prej meje (sepse i referohet gjyqtares M. F.).
- w) Për dosjen nr. *** (që i përket çështjes me palë M. M. – E. M., me objekt “zgjidhje martese etj.”, pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), po ju parashtrij qëndrimin tim vijues: padia me objekt “zgjidhje martese” të palës M., iu njoftua të paditurit, sipas nenit 158 të Kodit të Procedurës Civile; u planifikua seanca përgatitore; seancat janë shtyrë për shkaqe të arsyeshme/të motivuara dhe nuk

janë cenuar të drejtat e palëve; nuk kam qenë dakord me përjashtimin tim nga gjykimi i kësaj çështjeje.

- x) *Për padinë e palës M., me objekt “kundërshtim atësie etj.”, u kryen veprimet e njoftimit të padisë, sipas nenit 158 të Kodit të Procedurës Civile, në adresë të të paditurit. Gjykata nuk ka luajtur rol aktiv, sepse marrja e akteve/informacioneve tek të tretët dhe sqarimi i rrethanave që përmbajnë provat e paraqitura nga palët ka lidhje me detyrën e gjykatës, sipas nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile, ndryshe do të zvarritej gjykimi; nuk u çmua (në fazën përkatëse) kthimi i padisë, pasi adresa/kontaktet e përcaktuara në padi dhe në aktet bashkëlidhur saj për palët ishin të mjaftueshme për të vijuar me njoftimet, sipas nenit 158 të Kodit të Procedurës Civile, me kryerjen e veprimeve përgatitore, zhvillimin e seancës gjyqësore dhe dhënies fund të procesit me vendim përfundimtar gjyqësor civil.*

183. Parashtrime të subjektit lidhur me konstatime të tjera të Komisionit

Si për dorëzimin e deklaratës Vetting të vitit 2017, edhe për t’ju përgjigjur pyetësorëve tuaj, pranoj që unë ju kam dërguar e kërkuar (me cilësinë e gjyqtarit) disa institucioneve/organeve të ndryshme shtetërore/publike vendore apo qendrore/enteve private, akte/informacione që administrohen pranë tyre. Këto kërkesa janë parashtruar prej meje për shkak të detyrës, pasi edhe procesi i rivlerësimit lidhet me këtë detyrë. Aktet/informacionet e dërguara prej tyre kanë lidhje me këtë proces dhe me përgjigjet e pyetësorëve tuaj. Kam tentuar dhe jam paraqitur personalisht nëpër disa institucione për të marrë informacione/aktet përkatëse. Por nga disa institucione më është pretenduar ta paraqitja kërkesën me shkrim e vulë të gjykatës ose përgjigjja do vonohej dhe do të shkoja disa herë për të njëjtën kërkesë. Në këtë mënyrë do mungoja në punë dhe do të zvarriteshin gjykimet e planifikuara ditë/javë/muaj më parë. Për të evituar ndonjë keqdashje nga të tretët apo vonesa ose për të evituar ndërhyrje/influencime në aktet e kërkuara prej meje dhe në funksion të objektivitet, ju parashtroj se në kërkesat e mia të sipërcituara nuk e kam përshkruar shkakun konkret (sipas ligjit nr. 84/2016) të kërimit të akteve përkatëse që u kam dërguar enteve përkatëse. Por edhe në këtë formë/mënyrë siç i kam kërkuar aktet përkatëse, ka rezultuar që disa institucione/ente private nuk kanë kthyer/dërguar në kohë aktet/përgjigjet përkatëse. Ndoshta është gabim, por vetëm për këto shkaqe/arsye veprova (sipas konstatimit tuaj) dhe nga asnjë motiv shkak tjetër.

184. Parashtrime në lidhje me denoncimet e dërguar në Komision nga publiku (për çështjet e gjykuara prej meje)

- 1. Për denoncimin nr. *** të vitit 2018 të palës K. T., pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), po ju parashtroj qëndrimin tim vijues: Nuk është mbajtur audio, sepse sistemi i regjistrimeve audio të seancave gjyqësore është implementuar në Gjykatën e Rrethit Elbasan në 30 janar të vitit 2013. Por nga ky vit e deri në fund të vitit 2017 regjistrimet audio të seancave bëheshin vetëm në dy sallat penale, në katin e 1-rë, të vetmet në gjykatën e vjetër të Elbasanit. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së sallave, regjistrimet audio janë bërë kryesisht për çështje penale (themeli e masa sigurimi) dhe rrallë për ndonjë çështje civile, me shumë palë ose ndonjë çështje civile (kur është kërkuar prej palëve) ose për ndonjë çështje tjetër të veçantë penale, me objekt “kundërshtim vendimi të prokurorisë”. Pjesën më të madhe të çështjeve civile i kam zhvilluar në zyrën time në katin e 2-të, ku nuk ishte instaluar sistemi për regjistrimin audio të seancave. Pala K. ka pasur dijeni për mungesën e sistemit audio në ish-godinën e vjetër dhe nuk ka paraqitur kërkesë për t’u dëgjuar (për prapësimet e saj) me audio. Pala K. ka pasur dijeni për pretendimet e palës tjetër, i është dhënë mundësia/e drejta të dëgjohet në çdo formë/mënyrë procedurale, është njohur me procesverbalet e seancës/ave dhe nuk ka parashtruar vërejtje/prendime/kërkesa para gjykatës së shkallës së parë për përmbajtjen e*

procesverbaleve përkatëse. Duke u njohur me procesin, përmbajtjen/aktet e dosjes civile përkatëse dhe me vendimin gjyqësor të asaj mosmarrëveshjeje, pala K. ka ushtruar efektivisht të drejtën e saj të ankimit/apelimit civil në Gjykatën e Apelit dhe vendimi përkatës gjyqësor ka marrë formë të prerë. Ju qëndrojnë të njëjtave parashtrime të sqaruara prej meje në lidhje me materialin e KLD-së “Informacion për përdorimin e sistemit audio” (bashkëlidhur keni raportet elektronike të datave 5.1.2018 dhe 7.2.2018, të kryetarit dhe kancelarit të kësaj gjykate, për kohën e fillimit të përdorimit të sistemit audio në këtë gjykatë; akte të cilat janë të vetmet që na janë vënë në dispozicion).

185. Komisioni konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit citon/parashtron problematikën lidhur me instalimin e sistemit audio në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

186. Për 5 denoncimet e shtetasit B. I., po ju parashtroj qëndrimin tim vijues:

- a. Ky shtetas nuk ka interes të drejtpërdrejtë për çështjet e masave të sigurimit, pasi (që nga viti 2001, që unë ushtroj detyrën e gjykatësit në këtë gjykatë) nuk kam pasur/nuk kam në gjykim çështje ku ai të jetë palë dhe as ai nuk ka pasur cilësinë e mbrojtësit në ndonjë çështje të gjykuar prej meje, me përjashtim të çështjeve që gjykohen/shqyrtohen në dhomë këshillimi (pa pjesëmarrjen e palëve), të gjitha çështjet e tjera gjykohen e përfundohen me sistemin audio. Në parim dhe sipas neneve 48 e 259 të Kodit të Procedurës Penale (me tekstin e tyre, para ndryshimeve, sipas ligjit nr. 35/2017), kam çmuar e vlerësuar se seanca e gjyqësive penale, me objekt “vleftësimit të arrestit në flagrancë”, duhet zhvilluar me pjesëmarrjen e mbrojtësit, nëse personi nën hetim e ka zgjedhur (është njoftuar dhe është i pranishëm) ose nuk e ka zgjedhur (por kërkohet prej tij dhe është caktuar kryesisht) ose ka mbetur pa mbrojtës (e kërkon dhe i është caktuar kryesisht) ose në rastet e mbrojtjes së detyrueshme. Asnjë person nën hetim (që unë kam pasur në proces, nuk e ka kërkuar mbrojtës shtetasin B. I.. Edhe në praktikën e Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës së Lartë (në dijeninë time) nuk është vendosur prishja nga Gjykata e Apelit ose nga Gjykata e Lartë apo të jetë konstatuar/vënë në dukje si e metë procedurale, për shkak se “nuk i kam caktuar personit nën hetim mbrojtës kryesisht”.
- b. Jam dakord me përfundimet/arsyetimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, sipas vendimit të tyre “Mosfillimi i procedimit penal, për kallëzimin nr. *** të vitit 2015, të shtetasit B. I.”. Kundër këtij vendimi nuk është ushtruar ankim në gjykatë apo tek prokurori më i lartë nga pala e interesuar.
- c. Shtetasi B. I. nuk ka interes të drejtpërdrejtë, për padinë e paditësit Y. M.. Duke respektuar vendimin nr. ***, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese, ju parashtroj se: Jam dakord me qëndrimet e gjyqtarëve në pakicë në këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, sepse në raste të tjera, për të njëjtin pretendim (siç e ka parashtruar pala Y. dhe në fazën që çështja ishte në proces në Elbasan), Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar kërkimet ose nuk janë marrë parasysh. Gjykimi mund të jetë jashtë afatit, por jo për shkaqe që lidhen me kryerjen e detyrës prej meje, për shkaqet vijuese: seancat janë shtyrë, pasi ka pasur palë që në fazën përkatëse nuk kishte dijeni rregullisht; kishte palë që në fazën përkatëse ishin jashtë shtetit (dhe do të njoftoheshin me shpallje nenet 130 e vijues të Kodit të Procedurës Civile); përfaqësimi i palës përkatëse, kishte të meta dhe parashikohet shtyrja sipas nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile; palët e pranishme (përfshirë edhe paditësi) duhet të paraqisnin provat e pretenduara; duheshin thirrur palët e interesuara sipas nenit 193 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (për të cilën parashikohet shtyrja e seancës); kur palët kane pasur dijeni

rregullisht; janë kryer veprimet përgatitore dhe çështja ka kaluar ne seance gjyqësore, duke lënë detyra përkatëse për efektivitetin e saj; është kërkuar dorëheqja nga paditësi dhe nuk kam qenë dakord, për këtë shkak janë pezulluar veprimet (sipas nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile), deri në shqyrtimin e kësaj kërkesë nga gjyqtari tjetër. Me këto veprime/vendime nuk tregohet se unë kam vonuar veprimet ose të kem pasur periudhë pasiviteti sepse vendimet e ndërmjetme në këtë çështje janë të arsyetuara, me tekst të qartë, duke referuar qartë shkakun e shtyrjes (që kanë lidhje me nenet 125 e 315 të Kodit të Procedurës Civile) dhe në kohën/fazën e duhur procedurale. Pas çdo seance janë kryer veprime në funksion të seancës së radhës; këto veprime ose vendime të ndërmjetme (për ndërprerjen e seancave) ishin të arsyeshme/të domosdoshme. Shtyrjet e seancave kishin qëllim për të mos passjellë cenimin e procesit gjyqësor në themel. Pra, konstatimi/denoncimi, në raport me dinamikën, rrethanat konkrete të çështjes, ngarkesën time në punë, kuadrin ligjor të zbatueshëm procedural e material në fuqi dhe rolit tim në çdo seancë, mendoj se nuk përbëjnë sjelljen time të zakonshme në këtë çështje dhe zvarritja e pretenduar e humbet. Mendoj se zvarritjet në këtë çështje nuk janë të qëllimshme .

- d. Shtetasi B. I. nuk ka interes të drejtpërdrejtë për padinë/rastet e referuara nga avokati O. J.. Pavarësisht se nuk i përkasin periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj:
- e. Për padinë nr. *** akti të vitit 2019, të paditëses R. K., ka rezultuar se për shkak të të metave të konstatuara në kohën e paraqitjes së saj, meqenëse përbëjnë elemente të nevojshme për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të gjykimit për njoftimin e akteve palës tjetër sipas objektit të padisë, rrethanave të faktit (të parashtruara në këtë padi), sipas neneve 4, 154, 156 e 266 të Kodit të Procedurës Civile, dispozitave në fuqi të Kodit të Familjes, ligjit organik për aktet e gjendjes civile (në lidhje me banimin) dhe me vendim të ndërmjetëm, kjo çështje u la pa veprime, duke caktuar afatin për plotësimin e tyre. Megjithëse prezumohej që kishte dijeni (nëpërmjet avokatit të saj) që nga data 18.10.2019 dhe ishte detyrimi i saj/avokatit plotësimi i të metave, rezultoi se paditësja/avokati i saj nuk paraqiti në gjykatë një kopje të akteve të përkthyer të kartës së saj të identitetit (që ajo ka aktualisht në Gjermani), që t'i njoftohej në eventualitet palës tjetër. Sipas nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Kur paditësi/ja nuk plotëson të metat brenda afatit të caktuar, padia quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet paditësit”. Paditëses i është dhënë afat i mjaftueshëm dhe i arsyeshëm për plotësimin e të metave të sipërcituara; megjithëse është detyrimi i saj, paditësja nuk provoi shkaqe të përlegjura, që të justifikojë mosplotësimin e kësaj të mete për këto shkaqe dhe në bazë të neneve 154/a, 102-106 e 306-310 të Kodit të Procedurës Civile është disponuar (sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 25.10.2019), për kthimin e padisë. Ky vendim jo përfundimtar civil ka marrë formë të prerë, pa ankim prej palëve (ky vendim civil është bashkëlidhur këtij material).
- f. Për çështjen civile nr. *** akti të vitit 2019, me palë H. K. – F. K., me objekt padie “zgjidhje martesë” (pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese 2013 – 2016) ju parashtroj se janë planifikuar veprimet përgatitore, sipas nenit 158/b të Kodit të Procedurës Civile e nenit 134 të Kodit të Familjes, sipas të cilave, ndër të tjera, parashikohet se “Në shqyrtimin e padisë për zgjidhjen e martesës, gjykata cakton fillimisht një seancë pajtimi në të cilën duhet të paraqiten personalisht bashkëshortët [...]. Gjyqtari mund t'i dëgjojë ata veçmas secilin dhe më pas bashkërisht, pa praninë e përfaqësuesve të tyre [...]”. Por ka rezultuar se në seancën/at përkatëse është paraqitur vetë paditësja. Prezumohet që kishte dijeni edhe avokati i saj për seancat përkatëse. Ajo/paditësja nuk është shoqëruar nga avokati dhe ajo/paditësja nuk ka

kërkuar mbrojtje. Seanca e re u planifikua në datën 19.11.2019 dhe palët (duke qenë të pranishme) morën dijeni. Por, megjithëse kishin dijeni, rezultoi se nuk u paraqiten palët dhe mungesa e tyre nuk u justifikua me asnjë formë/mënyrë/shkak të përligjur, deri në përfundim të kësaj seance. Meqenëse i padituri ishte në mungesë (e nuk kishte paraqitur deklaratë mbrojtjeje), u çmua dhënia fund e procesit gjyqësor, si rast i nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile (i ndryshuar sipas ligjit nr. 38/2017) dhe në bazë të neneve 306-310, 299, 158/a, 158/b, 179/1 e 102-106 të Kodit të Procedurës Civile u vendos (sipas vendimit gjyqësor nr. ***, datë 19.11.2019) pushimi i gjykimit; shpenzimet gjyqësore në ngarkim të paditëses. Ky vendim jopërfundimtar civil ka marrë formë të prerë, pa ankim, prej palëve (ky vendim civil i është bashkëlidhur këtij material).

- g. Shtetasi B. I. nuk ka interes të drejtpërdrejtë për padinë e paditëses A. Ç.. Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj se: kam pasur për gjykim çështjen civile nr. *** akti ta vitit 2018, me palë A. Ç. – N. Ç., me objekt “zgjidhje martese etj.”. Sipas padisë dhe e pyetur në gjykim (nenet 158/b/2 e 158/c të Kodit të Procedurës Civile) paditësja/avokati i saj parashtroi pretendimet, argumentet, shpjegimet, kërkesat, faktet e shkaqet vijuese (ndër të tjera): “[...] Fëmijën dua ta mbaj unë [...]; nuk ka nevojë për kryerje ekspertimi psikologjik [...]”. I pyetur në gjykim (neni 158/b/2 i Kodit të Procedurës Civile) i padituri/avokati i tij parashtroi prapësimet, argumentet, shpjegimet, kërkesat, faktet e shkaqet vijuese (ndër të tjera): “[...] Jam dakord që fëmijën ta mbajë paditësja. Paditësja është në gjendje të rrisë fëmijën. Jam dakord të mos kryhet ekspertim psikologjik”. Në përputhje me padinë, pretendimet, prapësimet dhe pohimet e palëve, faktet që fëmija është i mitur, jeton aktualisht me paditësen dhe i padituri nuk ka vërejtje për mbajtjen e tij/fëmijës, në të ardhmen nga paditësja; nisur nga nevojat personale të fëmijës në raport me moshën e tij; në parim dhe në çdo procedurë që i përket të miturit, parashikohet prania e psikologut, sipas nenit 224/a të Kodit të Procedurës Civile, neneve 6/4, 155, 267 e 273 të Kodit të Familjes. Parimi për thirrjen e psikologut (që përbën thelbin e paraqitjes së padisë, sipas nenit 31 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe sipas dispozitave të Kodit të Familjes, kur nuk paraqitet kërkesa e përbashkët, sipas nenit 125 të saj) zbatohet nëse palët ka në mosmarrëveshje për mbajtjen e fëmijës ose për elemente të tjerë që lidhen me interesin e fëmijës. Edhe neni 125 i Kodit të Familjes nuk parashikon pyetjen e ekspertës, megjithëse palët mund të ketë fëmijë të mitur. Palët nuk kërkuan kryerje ekspertimi/praninë e psikologut. Për këto shkaqe nuk çmova në këtë çështje kryerjen e ekspertimit psikologjik. Nëse do të kisha caktuar ekspertë/psikologë në këtë çështje, sigurisht që do të zvarritej gjykimi (për çështje të qarta e të sqaruara) dhe do të shtonte shpenzimet/kostot e palëve për këtë proces. Palët nuk kanë pasur pretendime dhe ankim ndaj vendimit përfundimtar të kësaj çështjeje. Ndërsa, në dosjen nr. *** të paditëses M. M. është caktuar ekspertja/psikologjia, pikërisht për faktin se palët kishin pretendime për mbajtjen e fëmijës për gjendjen psikologjike të fëmijës dhe gjykata duhet të merrte njohuri të posaçme në fushën psikologjike.

187. Komisioni ka konstatuar se rezultatet e njoftuara lidhur me këtë denoncim nga Komisioni nuk ndryshojnë, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, sa u takon rasteve të parashikuara dhe nuk ka shpjeguar bindshëm arsyet për të argumentuar të kundërtën.

- a. Shtetasi B. I. nuk ka asnjë interes të drejtpërdrejtë për kërkesën e kërkuesit S. Z.. Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj se: kam pasur në proces dy kërkesat e palës S. Z., për çështjen e veçantë civile nr. *** akti të vitit 2019, me objekt “sqarim, interpretim vendimi etj.” të këtij kërkuesi, u çmua në thelb (sipas vendimit unifikues civil nr. *** të vitit 2012, të

Gjykatës së Lartë dhe sipas neneve 5, 510 e 511 të Kodit të Procedurës Civile), se objekt kërkimi nuk ishte “sqarimi dhe interpretimi i vendimit të veçantë civil nr. *** të vitit 2017 të këtij kërkuesi”, por objekt kërkimi ishte “lëshimi i urdhrit të ekzekutimit”. Por në çdo rast që paraqitet kërkesa, me objekt “sqarimi dhe interpretimi i vendimit gjyqësor”, sipas nenit 314 të Kodit të Procedurës Civile, mendoj se shqyrtimi i saj do të bëhet nga gjyqtari i çështjes fillestare/prej meje, sepse kisha disponuar me vendimin e veçantë civil nr. *** të vitit 2017. Duke qenë se çështja shqyrtohet në dhomë këshillimi (pa pjesëmarrjen e palëve) kam mendimin se nuk mund të kërkoja as dorëheqjen nga gjykimi, sepse në rastin hipotetik do të rrëzohej kjo kërkesë, duke vlerësuar objektin e kërkesës. Çmuarja e vlerësimit për objektin konkret të kërimit të kërkuesit S. (për kërkesën e tij nr. *** akti të vitit 2019 dhe sipas nenit 5 të Kodit të Procedurës Civile) realizohet në dhomë këshillimi. Pra, në këtë situatë procedurale nuk ka disponim tjetër veçse të shqyrtohej kërkimi, siç veprova e vendosa në fakt. Teorikisht jam dakord që (pasi kisha disponuar sipas vendimit të veçantë civil nr. *** të vitit 2017) nuk duhet ta gjykoja unë kërkimin e kërkuesit S. “për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”, nëse do të ekzistonte si kërkim më vete, por nuk kisha alternativë tjetër procedurale disponimi në dhomë këshillimi, me gjendjen e akteve që u paraqit për shqyrtim. Meqenëse ka vendime të Gjykatës së Apelit Durrës që kanë shqyrtuar vendimmarrjet e mia apo të gjyqtarëve të tjerë që kanë ndryshuar praktikën (në lidhje me çështje të kësaj natyre për deklaratat noteriale) çmova zgjidhjen e çështjes për pranimin e kërkesës së palës S.. Nuk është e vërtetë që kam ndërruar objektin e kërkesës me iniciativë, por ne thelb e nga shqyrtimi në tërësi (i pjesës hyrëse dhe përshkruese të kërkesës objekt gjykimi) kishte pretendime se duhej të shqyrtohej kërkesa me objekt “L. U. ekzekutimi...”.

188. Për denoncimin nr. * prot., të shtetasve T. Z. dhe I. B.**

Pavarësisht se nuk i përkasin periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj se kam marrë dijeni indirekt (kur është kërkuar përjashtimi në gjykimet përkatëse civile për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2018, të palës civile T. Z., regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë (trajtuar më lart). Jam dakord me verifikimet e përfundimet/konkluzionet që ka vlerësuar kjo prokurori për vendimin e saj “Mosfillimi i këtij procedimi”. Nuk rezulton që ky vendim të jetë kundërshtuar nga pala e interesuar në gjykatë nuk kam sqarime/parashtrime shtesë. Kam pasur në proces palën T. Z. dhe për paditë e tij kam disponuar, sipas vendimeve jopërfundimtare gjyqësore civile nr. ***, nr. *** dhe nr. *** të vitit 2018, të cilat kanë marrë formë të prerë (pasi nuk janë kundërshtuar prej paditësit. U qëndroj të njëjtave shkaqe ligjore/përfundime/arsyetime, për të cilat janë administruar provat e janë zhvilluar proceset dhe në përfundim është disponuar me këto vendime gjyqësore civile.

189. Për denoncimin nr. * prot., të shtetas R. A.**

Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016) ju parashtroj se: kam pasur në proces kërkesën e veçantë penale nr. *** akti të vitit 2017, të kërkueses R. A., me objekt “kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan etj.”; kam disponuar me vendimin e veçantë penal nr. ***, datë 18.10.2017, duke rrëzuar kërkesën. Ky vendim është ankimuar nga pala R. dhe vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës (këtë vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan e keni bashkëlidhur këtij material).

190. Për denoncimin nr. * prot., të palës studio ligjore “J.”**

*Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016) ju parashtroj se: për padinë e këtij paditësi (ku edhe unë jam palë), po ju paraqes aktet vijuese: prapësimet e mia origjinale datë 4.11.2019, për padinë nr. *** të vitit 2019, që është dorëzuar në këtë gjykatë; procesverbalet e mbajtura për këtë çështje në këtë gjykatë para kthimit të saj për rigjykim; vendimin origjinal civil nr. ***, datë 21.11.2019, të kësaj gjykate (dhe pasojën e këtij vendimi në Apel); fletën origjinale elektronike të shortit civil RIV, nr. *** të vitit 2021, pas kthimit të kësaj çështjeje për rigjykim (caktuar të njëjtit gjyqtar të deleguar) dhe aktin e datës 20.8.2021, të kryesekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate (sipas të cilës kjo çështje është aktualisht në gjykim). Unë i qëndroj të njëjtave prapësime për këtë padi.*

191. Për denoncimin nr. * prot., të palës A. D.**

*Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj se: ka patur në proces padinë nr. *** akti të vitit 2017, që iu përket palëve A. D. - Këshilli i Ministrave etj., me objekt “fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, pa titull etj.” në bazë të neneve 168 dhe 169 të Kodit Civil. Paditësi parashtrori shkakun e padisë, ku i bazonte pretendimet e tij, duke saktësuar të drejtën materiale konkrete që ai kërkonte të mbronte, sipas nenit 169 të Kodit Civil. Gjykata e zbuloi shkakun e padisë, duke e analizuar në tërësinë e tyre përmbajtjen e saj pretendimet e prapësimet në gjykim, duke mbajtur parasysht nenet 5, 31 e 154 të Kodit të Procedurës Civile, pa u lidhur me përcaktimet në padi e gjykim, duke konstatuar se pretendimi i paditësit në parim ka mbrojtje ligjore; gjykata i ftoi palët të jepnin shpjegime që nga pikëpamja e së drejtës ish-in të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Për këto shkaqe dhe sipas pretendimit gjykata çmoi se me gjendjen përkatëse të akteve, palët në këtë proces legjitimoheshin me cilësitë e tyre procedurale në këtë gjykim; paditësi kishte interes të ligjshëm; kjo gjykatë kishte juridiksion e kompetencë për gjykimin e përfundimin e çështjes, me ndërgjyqësinë, objektin e bazën ligjore që u paraqit për gjykim. Në përputhje me pretendimet, prapësimet, objektin e shkakun e padisë u çmua se në këtë çështje ish-in të zbatueshme nenet 169, 170, 192-197, 316-361, 304-306 të Kodit Civil të vitit 1994; VKM-ja përkatëse në fuqi e vitit 2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë s shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë e Financave”; ligji nr. 7843/1994 e ligji nr. 33/2012; ligji nr. 8743/2001; VKM-ja nr. 608/2012, “Për përcaktimin e procedurës të regjistrimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme dhe të truallit”; VKM-ja nr. 578/2012 dhe nenet 5-24, 31, 32/a, 35, 36, 41, 45, 224/a, 253, 255, 281 e 282 të Kodit të Procedurës Civile; vendimi gjyqësor civil themeltar nr. ***, datë 11.7.1994, i kësaj gjykate (dhe kartela e pasurisë së paluajtshme nr. ***, të lagjes “S.”, z. k. ***, qyteti Elbasan, lëshuar pas azhornimit të pasurisë të vërtetuar sipas këtij vendimi gjyqësor), nuk kishin fuqi në çështjen objekt gjykimi, pasi ky vendim gjyqësor nuk përcakton sipërfaqen e pronësisë se vërtetuar, nuk shoqërohet me asnjë lloj planvendosje të pasurisë së paluajtshme të vërtetuar; ky vendim gjyqësor nuk përmban detyrim për ndonjë organ vendor publik dhe (ky vendim gjyqësor) nuk i kundërtohet asnjë pale (person fizik apo person juridik, privat apo publik, qendror apo vendor); akti nr. *** regj., datë 14.9.1993, i kësaj gjykate nuk ka fuqi në çështjen objekt gjykimi, pasi vendimi gjyqësor civil themeltar nr. ***, datë 5.12.1964, i kësaj gjykate (që referon ky akt) nuk përcakton sipërfaqen e pronësisë së pasurisë së paluajtshme të vërtetuar, nuk përcakton palët në procesin përkatës civil, objektin e padisë/kërkesës, shkakun e saj ligjor; ky akt nuk shoqërohet me asnjë lloj planvendosje të pasurisë së paluajtshme të vërtetuar dhe nuk përcaktohet koha se kur ka marrë formë të prerë ai vendim civil. Meqenëse paditësi nuk provoi të kundërtën e përmbajtjes apo falsitetin e këtyre akteve/të dhënave, u çmua e panevojshme kryerja e ekspertimit topografik dhe*

pyetja e çdo dëshmitari, pasi në çdo rast do rrëzohej padia, procesi nuk do kishte efektivitet dhe do të rriteshin shpenzimet/kostot e palëve/procesit; gjykata arsyetoi shkaqet e moskryerjes së ekspertimit dhe të mosthirrjes së dëshmitarëve. Nuk është e vërtetë se gjatë gjykimit ka pasur mungesë serioziteti dhe mungesë etike në zhvillimin e seancave gjyqësore. Tërheqja e vëmendjes së avokatit të paditësit, i cili ndërhyr pa lejen e gjykatës, ndërkohë që gjykata shpallte vendimin e ndërmjetëm, nuk tregon mungesë etike. Meqenëse ishte e panevojshme, me gjendjen e akteve të dosjes, sipas pretendimit objekt padie dhe nuk tregohen emrat e kufitarëve, me vendim të ndërmjetëm dhe të arsyetuar (pa paragjykuar zgjidhjen e çështjes dhe ecurinë e mëtejshme të procesit), gjykata vendosi: rrëzimin e kërkesës së paditësit, me objekt “pyetjen e dëshmitarëve”; me vendim të ndërmjetëm janë pranuar për administrim provat shkresore të paraqitura prej paditësit dhe i është kërkuar atij/paditësit të paraqesë prova të tjera shkresore. Meqenëse përfaqësimi i paditësit në fazën përkatëse ishte me të meta; meqenëse kërkesa e datës 16.10.2017, me objekt “kërkim të kopjeve të akteve” (dërguar me postë dhe dorazi) nuk ishte nënshkruar nga paditësi (por nga avokati i tij, pa prokurë), me vendim të ndërmjetëm e të arsyetuar gjykata vendosi në fazën përkatëse të seancës së datës 31.10.2017, të mos veprohej nga sekretaria gjyqësore për t’i dhënë përgjigje kërkesës së avokatit të paditësit, me objekt “kërkim të kopjeve të akteve”. Ndërkohë që shpallej vendimi i ndërmjetëm, avokati i paditësit fliste pa lejen e gjykatës (duke deklaruar se kishte prokurë noteriale nga paditësi, por nuk e depozitoi kur iu kërkua prej gjykatës). Disponimi i Gjykatës së Apelit Durrës, që ka prishur këtë vendim lidhet me mënyrën e çmuarjes teorike (nga kjo gjykatë apeli) këtij rasti; e respektoj këtë vendim apeli.

192. Për denoncimin nr. * prot., të palës T. M.**

Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj se: kam pasur në proces padinë nr. *** akti të vitit 2016, që u përket palëve A. S. – T. M. etj., me objekt padie “lirim e dorëzim sendi etj.”; me objekt kundërpadie “njohje pronar etj.”. Me vendim të ndërmjetëm, në seancën e datës 20.3.2017, u vendos shqyrtimi i kundërpadive të të paditurve, në gjykim të vetëm. Po në këtë seancë të paditurit/avokatja e tyre ka dhënë shpjegime për kundërpadinë, është dëgjuar në këtë seancë edhe paditësi për kundërpadinë dhe (po në këtë seancë) janë administruar provat e paraqitura bashkëlidhur kundërpadive. Në seancën e datës 27.3.2017 palët kanë debatuar për ekspertimin dhe morën dijeni për seancën e re të datës 12.4.2017. Por të paditurit përkatës dhe avokatja e tyre nuk u paraqitën në seancën e datës 12.4.2017; meqenëse të paditurve kundërpaditës ju ishte dhënë koha për mbrojtje; meqenëse avokatja e tyre kishte dijeni dhe shkaku i parashtruar prej saj nuk ishte i provuar dhe as i bazuar në ligj. Fakti që një gjykatë më e lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ajo që ka mbajtur Gjykata e Rrethit Elbasan (ku unë jam pjesë e vendimmarrjes), nuk përbën argument dhe nuk duhet të përdoret apriori për të vlerësuar njohuritë e mia ligjore, arsyetimin tim ligjor, vlerësimin dhe aftësinë time profesionale (veçanërisht aftësitë që lidhen me zgjidhjen e çështjes).

193. Për denoncimin nr. * prot., të shtetasës Z. T.**

Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj se: kam pasur në gjykim padinë civile nr. *** akti të vitit 2017, që u përket palëve S. T. – V. Ç., me objekt “detyrimin e të paditurve të kthejnë solidarisht huan”. Pasi u administruan/shqyrtuan padia, pretendimet, prapësimet, deklarata e thjeshte e datës 20.9.2016, kujtesa noteriale e paditësit (drejtuar të paditurve) dhe një disk/CD (akte këto të paraqitura nga paditësi e mbrojtësi i tij). Në kundërshtim me një pjesë të pretendimeve të paditësit gjykata vlerësoi (ndër të tjera) se nuk u provua që të paditurit V. dhe A. kishin marrë hua në emrin e tyre apo në mënyrë solidarë. I padituri V.1 (në kohën e redaktimit të

deklaratës së datës 20.9.2016) ka vepruar me cilësinë e ortakut të të paditurit “K. O.”; e paditura A. (ortakja tjetër e kësaj shoqërie tregtare) kishte dijeni për marrjen e huas në emër të kësaj shoqërie; paditësi nuk e ka siguruar kthimin e huas (që i ka dhënë të paditurit “K. O.”), me hipotekë mbi pasuritë e paluajtshme të të paditurve. Ky vendim gjyqësor nuk ka marrë formë të prerë dhe sekuestrimi i pasurive të paluajtshme të të paditurve kryhet nga përmbaruesi gjyqësor (në fazën e ekzekutimit të titullit), në kuptim e zbatim të neneve 510, 511-527 të Kodit të Procedurës Civile.

194. Për denoncimin nr. * prot., të shtetasit Gj. Gj.**

Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj se: kam pasur në gjykim kërkesën e veçantë penale nr. *** akti të vitit 2017, që u përket palëve Gj. Gj., me objekt “kundërshtimin e vendimit të prokurorisë etj.”. Seancat janë shtyrë për shkaqe të përligjura/të motivuara të domosdoshme dhe nuk kishte alternative tjetër; për ankimin e këtij shtetasi/palë kam dhënë sqarime në KLD dhe ju qëndroj këtyre deklaramëve (bashkëlidhur këtij material keni edhe deklaramet e mia, datë 11.1.2019, dërguar KLD-së/inspektorit përkatës, në lidhje me ankesën e kësaj pale; keni vendimin përkatës gjyqësor penal nr. ***, datë 18.10.2017, të kësaj gjykate, me kërkuese R. A.; edhe pala R. A. rezulton që ka paraqitur në Komision ankesën e sipërcituar ndaj meje. Mund të këtë zvarritje, por jo për shkaqe që lidhen me kryerjen e detyrës prej meje, por për shkaqet vijuese.

195. Për denoncimin nr. * prot., të palës “R. L.”**

Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj se: në shqyrtimin e kërkesave, me objekt “L. U. ekzekutimi”, jam referuar në dispozitat e neneve 511 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile (ndryshuar me ligjin nr. 38/2017); kërkesat janë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe në mungesë të palëve. Kjo dispozitë nuk parashikon lënien e afatit për plotësimin e të metave, pasi do e shndërronte procesin e këtyre çështjeve në gjykim të zakonshëm. Është detyrimi i kërkuetit/kreditorit të paraqesë akte të plota provuese, përfshirë edhe akteve e përfaqësimit të tyre, me gjendjen e përditësuar të të dhënave. Në fakt, nuk jam unë që kam mbajtur qëndrime të ndryshme për shqyrtimin e kërkesave të kësaj natyre (siç pala denoncuese ka pretenduar në Komision, duke paraqitur vendimin e veçantë nr. ***, datë 30.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Elbasan, i cili është prishur me vendimin nr. ***, datë 3.7.2019, nga Gjykata e Apelit Durrës [...]). Bashkëlidhur këtij material po ju paraqes edhe vendimin e veçantë gjyqësor civil nr. ***, datë 5.2.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, sipas të cilit është lënë në fuqi vendimi gjyqësor i veçantë civil nr. ***, datë 31.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Elbasan (disponuar prej meje). Në këtë vendim apeli është interpretuar edhe neni 154/a i Kodit të Procedurës Civile, sipas të njëjtit kuptim që kisha unë. Vendimet e Gjykatës së Apelit (kur mbajnë të njëjtin qëndrim, për të njëjtat çështje/problematika), në parim janë vendime orientuese, ofrojnë standard të ri gjykimi dhe përbëjnë precedentë për t'u respektuar, për raste të tjera që do gjykohen në të ardhmen.

196. Për denoncimin nr. * prot., të palës E. K.**

Pavarësisht se nuk i përket periudhës parimore kohore rivlerësuese (2013 – 2016), ju parashtroj: kam pasur në proces padinë nr. *** akti, që u përket palëve personi juridik privat tregtar “E. T.” – K. M. etj., me objekt “shpërblim dëmi etj.”. Denoncuesi E. K. është vëllai i administratorit të paditësit. Këtë çështjen civile e kam marrë pa short të rregullt ose në mënyrë të paracaktuar; janë kryer veprimet përgatitore; seancat janë shtyrë për shkaqe të domosdoshme dhe objektive, përfshirë plotësimin e të metave të përfaqësimit të paditësit dhe mungesa e palëve përkatëse, për shkaqe të justifikuara. Për

*çdo seancë të re të planifikuar janë kryer detyrat e caktuara në seancën paraardhëse; ka pasur shtesa/saktësime të objektit të padisë dhe janë shtyrë seanca, që të njoftohen palët në mungesë për këto shtesa/saktësime; janë shtyrë seancat, për t'u njoftuar të tretët për akte që administrohen prej tyre (që kishin lidhje me pretendimet e prapësimet e palëve të pranishme) dhe për të pritur përgjigjet e tyre; janë shtyre seancat, që palët e pranishme të njihen me përgjigjet e të tretëve dhe paditësi të jepte sqarime/parashtrime plotësuese në gjykatë për 23 kërkesat/pyetjet/nënpyetjet e gjykatës, sipas gjendjes së akteve të administruara deri në fazën përkatëse të procesit dhe sipas neneve 14, 175, 176 e 185 të Kodit të Procedurës Civile; seancat janë planifikuar duke pasur parasysh kohën e kthimit të përgjigjeve nga të tretët, kohën që u nevojitet palëve (për t'u njohur me aktet, për t'u njohur me shtesat/saktësimet e objektit të padisë), që kanë lidhje me parimin e kondradiktoritetit. Pra, në caktimin e seancave të reja ka ndikuar edhe sjellja e të tretëve (organet shtetërore, vendore), objekti voluminoz i kërtimeve dhe sasia voluminoze e akteve për administrim. Vendimet e ndërmjetme janë të arsyetuara dhe palët e pranishme kishin dijeni. Kjo dosje përmbante edhe aktet që i kishin pasur për shqyrtim më parë 2 gjyqtarë të tjerë. Nuk kam qenë dakord me kërkesën e paditësit për përjashtimin tim (por u përjashtova nga një gjyqtar tjetër i kësaj gjykate). Mund të këtë zvarritje, por jo për shkaqe që lidhen me kryerjen e detyrës prej meje. Kam pasur në proces çështjet civile nr. *** akti të vitit 2020 dhe nr. *** akti të vitit 2020, që u përkasin të njëjtave palë M. D. – T. D., me objekt “zgjidhjen e martesës etj.”. Denoncuesi E. K. nuk ka asnjë interes të drejtpërdrejtë në këto çështje.*

Vlerësimi i trupit gjykues

- 197.** Në vijim të shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit dhe të dokumentacionit të paraqitur prej tij, trupi gjykues vlerëson se ky i fundit nuk ka paraqitur elemente argumentues bindës apo prova që të përmbysin apo ndryshojnë totalisht rezultatet e njoftuara nga Komisioni. Megjithatë, mes shumë problematikave të konstatuara, rezultoi se lidhur me disa rrethana konkrete subjekti ka shprehur një interpretim alternativ ose ka argumentuar se qëndrimet e tij ishin të bazuara në bindjen e tij. Gjithashtu, mbi problematikat e konstatuara lidhur me masat e propozuara (ose të dhëna ndaj tij), subjekti ka pohuar, edhe përgjatë seancës dëgjimore, se ato kanë qenë tendencioze dhe të pabazuara, por nga ana tjetër, nuk ka provuar të kundërtën, për sa kohë të gjitha zvarritjet e proceseve gjyqësore ose vonesat për zbardhjet e vendimeve dhe shkeljet e tjera të konstatuara ishin bazuar në të dhëna konkrete, përpos subjektivizmit hipotetik të vlerësimit të rrethanave në raport me masën disiplinore të propozuar.
- 198.** Në këto kushte, duke konstatuar se nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale kanë rezultuar problematika të shumëfishta dhe të shtrira në kohë (ndër të cilat disa janë referuar prej Ministrisë së Drejtësisë, ose nga KLD/KLGJ-ja dhe të tjera të cituara nga Komisioni, pasi ka analizuar dhe përfshirë edhe të dhënat e evidentuara nga denoncimet e publikut për këtë subjekt) – trupi gjykues çmon se shumë prej shkeljeve dhe problematikave të konstatuara në këtë kriter kontribuojnë gjithashtu në krijimin e bindjes mbi cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë nga ana e subjektit. Për rrjedhojë, vlerësohet e mjaftueshme që këto gjetje/shkelje të konkurrojnë – së bashku me elementet e tjera të evidentuara në dy kriteret e shqyrtuara më herët, të cilët gjithashtu janë kualifikuar dhe kristalizuar si përcues e passjellës të të njëjtit efekt/pasojë – duke kontribuar kësaj në gërshetimin e elementeve faktiko-ligjore që përforcojnë bindjen për aplikimin e pikës 5 të nenit 61, pa qenë nevoja në këtë rast/pikë që shkeljet profesionale të vlerësohen paralelisht edhe në kuptimin *stricto legis* të aftësive profesionale lidhur me nivelin kualifikues, të parashikuar nga germa “c” e nenit 59/1, të

ligjit nr. 84/2016 – për sa kohë ky aspekt tashmë duket ininfluent mbi vendimmarrjen përfundimtare lidhur me vijueshmërinë ose jo të ushtrimit të detyrës.

199. Në konkluzion, trupi gjykues çmon se:

- i.** Në lidhje me kriterin e pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka pasur mungesë të theksuar të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruar; (ii) ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe ka (tentuar për të) fshehur pasurinë nr. 1, përgjatë viteve 2004 - 2010; (iii) kësisoj, duke cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
 - ii.** Në lidhje me kontrollin e figurës – ndonëse nuk janë provuar faktet se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme, të cilat do të mundësonin aplikimin e pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 – kanë rezultuar përputhje midis informacioneve të klasifikuara dhe qasjeve procedurale, të ndërthura me zgjidhjet substanciale të kryera nga subjekti lidhur me disa çështje gjyqësore, veprime të cilat kanë cenuar besimin e publikut, duke e bërë të papërshtatshëm subjektin për vijimin e detyrës.
 - iii.** Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, për sa më sipër, trupi gjykues çmon se shkeljet e konstatuara konkurrojnë – së bashku me elementet e tjera të evidentuara në dy pikat e mësipërme – në gërshetimin e elementeve faktiko-ligjore, që (ri)krijojnë bindjen se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, rrjedhimisht, përforcojnë bazueshmërinë për aplikimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
- 200.** Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Musta, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Musta, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.9.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Lulzim HAMITAJ
Relator

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi